



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

PREJ DYSHIMIT DERI NË BESIM

Dr. Mustafa Mahmud

Botuar nga: SHB Logos-A

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

Në vend të parathënies**Error! Bookmark not defined.**

PARATHËNIE PERSONALITETI DHE VEPRA E MUSTAFA MAHMUDIT

Dr. Mustafa Mahmud është i lindur në vitin 1921 në Egjipt. Shkollimin fillor dhe të mesëm e kreu në Tantë, atë universitar në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Kajros. I specializoi sëmundjet e mushkërive, duke u bërë njëri prej ekspertëve më të njohur për këto lloj sëmundje në Egjipt. Mirëpo, dëshira për afirmimin letrar ishte më e fuqishme, kështu, e lëshoi mjekësinë dhe i kushtohet studimit letrar, filozofik, sufistik dhe ideor.

Së pari u mor me letërsi; boton disa vepra të rëndësishme dhe të dalluara letrare, të argumentuara me përsiatje filozofike, e të krijuara menjëherë pas revolucionit në Egjipt në vitin 1952. boton edhe disa tregime të shkurtra, prej të cilave posaçërisht dallohen: “Ushqimi dhe jeta” (1953), “All-llahu dhe njeriu” (1955), “Apartmani 7” (1955 dhe 1957), “Një grup njerëzish” (1962), “Era e gjakut” (1965), Pastaj boton disa studime mjaft të rëndësishme siç janë: “Iblisi” (1957), “Enigma e vdekjes” (1958), Enigma e jetës”(1967), “Endërrat” (1961), “Ajshtajni dhe relativiteti” (1961) e tjera. I shkruan disa ese me rëndësi ndërmjet të cilave veçanërisht dallohen: “Mbi dashurinë dhe jetën” që janë botuar ndërmjet vitit 1961 dhe 1965. Romanet të cilat i shkruan e pushtojnë publikun dhe i nxisin kritikët e mëdhenj. Posaçërishtë dallohen romanet e tij vijuese: “E pamundshme” (1960), “Opiumi” (1964), Marimanga” (kah fillimi 1965) Dalja Prej

tabutit (arkivolit) (kah fundi i 1965), Neriu nën zero (1966), shkruan edhe pjesë teatrale, “Njeriu dhe hija” (1964), “Goma” (në dimër 1968), “Djalli banon në shtëpinë tonë” (1973). Pastaj botohen disa udhëpërshkrime të rëndësishme të tij: “Pylli virgjër” (1963), “Shpella në shkretëtirë (1969), “Qyteti” ose “Rrëfimi i mysafirit” (është përmbledhje vëzhgimesh mbi udhëtimet e tij nëpër Evropë ndërmjet vitit 1966 dhe 1968). Vepra me titullin “Ma kanë pranuar”, në të vërtetë, është përmbledhje letrash të zgjedhura, të cilat lexuesit ia kanë dërguar në periodën ndërmjet vitit 1956 dhe 1959. Zgjedhja prej letrave të lexuesve ndërmjet vitit 1960 dhe 1966 botohet me titullin “55 problemet e dashurisë”. Pastaj krijohen “Pranimi i të dashuruarve (1956-1966), dhe “Rruga deri në Qabe (1971), Mustafa Mahmud i boton edhe disa studime mjaft të rëndësishme, të cilat kanë shkaktuar polemika jashtëzakonisht të mëdha dhe të vrazhda. Veçanërisht janë të njohura: “Kur'ani - tentativë për të kuptuarit bashkëkohor” (1969), “Peripecitë e mia prej dyshimit deri në besim” (1970), “All-llahu”, (1972), “Djalli sundon” (1970), “Tevrati” (1972), “E kam parë Zotin” (1973), “Shpirti dhe trupi” (1973), “Dialog me mikun ateist” (1974), “Marksizmi dhe islamizmi” (1975), “Muhammedi (a.s.)” (1975) e tjera.

Duke e dhënë këtë pasqyrë të shkurtër të veprave të publikuara të M. Mahmudit, kemi pasur për qëllim që lexuesit tonë t'i njoftojmë me këtë shkrimtar, shkencëtar e mendimtar bashkëkohor arab me arudicion jashtëzakonisht të madh, rruga jetësore e të cilit është mjaft interesante, që përndryshe më së miri mund të shihet prej zhvillimit ideor të cilin ai e ka kaluar.

ZHVILLIMI IDEOR I DR. MUSTAFA MAHMUDIT

Vështirë është që në një vështrim të këtillë të shkurtër të thuhet krejt ajo që do të duhej të thuhej mbi zhvillimin ideor të Mustafa Mahmudit. Megjithatë do të përpiqemi t'i shkoqisim së paku tendencat kryesore të këtij zhvillimi, duke i reduktuar ato në katër:

- a) prej muzikës deri në medicinë,
- b) prej aventurës deri në izolim,
- c) prej dyshimit deri në besim,
- ç) prej letërsisë deri në filozofi.

Do të përpiqemi këtu, së paku shkurtimisht të tregojmë në të katër periodat e zhvillimit, në mënyrë që lexuesit tonë, aq sa të njihen me këtë personalitet mjaft interesant të botës bashkëkohore islame.

- a) Prej muzikës deri në medicinë

Qysh në shkollën fillore, pastaj në të mesmen, Mustafa Mahmudin e tërhiqte muzika. Duke e lexuar dhe dëgjuar Kur'anin frymëzohej me muzikalitetin dhe bukurinë e tij. Kjo ndikoi që një ditë ta blejë kitarën dhe të fillojë të mësojë të rënët veglave muzikore. Kitara shpejt iu pat bërë pasion dhe opsion. Nga ana tejtër, prindërit njëmend dëshironin që të birin ta shohin në El Ez'herin e njohur, e pastaj në xhube dhe ahmedi. Mirëpo, muzicenti i ri i theu të gjitha shpresat e tyre atë ditë kur maturoi dhe shkoi të regjistrohet në fakultet. Pas kthimit prej Kajros, i lajmëroi

prindërit se është regjistruar në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Kajros, duke ua bërë me dije se ky vendim i tij është përfundimtar. Ja, kështu Mustafa Mahmud në një mëngjes të shtatorit u lajmërua në Fakultetin e Mjekësisë në të cilin më vonë diplomoi dhe specializoi.

Askush nuk e dinte se pikërisht të studiuarit e mjekësisë aq fuqishëm do të ndikojë në Mustafa Mahmudin, i cili qysh në shkollën e emesme tregonte interesim të madh për ateizëm. Ditë e natë lexonte, shkruante dhe diskutonte. Profesorët e këshillonin që ta lë mjekësinë dhe t'i kushtohet letërsisë. Të tjerët ia preferonin drejtësinë, deri sa të tretët i sugjerorin ta studiojë filozofinë. Duket se vetëm ai e dinte se cila është rruga e tij. Së shpejti u bind se pikërisht mjekësia ia ofron atë që dëshiron. Profesorët shpesh e gjenin se si qëndron pranë trupit të autopsuar (prerë) të njeriut, i ndan dhe i analizon pjesët e tij, duke kërkuar përgjigje në pyetjet, të cilat shpesh as vetë profesorët nuk i dinin e ndoshta as nuk i kërkonin. Në këtë periudë M. Mahmud i shkruan disa vepra, të cilat paraqesin fillimin e kthesës në jetën e tij, sikur që janë veprat: “Enigma e vdekjes”, “Marimanga” e disa të tjera. Kjo për një kohë do ta shpjerë në filozofinë indiane, ku në idenë e inkarnacionit do të orvatet të gjejë përgjigje në disa pyetje të cilat e preokuponin. Mjekësisë përsëri i kthehet, duke ia kushtuar tërë qenien e vet. Duke iu falënderuar kësaj, për një kohë relativisht të shkurtër filloi të dominojë në qarqet e mjekësisë në Egjipt, që te një shumicë nxiti xhelozitë e te disa madje edhe kundërshtim të hapët. Reputacioni të cilin e gëzonte në vend dhe jashtë vendit, i mundësoi atij udhëtime mjaft të shpeshta në shumë vende të Evropës, Azisë dhe Afrikës.

b) Prej aventurës deri në izolim

Shpirti i shqetësuar dhe të ardhurat e mira e nxisin në aventura. Disa herë shkoi në Evropë, duke u orvatur të gjejë qetësi në të dhe në qarqet e saj shkencore. Lexon çdo gjë që i vjen ndër duar, zhvillon diskutime me dijetarët dhe shoqërohet me mendimtarët duke shpresuar se ata do t'i ofrojnë atë që e kërkon dhe për çka hulumton. Mirëpo, mbetet gojëhapur pas takimit me ta. Pasqyra të cilën para kësaj e kishte mbi Evropën filloi papritmas të venitet dhe çrënjoset. I pasur në të gjitha dhe egoist sipas natyrës e detyrojnë që më thellë të zhytet në shpirtin e njeriut evropian, veçantia parësore e të cilit është centrizmi ekskluziv. Kjo i hap atij horizonte të reja, të cilat do ta shpiejnë në Azi, pastaj në Afrikë, midis njerëzve, zakoneve, shkretëtirës, xhunglës dhe fiseve të tyre. Altruizmi islam në të, gjatë këtyre udhëtimeve, do të zhvillojë njohuri grandioze të filantropisë, dashurisë dhe humanizmit. Kudo do të gjurmojë për burimet origjinale të dashurisë ndaj Finitit (për fundimtarit), Absolutit dhe Burimorit. Për këtë në veprat e tij edhe takohemi me udhëkryqet e të gjitha meridianëve të botës. Penda e tij gazetareske sado që është ekskluzive aq është edhe studioze. Në udhëpërshkrime, artikuj, vepra dhe punime tjera, të krijuara në atë periodë hasim në laramani të pasur të jetës, të mbushur me zakone, kontraste, tradita, martesat, lindje, varrime dhe me dervishët e të gjitha tarikateve, kombeve dhe manireve. Mustafa Mahmudi tek ato na shpie nëpërmjet të gjitha rrugëve të jetës, pikëllimit, gëzimit, varfërisë, pasurisë, shfrenueshmërisë, tërheqshmërisë dhe shumëngjyresisë.

Thënë shkurt, këtu pikërisht takohemi me jetën ashtu siç është: e plotë dhe e zbrazët njëkohësisht, jetën e cila e përjetëson aromën, të qajturit dhe të qeshurit e tij. Mustafa Mahmud arrin të na prezentojë këtë me fjalë po ashtu sikurse artisti që e bën këtë me ngjyra.

Në këto vepra të tij gjejmë mjaft frymë romantike, pasuri realiste dhe shumë këndim simbolik. Këtu Mustafa Mahmud paraqet një hap më tej në letërsinë bashkëkohore arabe e cila shquhet me

nduarndurshmëri, pasuri, ide, ballafaqim, guxim, bukuri, angazhim, humanizëm dhe tradicionalitet.

Dhe pikërisht kjo përvojë e pasur dhe e ndurnduartë do t'i konfirmojë Mustafa Mahmudit se jeta dhe vdekja së bashku me materien dhe shpirtin me të vërtetë paraqesin sekretin e sekretit dhe se njeriut, sado që të dijë, të posedojë dhe kushdo qoftë, megjithatë pak i është dhënë. Ky mësim do të jetë shkak që edhe ai vetë të gjendet në meridianët, binarët dhe hulumtimet e reja ideore, çka të gjitha së bashku do ta shpiejnë atë në të përsiaturit e ri, në vetmi dhe izolim.

c) Prej dyshimit deri në besim

Ka mundur të pritej se dr. Mustafa Mahmudi në këtë rrëke nduarndurshëmish dhe kontradiktash do ta humbë veten. Mirëpo, një shikim rreth vetvetes dhe jashtë vetvetes e detyron që t'i përcaktojë relacionet e veta jetësore, të cilat shpiejnë nëpër të gjitha scillat dhe haribdet, mosbesim dhe besim, mëkate dhe pendime. shfrenime idore dhe përcaktime shpirtërore, ndryshueshmëri kreative dhe stabilitet logjik. Dhe kjo rrugë do të jetë rikthyese në tërë jetën e tij. Në tërë këtë ai do ta gjejë vetveten edhe qenien e vet. Kështu do të fillojë faza e re e jetës së tij, e cila e tërë do t'i kushtohet shpirtit, fesë, njeriut dhe ngritjes së tij. E tërë kjo ka ardhur pas leximit, studimit dhe premjes edhe të tjerëve edhe vetvetes. Fryt i gjithë kësaj do të jetë vepra e tij me rëndësi “Peripecitë e mia prej dyshimit deri në besim” të cilën lexuesit tonë kanë rast ta lexojnë si botim të veçantë. Është interesant të theksohet se para do kohe kjo vepër është publikuar edhe në gjuhën frengjishte në përkthimin e orientalistit të njohur Moro Shartijes, të botuar në Bejrut.

Duke e marrë parasysh se lexuesit tonë, siç e theksuam tashmë këtë, janë njoftuar me këtë vepër, për këtë arsye te kjo nuk do të ndalemi. Do të theksojmë vetëm se kjo paraqet shprehjen e

zhvillimit shpirtëror të autorit po në atë përmasë në të cilën prezentohen disa vepra të Dekartit, Gazalisë, Spinozës e të tjerëve. Këtu është e nevojshme të theksohet se kjo periudë e dr. Mustafa Mahmudit, prezenton të kthyerit e tij të sinqertë, njëmend Kur'anit, krejtësisht do ta shpjerë në binarët, rrugën dhe relacionet e tij. Këtë edhe do ta bëjë që i tërë t'i jepet dhe t'i kushtohet të studiuarit kompleksiv të Kur'anit. Si rezultat i kësaj lindi vepra e tij “Kur'ani tentativë për të kuptuarit bashkëkohor” (kjo vepër është në përkthim e sipër edhe në shqipen) e cila ka shkaktuar diskutime të rrepta midis islamologëve, rezultat i së cilës ishte edhe vështrimi shkencor - kritik mbi këtë vepër i kur'anologes së njohur dr. Aishe Abdurahmanit - më të njohur si Bintu Shati. Në këtë vepër Mustafa Mahmudi do të niset hapave të të observuarit konstruktiv kur'anor, duke i konfirmuar dimensionet e mu'xhizes së Kur'anit dhe të predominuarit e tij të gjitha llojeve të kufizimeve, duke i mishëruar në njëmendësinë absolute, të cilën mundemi vazhdimisht ta zbulojmë, por asnjëherë nuk mundemi plotësisht të zbulojmë. Përveç tjerash kjo do t'i ndihmojë t'u shmanget të gjitha tendencave tjera ndikuese, duke u thelluar thellë në sferën e fesë, filozofisë dhe shkencës.

Për shkak të mbarë të ekspozuarës mund të themi se letërsia e tij pikërisht edhe e ka kaluar rrugën e vet zhvilluese e cila më në fund e gjet në punimet filozofike sikurse do ta shohim këtë më vonë.

ç) Prej letërsisë deri në filozofi

Së pari konsideronte se nëpërmjet veprës letrare mund të thuhet çdo gjë. Për këtë hidhet në fushën e letërsisë, e cila me të vërtetë edhe i sjell famë, renome dhe mirënjohje. Veprat e tij lexohen në të gjitha anët. Çdonjera prej tyre, gati, është rrëmbyer. Mbi to shkruhet, shqyrtohet dhe mendohet. Kur shfaqet pjesa e tij teatrale atëherë nëpër sportele është rrëmujë, sepse rinia

universitare dëshiron ta shohë, ta ndjejë dhe ta dëgjojë. Besojmë se për këtë arsye vepra e tij letrare është e mveshur, sa me sensibilitetin e artistit, aq edhe me penetrimin, subtilitetin e filozofit. Ai është letrar - filozof dhe filozof - letrar. Stili i tij është tërheqës, i bukur dhe dinamik. Gjuha është e mveshur me figurativitet, simbolikë dhe ide. Dialogjet janë të logjikshme dhe me proporcionalitet. Eksploatimi me mundësinë gjuhësore është shumë i pasur dhe i fuqishëm. Çdo gjë është në lëvizje, hov, zhvillim, ndryshim. Personazhet janë të gjallë, origjinalë dhe të zhvillueshëm, por edhe të thurur në tërësinë e konceptimit të krijimit të ri letrar, e cila imponohet, ndikon, ndërron dhe krijon. Këtu mishërohen shpresat për të nesërmen më të mirë, më humane dhe më të ndjeshme, sepse para së gjithash jemi njerëz. Në tërë këtë njeriu mund ta shohë edhe mjerimin e vet edhe shenjtërinë e vet, pavlerësinë dhe autoritetin. E para e shkatërron, ndërsa e dyta e nderon. Në vrapimin e vazhdueshëm për ndërrime dhe gjurmime ai, megjithatë, merr fuqi ta gjejë vetveten, qenien e vet dhe t'i mposhtë problemet, të cilat edhe pse origjinale, megjithatë e transformojnë njeriun. I lirë është vetëm atëherë kur ka mundësi të përcaktohet, angazhohet dhe prodhojë, sepse në tërë atë mishërohet edhe ideja e tij sikur edhe qenia e tij.

Ja, në tërë këtë ciklus të ndodhur rreth tij dhe në vetë at, njeriu sipas mendimit të dr Mustafa Mahmudit është i vyeshëm aq sa vepron, sa është i lirë, sa beson dhe sa është i angazhuar.

Dhe në fund, dëshirojmë të theksojmë se dr. Mustafa Mahmudi është i preokupuar me problemet e njëjta me të cilat është i preokupuar edhe filozofi më i madh bashkëkohor islam dr. Muhammed El-Behij, edhe pse të dy problemeve iu hyjnë nga aspektet e shumënduarta dhe aspektet e llojllojshme. Neve na mbetet vetëm kjo që të dy, sikur edhe mendimtarët tjerë islamo - arabë, t'i njoftojmë, prezentojmë dhe studiojmë.

Dr. Ahmed Smajloviqi

ALL-LLAHU

Ka qenë kjo kaherë, nuk më kujtohet se kur, ndoshta kam pasur dymbëdhjetë deri në katërbëdhjetë vjet, e ndoshta edhe më pak. Kam qenë afër moshës madhore kur paturpshëm kam pyetur:

- Po pohoni se si All-llahu e ka krijuar botën, se të gjitha krijesat duhet medoemos ta kenë Krijuesin, se çdo vepër duhet ta ketë krijuesin (trajtuesin), çdo gjë që ekziston filluesin e vet. Mirë! - do të besoj! - por më thoni ju kush e krijoi All-llahun apo Ai u krijua vetë?! Nëse është krijuar vetë dhe ju këtë e pranoni si të vërtetë, përse imagjinata juaj nuk do ta pranonte se edhe bota është krijuar vetvetiu, se ajo nuk ka Krijues dhe çështja nuk do të ishte kontestuese.

Kur e flitja këtë, fytyrat e njerëzve të cilëve u drejtohesha, zbeheshin dhe gjuhët e tyre më mbushnin me rrebesh mallkimesh. Garonin, nga të gjitha anët, se kush më shumë do të më qortojë, e njerëzit me zemër të devotshme më dëshironin falje prej Zotit dhe të më udhëzojë në rrugë të drejtë. Konservatorët më kanë refuzuar, e rebelët rreth meje janë tubuar dhe pafundësisht kanë diskutuar mbi çështjet filozofiko - fetare.

Krenaria në njohjen time të atëhershme e cila mori përpjesëtime të gjera dhe elokuenca ime gjatë të ekspozuarit me të cilën jam dalluar, këto kanë qenë motive që të sillen kështu, e jo dëshira që ta mësoj të vërtetën dhe ta zbuloj realitetin. Pastaj, harrova se shkak i parë duhet të jetë qenie medoemos ekzistuese (vâxhibu-l-vuxhud), e jo kontingjent, në raport me ekzistencën aksidentale, të mundshme (mumkin). Në të kundërtën, do ta fitoja zinxhirin e pafund të shkaqeve, pa

parafillim. në të vërtetë, e kam prekur pyetjen e kauzalitetit¹, shqyrtimit të njohur filozofik i cili Aristotelin e solli në pohimin mbi parafillimin dhe shkakun e parë. Atëherë asgjë s'kam ditur mbi Aristotelin² as nuk i kam ditur fundamentet e ligjësisë së logjikës dhe dialektikës. Është dashur të kalojnë tridhjetë vjet pune të etshme me libra dhe mijëra net në vetmi, përsiatje e diskutime me vetveten dhe që përsëri ta përmirësoj atë që tashmë sa herë a kam korrigjuar. E kam kundruar idenë nga të gjitha pikëpamjet dhe jam orvatur të kaloj rrugë të mundimshme prej Zotit dhe njeriut deri te enigma e jetës dhe vdekjes, deri te të besuarit e fortë, të cilin, ja, tash, po e ekspozoj. Fatkeqësisht atëherë nuk e kam ditur se ky është ai motivacion. Për këtë kam refuzuar të besoj në Zotin, sepse kam besuar në vetveten. Kam qenë i verbuar me dritën e idesë sime personale dhe zgjimit, i cili ka filluar ta shquajë periudhën e fëmijërisë sime.

Kjo kryesisht, ka qenë gjendja ime psikike kur kam hyrë në diskutimin e përditshëm oratorik dhe ideor. Kam qenë aq i verbuar sa që nuk i kam vërejtur edhe bazat e logjikës në të cilën pikërisht jam mbështetur. Nuk kam qenë i vetëdijshëm se po e kontradiktoj vetveten kur them: E kush e

¹ Kauzaliteti (causalitas), shkathtësia, lidhja shkakore, lidhja objektive, e domosdoshme ndërmjet shkakut e pasojës. Parimi i kauzalitetit është: Çdo ndryshim medoemos duhet ta ketë shkakun e vet.

² Aristoteli (Aristoteles, 384 - 322 p.e.r.) është filozofi më i madh grek, nxënësi i Platonit, mësuesi i Aleksandrit të Madh. Themelues i shkollës peripatetike, i pari ka hulumtuar “lëvizësin e parë” me anë të shkaqeve. Filozofinë e tij e karakterizon luhatshmëria ndërmjet idealizmit dhe materializmit. Me të drejtë e mban ofiqin “magister primus”.

krijoi Krijuesin; - me çka kam rënë në sofizëm³, sepse Krijuesin e kam radhitur në krijesa edhe pse po e quaj Krijues.

Të njihet, mësohet e vërteta nuk ka qenë aspak punë e lehtë, sepse nuk kam dëshiruar që çështjes t'i hyj superficialisht dhe lehtëzi. Mirëpo, po ta kisha dëgjuar zërin e natyrës dhe po të më kishte udhëhequr intuita, do t'i shmangesha diskutimit të mundimshëm dhe intuita ime do të më shpiente kah All-llahu. Por, rasti ka dashur të jem lindur në kohën, në të cilën zëri i thirrjes natyrale është i ngjirur (shterur) dhe mezi dëgjohej. Atë e ngadhënjeu zëri i arsyes, i cili, me disa këmbëngulje dhe abuzime, kaloi në mashtrime. Me fjalë tjera, dëshira që me arsye çdo gjë të kuptohet, deri diku mund të arsyetohet, sepse intelektu njerëzor e sheh vetveten mbi piramidën e të arriturave të veta të mëdha; të dhënë pas të arriturave kulturore në industri, elektricitet, raketa, avionë, nëndetëse. Shkurtimisht, njeriu ka dominuar në det, tokë, ajër, nënujë, e vetveten e ka ngritur se është i gjithmundshëm dhe është bërë arbitër në suazat e arritshme dhe të paarritshme.

³ Sofizmi (sophisma), arsyetim ose përfundim logjik që duket i drejtë nga ana e jashtme, por që në thelb është i gabuar dhe përdoret me qëllim të paramenduar për të shtrembëruar të vërtetën.
- Për dallim nga sofizmi (grek) në tekst shpesh ndeshemi me termin **sufizëm** (sufya), e kjo është doktrinë religjioze në Islamizëm, e cila në perioda të ndryshme historike ka marrë kahje të ndryshme. Tesawufi Islam (siç preferohet të thuhet, shkruhet) s'është asketizmi krishter, as budistik... që të abstenohet nga çdo gjë, të jetojmë në askezë, të mos posedojmë asgjë, përkatësisht s'është të mos posedojmë asgjë, por neve mos të na posedojë asgjë, askush. Me fjalë tjera, sendet, veglat të jenë mjet e jo qëllim.

Që ta shpjegoj me arsye këtë botë në të cilën jetojmë, qysh si i ri i drejtova shkencës. Kam lexuar çdo gjë: prej Shibli Shumejlit e Selame Musaut deri të Frojdin e Darwinin. E pëlqeva kiminë, fizikën dhe biologjinë. Në dhomën time të vogël kam pasur laboratoriumin miniaturial, në të cilin i kam përgatitur acidet karbonike, me klor i kam mbytur insektet dhe i kam autopsuar bretkosat. Të gjitha bindjet e mia kanë filluar dhe kanë mbaruar në bazat shkencore. Njohja objektive është rruga e vetme kah e vërteta. E kam refuzuar çdo teori metafizike.

Kam menduar; kush po na i jep tanket dhe avionët, ndërsa po i merr prej nesh fetë orientale dhe ritualet? Lajmet shkencore perëndimore na kanë verbuar dhe prej Perëndimit e kemi pranuar çdo gjë që na ka ofruar: librat, ilaçet, veshjen, pëlhurat, lokomotivat dhe automobilët, e madje edhe konservat, lapsat, paramanat dhe gjilpërat. Prej tyre i kemi pranuar edhe format e hulumtimit letrar dhe i përvetësuar format e tyre të tregimeve, romaneve dhe veprave dramatike. Kemi ëndërruar mbi Pasterin, Markonin, Rentgenin dhe Edisonin dhe në ta i kemi parë idealet tona. Shkurtimisht, çdo gjë që është nga Perëndimi e kam konsideruar përparimtare, e çdo gjë që ka ardhur nga Orienti islamik, prapanike, dekadenciale. Orienti ka qenë i venitur, dobësuar dhe nën thundrën e kolonizatorit.

Ka qenë kjo, deri diku, edhe e natyrshme, duke i marrë në konsiderim kushtet e atëhershme të të kuptuarit tim, se çdo gjë që na e servon Përëndimi është pozitive dhe e vërtetë dhe se përvetësimi i mënyrës së tillë evropiane të jetesës, është rruga e vetme e fuqisë dhe shpëtimit.

Jam regjistruar në Fakultetin e Mjekësisë që atje t'i ndjek ligjëratat në gjuhën angleze, që ta studioj anatominë nga burimet angleze dhe në spital me profesorët e mi të flas në gjuhën angleze. Jo për atë pse anglezët kanë qenë në Kanalin e Suezit, por për arsye se medicina e re, si shkencë, tash ka

qenë produkt ekskluziv i Përëndimit. Atë që e kanë dhënë arabët dhe popujt islamikë në kohën e Ibni Sinasë (Avicennës)⁴, ato kanë qenë konceptet, nocionet elementare të pamjaftueshme për nevojat bashkëkohore të njerëzisë. Me fjalë tjera, evropianët e kapën fijen atje ku e lëshuan Ibni Sinâa dhe mjekët tjerë arabë dhe e vazhduan me mundësitë zhvilluese që ta përparojnë shkencën e medicinës, krijuan laboratoriume, deponuan me miliona funta në hulumtime dhe i tejkaluan arabët, persianët e të tjerët dhe e krijuan medicinën bashkëkohore, fiziologjinë, anatominë dhe patologjinë dhe me të drejtë në këtë shkencë e zunë vendin e parë.

Kështu kam hyrë në botën e medicinës dhe teorive shkencore dhe kam ardhur deri te mendimi e bindja se mbi asgjë nuk duhet gjykuar pa eksperiment dhe pa fakte e dëshmi. Shkenca zë fill në empirizëm⁵, që shifet dhe dëshmohet. Ajo që me shqisa nuk mund të argumentohet, për

⁴ Ibn Sinâ (Ebu Alij Husein ibn Abdullah Ibn Sinâ, 370/980 - 428/1-37), në Përëndim më i njohur si Avicenna, ka poseduar njohuri enciklopedike si në gramatikë, gjeometri, fizikë, medicinë, teologji ashtu edhe në shkencat tjera, Shkroi mbi 242 vepra, shqyrtime, traktate. Shkencën e vendosi në fundamente empirike dhe e ndau nga metafizika, me mundësi bashkëpunimi. Edhe pse Toma Akuini, parimisht. Avicennën e konsideron filozof platonik, edhe përkundër asaj se është i vetëdijshëm për vendin të cilin në sistemin e tij e zë kritika e aristotelit Platonit, edhe vetë në diskutimet e veta shpesh thirret në Ibn Sinën. Pra, ai është filozof, krijues origjinal i cili me sukses i lexoi, përpunoi dhe vlerësoi të arriturat helenase, persiane e tjera.

⁵ Empirizmi (empiria), rrymë filozofike që pranon si të vetmin burim të dijes perceptimin me anë të shqisave, përvojën dhe praktikën dhe që nënvlerëson ose mohon krejt rëndësinë e të menduarit abstrakt dhe të përgjithësimeve teorike.

shkencën nuk ekziston. Kuptimeve metafizike botës transcendentale (gajbit) nuk i kushtohet kurrfarë kujdesi në botën shkencore.

Kështu në botën e njohurive dhe bindjeve të mia fetare e fillova rrugën time prej të kuptuarit tim të pastër shkencor, materialist. Mirëpo, përkundër rrebeshit materialist dhe empirik të kësaj bote, të cilët mohojnë çdo gjë që është transcendentale, nuk kam arritur ta mohoj dhe mënjanoj fuqinë hyjnore.

Me fjalë tjera, shkenca mua ma prezentoj gjithësinë si diç që ekziston në rendin e përkryer, çdo gjë: prej gjetit në dru deri te krahu i fluturës dhe rëra e rërishtes - çdo gjë është në marrëdhënie, rend dhe bukuri të përkryer. Tërë kozmosi ekziston mbi ekuilibrin dhe ligjësitë precize. Prej grimcës së atomit e deri te sistemi qiellor, deri te gallaksia që përmban miliarda - sisteme qiellore të pakufishme mbi të cilat na flet astronomia - të gjitha këto lëvizin në rregullin e pacenuar dhe llogarinë precize. Mbarë kjo botë e paskajshme, prej elektronit të imët deri te trupi më i madh qiellor, i ngjan aries (melodisë) së shkëlqyeshme harmonike, akordet e së cilës janë jashtëzakonisht të harmonizuara mirë, si një trup i tërësishëm, i cili ka shpirt... Shkenca, tash më ka dhënë mundësi ta përfytyroj All-llahun në mënyrën materialiste.

Atëbotë, në epokën time të atëhershme ideore zhvilluese, kam përfytyruar se All-llahu është fuqia e brendshme e gjithësisë, e cila drejton të gjallët e jotëgjallët. Tokën e Kozmosin. E kam përfytyruar Atë në të lëvizurit atomik, të cilat shkenca i pat zbuluar në protoplazmë, në gjithësi, se

Ai është ajo fuqi e brendshme krijuese në çdo gjë ose, siç e ka thënë këtë Shën Toma Akuini⁶:... proces i cili ka filluar të zhvillohet në mikrob që prej tij të krijohet njeriu. Ky proces edhe më tej po zhvillohet dhe do të zhvillohet në infinit (pafundësi).

Ekzistenca⁷, çdo gjë që ekziston, sipas të kuptuarit tim të atëhershëm, nuk ka pasur fillim as fund, sepse ekzistencës ka mundur t'i kundërvihet vetëm joekzistenca, e këtë logjikisht nuk kam mundur ta sqaroj sepse do të gjendesha para pyetjes: e kush e krijoi botën!? Me fjalë tjera, nëse do ta pranoja supozimin se dikur bota nuk ka qenë, si ta shpjegoj se diç është krijuar prej asgjëse? Për këtë kam konkluduar: çdo gjë që sot ekziston, ka ekzistuar kaherë, do të ekzistojë përherë, e pakufizuar hapësinërisht dhe kohërisht.

Kështu duke e kuptuar të ekzistuarit e kësaj bote e pranova hipotezën se All-llah është çdo gjë që është rreth nesh dhe se ne jemi vetëm emancion, manifestim i Tij. Ai është ekzistencë materiale, e pafillim e pambarim, i përhershëm.

Në këtë mënyrë ia kam përfytyruar vetvetes teorinë e cila është kufizuar në ekzistencë dhe All-llahun e ka identifikuar me ekzistencën. Më nuk kam pasur nevojë të shërbehem me metafizikë dhe të gjej strehim te e padukshmja, transcedentalja.

⁶ Shën Toma Akuini (1225 - 1274), një ndër figurat më të njohura të doktrinës krishtere. Shkrimet e tij, thënë në mënyrë sumare, më tepër janë koment të elementeve idealiste të Aristotelit të harmonizuara me parimet e metafizikës së tij religjioze. Edhe pse teorikët krishterë e tjerë i ikin, është i dukshëm ndikimi i disa filozofëve islamë, si Ibni Sinnës, Ibni Rushdit (Averoesit, 1126 - 1198) e tjerë.

⁷ Ekzistenca (existentia), Qenia në jetë, të qenët e dikujt e të diçkahit, gjykim sintetik i cili tregon se diç ekziston.

Për këtë arsye pata rënë në grackën e idesë së “monizmit ekzistencial”, panteizmit indian dhe filozofisë panteiste të Spinozës⁸, ose në grackën e filozofisë së Bergsonit mbi “fuqinë e brendshme krijuese”, e të gjitha këto janë filozofi të cilat janë nisur prej Tokës, prej pesë shqisave dhe nuk kanë pranuar kurrfarë metafizike - sekreti, manifestimi të kuptimit logjik.

Filozofia indiane shkon edhe më tej prej kësaj dhe e mohon dualizmin ndërmjet Krijuesit dhe të krijuarës. Sipas saj, krijesat janë vetëm emanacion i Krijuesit. Sepse, në librat Upanishad⁹ zoti Brahma, i cili e banon qendrën e botës, pëshpërit:

“Nëse dorasi (vrasësi) mendon se është doras, e i vrari se është i vrarë, ata nuk i dinë metodat e mia sekrete, sepse të vdekurin e pranoj në mbrojtjen time, si edhe armën e vrasësit dhe krahun e

⁸ Spinoza (Baruh de Spinoza, 1632 - 1677), filozofia e të cilit karakterizohet me idenë se Zoti dhe natyra është e njëjtë, një (dens sive natura), e sendet dhe fenomenet në botë janë vetëm çaste të Gjithëjetesës së Zotit, sipas së cilës, pra, Zoti dhe bota nuk qëndrojnë në relacion si krijues dhe send i krijuar. Me fjalë tjera, në filozofinë e vet e rekomandon tezën mbi autonominë e natyrës dhe “bashkimin e botës” (wahdetu-l-wuxhud), përkatësisht determinizmin monist, apo monizmin ekzistencial.

⁹ Upanishade, emri i traktateve, shqyrtimeve të shumënumërta hinduse me përmbajtje filozofike dhe rituale, janë (bashkë me Brahmanet) pjesë të vedeve, edhe pse jo aq të shenjta, megjithëse autotentike. Upanishadet, sikur edhe letërsia e vjetër indiane, janë përcjellë gojërisht nëpër gjenerata. Zoti Brahma është zoti suprem i panteonit hinduist, i cili me tërë fotografinë e konstituimit të qiellit është marrë edhe si prapavijë mitologjike e budizmit; parimi universal i gjithpërfshirshmërisë, posaçërisht në vedânt. Ekzistenca gjithpërfshirëse. respektivisht absoluti më atë anë ekzistencës dhe joekzistencës, atributi themelor i të cilit është neutraliteti kundruall ndarjes subjektiv-objektive të vetëdijes njohëse dhe identiteti me amanin (subkoshiencën) (vedantah).

fluturakes. Në mbrojtje e pranoj edhe atë kush dyshon në ekzistencën time - çdo gjë e pranoj, e madje edhe vetë dyshimin, e pranoj atje ku unë jam i vetmi. Unë jam çdo gjë”.

Ky është zoti i cili i ngjan dritës së bardhë... një dhe i natyrshëm, por në vete përmban shtatë ngjyrat (spektrale) të ylberit.

Me vite kam jetuar në këtë mjegull indiane dhe bufoneri sofistike. E kam praktikuar jogi-n¹⁰, dhe për të kam lexuar burimisht dhe kam studiuar te profesorët indianë. Gjatë më ka preokupuar dhe përvetësuar ideja mbi inkarnimin e shpirtit,¹¹, e madje edhe është manifestuar në disa krijime të mia letrare, siç është “Marimanga” dhe “Dalja prej arkivolit”.

Pas kësaj, pak nga pak, fillova të vij në vete, sepse nuk isha i bindur se shpirti mund të kalojë prej trupit në trup. Ia pranova vetvetes se botëkuptimi im i këtillë mbi Zotin nuk është bindës dhe se është konfuz i turbullt.

¹⁰ Joga (yoga), filozofia indiane, një prej gjashtë sistemeve të filozofisë indiane autori i së cilës kinse është Patanjali; besohet në ekzistimin e një parashpirti, dmth, hyjnie, dhe synohet inkarnimi me këtë hyjni e kënaqësive ndijore, me shtrëngimin e trupit, me mbajtjen e frymëmarrjes, koncentrimin intelektual dhe disiplinën morale; inkarnimi i arritur shpie deri te të kuptuarit e Permanentit, të pastruarit dhe të shpëtuarit të shpirtit;...

¹¹ Inkarnimi (incarnatio), mishërim, personifikim; kur ka të bëjë me budizmin, xhainizmin e tjerë më adekuat është të përdoret termi “karma” që është ligj i shkakësisë etike, dhe sipas këtij ligji njeriu pas vdekjes kalon në formë të re të ekzistencës i cila domosdoshmërisht është i kushtëzuar me vetë karmën.

Për herë të dytë iu ktheva shkencës si udhëheqësit dhe shpëtuesit tim. Ajo nëpërmjet autopsisë biologjike dhe nën mikroskop më tha diç tjetër. Me fjalë tjera, “monizmi ekzistencial” indian është shpjerë në këngët liturgjike sofistike, por ireale, të pavërteta, deri sa shekna ma konfirmoi vetëm unitetin, identifikimin në materien fundamentale (të botës), në lëndën e parë, uniteti në fundamentin themelor dhe ligjësitë themelore, uniteti në materien origjinale, fillestare prej së cilës çdo gjë është ndërtuar. Çdo gjë që jeton: flora (bimët), fauna (shtazët), njerëzit, janë formuar prej kombinimit të karbonit me hidrogjenin dhe oksigjenin. Për këtë ata me të djegur shndërrohen në thëngjill. Së këndejmi dimë se të gjitha llojet e jetave janë me prejardhje nga një qelizë.

Duke u shërbyer me shkencë mësojmë nga astronomia, kimia dhe atomistika se vetë karboni, si edhe të gjitha elementet tjera, është produkt i një elementi të caktuar, i cili është zier shumë në stufat e mëdha të yllëzuara, e ky është hidrogjeni. Me fjalë tjera, hidrogjeni në brendësi të stufave yjore shndërrohet në helium, karbon, sicilium, kobalt, nikël, hekur ose në elemente tjera varësisht prej ndarjes dhe bashkëdyzimit të tyre të sërishëm në shkallët e caktuara të temperaturës dhe fuqisë së shtypjes. Thënë me fjalë të tjera, të gjitha llojet e krijesave rrjedhin prej materies unike, fijëzës unike të mëndafshit, prej të cilës është ndërtuar gjithësia, në format, detajet, figurat e saj të ndryshme e tjera. Dallimi ndërmjet njerit dhe tjetrit lloj, ndërmjet njëres dhe tjetres krijesë shpjeret vetëm në raportin, marrëdhëniet e kualitetit dhe kuantitetit, në përpjesëtime dhe të modeluarit e tyre, por lënda e parë është e njëjtë. Kjo është fshehtësia e cila na zbulon krushqinë, afërsinë, ngjashmërinë ndërmjet njeriut dhe shtazëve, zbutësit të kafshëve dhe kafshës së egër, ndërmjet hundës që nuhat dhe lules aromatike, ndërmjet syrit dhe pamjes së shkëlqyeshme të diellit duke perënduar. Këtu qëndron sekretin e kësaj harmonie dhe rregullit të gjithësisë. Çdo gjë që ekziston janë anëtarë të një familjeje, kanë rrjedhur prej një babai.

Natyrisht se konkludimi i këtillë nuk pretendon që të konfirmojmë se si All-llahu është identifikim njësoj, çka edhe ekzistenca ose se çdo gjë që ekziston njësoj është çka edhe Krijuesi, sepse këto janë ngatërime të rëndomta mistike, të cilat nuk mund të prëvetësohen. Thënë ndryshe, nëse këtë botë do të dëshiroja të tregoj, në mënyrë plastike do t'ia krahasoja përjetimit të kritikut (artistik) figurativ të entuziazmuar, i cili e ka vizituar ekspozitën piktorale dhe ka zbuluar se të gjitha ekspozitat janë pikturuar me shprehjen e njëjtë artistike, prej materialit dhe ngjyrërave të njëjta. E natyrshme është që kritiku, në këtë rast, të mendojë se të gjitha pikturat janë prej penelit (furçës) të artistit të njëjtë dhe se kjo është vepër e një Pikaso, Shagali ose Modilani. Uniteti i të krijuarës tregon edhe në unitetin e Krijuesit, por kjo njëkohësisht nuk do të thotë se krijesat janë çka edhe autori i tyre, përkatësisht se krijimet e artistit (pikturat e tij) janë çka edhe vetë piktori.

Prandaj, teoria indiane mbi “unitetin e botës” është mashtrimi, paragjykimi më i thjeshtë mistik, i cili shkencërisht nuk mund të jetë i konfirmuar as që mendja e shëndoshë mund ta pranojë. Mirëpo, shikimi studioz shkencor mbi manifestimet e krijimit dhe të krijuarës, na drejton në lidhshmërinë dhe unifikimin e të gjitha krijesave. Forma, stili i tyre i njëjtë, ligjësitë e njëjta të tyre, uniteti i lëndës së parë (materies) të tyre prej së cilës janë të ndërtuara, të gjitha këto dëshmojnë se këtu ka të bëjë me një Krijues, se nuk ka shok, kompanjon, sepse, përndryshe, edhe stili i krijimit do të ishte i ndryshëm.

Vështrimet e këtilla na udhëzojnë në atë se ky Krijues është intelekti universal (akl-un kul-lij-un), se Ai ua jep inspirimin krijesave të veta dhe i drejton në rrugën e tyre zhvillimore, dhe se Ai i furnizon me mjetet për të ekzistuar në këtë botë. Ai është i cili i dhuron krahë farës së drurit shkretinor në mënyrë që të fluturojnë shkretëtirën e shkretë e të arrijë në oaza ku do të gjejë

kushte të përshtatshme për shumëzimin e vet. Ai është i cili e krijoi vezën e mushkajës me dy cipa në mënyrë që të notojë mbi ujë dhe të mos fundoset. Dhe, po mos të ishte Ai, mushkaja nuk do të mund ta dinte ligjin e Arkimedit dhe t'ia vendosë mbështjellësin dystrajcor vezës së vet.

Pra, All-llahu është ajo Arsyeja e Gjithdijshme dhe Gjithpërfshirëse, ai intelekti Universal, i cili secilës krijesë ia jep kushtet e jetës, Krijues i cili është mbi krijesat e veta, di çka ato nuk dinë, mundet çka ato nuk munden, sheh çka ato nuk shohin. Ai është Një, i Vetmi, i Gjithfuqishmi, i Gjithdijshmi, Gjithdëgjuesi, Gjithinkuadruesi, Githpamësi, Gjithlajmëtar. Ai është i cili jep attribute, ndërsa Ai është i paatribuar.

E pandërprerë dhe e vazhdueshme është lidhja ndërmjet këtij Krijuesi dhe krijesave të Tij; Ai u është më i afërt sesa gjaku i tyre personal i cili nëpër ta qarkullon. Ai e ka krijuar dhe harmonizuar këtë këngë shumë të bukur kozmike. Ai është i Drejti i cili i ka krijuar ligjësitë kozmike dhe deri në detaje i ka bërë të sakta e të pagabueshme.

Ja, këtë pasqyrë të plotë, më vonë, mbi All-llahun ma dha shkenca.

Çdo gjë që ekziston në gjithësi, ka ndodhur. Në këtë na udhëzon leksikoni shkencor i cili këtë na e shpjegon në të ashtuquajturin ligjin e dytë të dinamikës termike. Me fjalë tjera, ky ligj e përkufizon ngrohtësinë dhe ndryshimet e saj prej të ngrohtës në të ftohtë, prej ngrohtësisë së lartë në të ultën deri sa dy nivelet nuk barazohen dhe pushon ndryshimi termik.

Në bazë të këtij ligji shkencor nxjerrim përfundim logjik: nëse kohën nuk e kufizojmë dhe nëse gjithësia do të ishte permanente pa fillim, alternativiteti i ngrohtësisë dhe ftohtësisë ka herë do të

merrte fund, e me këtë edhe të gjitha format e jetës. Të gjithë trupat qiellorë do të ngriheshin dhe me këtë çdo mundësi e jetës do të merrte fund.

Pikërishtë këtu, pra, na qëndron dëshmia mbi të zënët fill (krijueshmërinë) e gjithësisë, respektivisht e tërë asaj që ekziston.

Nga ana tjetër, zhdukjet alternative nga faqja e Tokës dëshmitarë të së cilës jemi: zhdukja e kulturës, vdekja e individëve, zhdukja e trupave qiellorë, bimëve dhe shtazëve, kalueshmëria kohore, ajo rrugë e domosdoshme e çdo gjëse që ekziston dëshmon se gjithësia do të përfundojë në shkatërrimin e madh, në ringjalljen e madhe.

Shkenca e vërtetë, jotendencioze kurrë nuk ka qenë në kundërshtim me fenë. Përkundrazi, e ka përmbajtur dhe e ka argumentuar. Gabimi është në këtë se dituria sipërfaqësore, gjysmë shkenca e shpie arsyen e shëndoshë në dyshim dhe josiguri. Posaçërisht kjo manifestohet kur ka të bëjë me arsyen e cila është vetëmohuese dhe krenare dhe kur zhvillohet diskutimi në kohën kur arsyeja kundrohet si qëllim dhe synim i çdo gjëje. E kjo është pikërisht epoka e sotme, koha në të cilën kultura materiale i ka bërë hije çdo gjëje tjetër, koha në të cilën njeriu është i rrethuar me avionë, satelitë, dhe anije kozmike, dhe tërë kjo me zë të lartë bërtet:

“Unë jam materia, unë jam çdo gjë!”

TRUPI I NJERIUT

Të gjithë rrjedhim prej një burimi, të njëjtit trung, prej të njëjtës materie, por çdonjëri e posedon personalitetin e vet, individualitetin e vet. Sepse, dallimi ndërmjet njëres dhe tjetres krijesë, nuk është vetëm kuantitativ, në numrin e grimcave materiale, por ky dallim është edhe më i madh më i ndërlikuar në marrëdhëniet dhe mënyrën e lidhjes së këtyre pjesëzave.

Sot, për shembull dimë nga embriologjia se të gjitha qelizat e embrionit trashëgues të njeriut përbëhen prej proteinave të ndryshme të shënuara me njëzet formula kimike (NDA - RNA), diç e ngjashme sikur edhe abeceda, me të cilën janë shkruar libra dhe hartime. Në këtë mënyrë, edhe pse të gjitha librat (njëgjuhësore) janë të shkruara me shkronjat e njëjta, secili libër - në rastin tonë secili njeri - do ta ketë shpirtin e vet, personalitetin e vet dhe kualitetin si krijesë e veçantë, dhe pavarur. Kjo veçanti e njeriut shkon deri atje sa që secili njeri ka shenjë të veçantë të gishtit. Nuk ekziston ngjashmëri midis dy shenjave edhe sikur të ketë të bëjë edhe me bineqet. Kështu kjo vazhdon prej njeriut të parë.

Ose, ta marrim shembullin tjetër, dimë se cili organizëm njerëzor e ka “shifrën e vet personale kimike”, kështu që është mjaft vështirë, e nganjëherë dhe e pamundur, të transplantuarit e pjesës së trupit nga njëri në trupin tjetër njerëzor. Ai, së shpejti, e refuzon trupin e huaj, sikur ky është mikrob dhe për të krejtësisht i huaj. Ky dëbim paraqet problemin më të madh në kirurgjinë plastike dhe në të transplantuarit e organeve të trupit. Na është e njohur se, përkundër gjilpërave

anestezike dhe barërave të vazhdueshme kundër refuzimit të trupit të huaj, zemra e transplantuar më e suksesshme ka jetuar vetëm diç më shumë se njëzet muaj¹².

Tërë kjo na tregon se individualiteti dhe veçantia personale është e vërtetë qenësore, shkencërisht e argumentuar - e vërtetë të cilës, në fillim të këtij zhvillimi ideor, nuk i kam kushtuar kujdes. Kam besuar se e rëndësishme dhe qenësore është shoqëria, bashkësia, e jo individi, njeriu, se e rëndësishme është jeta, e jo qeniet e gjalla, shoqëria, e jo anëtarët e saj. E vërteta, të kuptuarit e tillë ka qenë refleksi, jehonë e filozofisë sime indiane mbi “panteizmin” (vahdetu-l-vuxhud) më herët të përvetësuar, e pastaj të lënë, e cila tërë botën fenomenale e identifikon me All-llahun, se ai është i vetmi i gjithmonshëm (permanent), e të gjitha krijesat tjera janë “MAYA”¹³ dmth. mashtrime kaluese. Sipas saj, njerëzit pakthyesëm vdesin, zhduken dhe nuk do të ringjallen. Për këtë edhe unë kam besuar se njeriu është i amshueshëm aq sa i edukon fëmijët e vet, i udhëzon dhe i mëson. E sa i përket vetë personalitetit të tij, ai pakthyesëm shndërrohet në pluhur. Kujtimi ynë do të zgjasë aq sa të kontribuojmë për çështjen e përgjithshme. Mirëpo, personalitetet tona - fati i tyre është që të zhduken.

Por, ç'është personaliteti?

¹² Duke e marrë parasysh se botimi i parë i kësaj vepre është lajmëruar më 1970, këto rezultate duhet kuptuar në kontekstin historik të asaj kohe; sot është shkuar mëtej në këtë plan.

¹³ “Mâyâ”, iluzion, mashtrim (në vedant) sipas së cilës fenomenalja na duket si e vërtetë definitive, sipas së cilës ajo që është absolute dhe e pandashme na duket relative dhe e ndashme. Mâyâ e mbulon të pamurit tonë kah e vërteta më e lartë. Ajo është fundamenti vegues i botës fenomenale. Do të thotë edhe fuqia mbinatyrore e zotërave.

Në fillim të formimit të konceptit tim mbi personalitetin nuk kam ditur më shumë se, individualiteti është reaksion i përkohshëm në qëndrimet e përkohshme dhe, në pajtim me këtë, kur të zhduken përkohshmëritë dhe të ndyshohet koha, prej këtij personaliteti nuk mbetet asgjë. Fundi i tij vjen me pleqërinë, kur të vijë deri te sahatërrimi i tij si pasojë e shkatërrimit të sistemit nervor në tru. Kur nervat pas vdekjes të kalben dhe të zhduken, do të zhduken edhe personalitetet të cilit i kanë takuar.

Thënë më mirë, kam besuar se termi personalitet është sinonim për karakteristikat e caktuara të njeriut të formuara nën ndikimin e përvojës aktive dhe aksioneve nervore reflektive prej të cilave disa janë trashëguar në trajtë instinkti, e disa janë arritur me përvojat e shqisave, të cilat nëpërmjet trurit janë regjistruar dhe me memorie janë mbajtur mend. Dhe, kur pushon së punuari truri dhe qelizat e tij memorike vdesin, nuk ka nevojë të supozojmë njëfarë vazhdimi spiritual të këtij funksioni të pastër material.

Kështu, në fillim, sipërfaqësisht në mënyrë materialiste e kam përfytyruar njeriun. I kam folur vetvetes se një personalitet nuk është i veçuar, i determinuar; ai s'është asgjë përpos shirit rrjedhës i personaliteteve të ndryshme e të shumënumërta. Kështu për shembull personaliteti im nga koha dhjetëvjeçare nuk është i njëjtë sikur edhe ai kur i kam pasur njëzet, e sërish tjetër prej atij kur i kam pasur tridhjetë. në çdo çast personalitetit tim diç i është shtuar, e diç i është marrë. Kam pyetur vetveten se cili personalitet do të ringjallet dhe në botën tjetër do të dënohet?

Kjo lojë fjalësh, për të cilën atëherë s'kam qenë i vetëdijshëm, më ka bërë të harroj shembullin nga jeta e kësaj bote që, kur ta shtypim botimin e dytë të ndonjë libri, atëherë nuk e shtypim vetëm një faqe ose kaptinë të tij, por i shtypim tërësisht të gjitha pjesët e tij.

Rasti i tillë do të jetë edhe me shpirtin: do të ringjallet me të gjitha kaptinat dhe detajet e tij, sikur që fara, e mbjellë në gjiun e tokës i përmban të gjitha kushtet dhe mundësitë që prej saj të zhvillohen edhe kërcylli edhe gjethet edhe fruti.

Mirëpo, teoria materialiste e cila sipas natyrës së vet është e dhënë kah detajizimi, obdukcioni dhe shkoqitja, gjithnjë më është imponuar, prandaj kam harruar që gjerat t'i shikoj në tërësi dhe absolutisht. Më dukej se shpirtin mund ta kuptoj nëse e studioj dhe analizoj trupin, dhe se midis këtyre dy nocioneve nuk ka kurrfarë dallimi: shpirti është trup, arsyeja tru, e personaliteti asgjë tjetër përpos reaksion dhe grumbull i qëndrimeve refleksive, se disponimi dhe simpatia, tekefundit, janë uri trupore, fizike.

Të ndalemi tash në këtë çështje: a është e saktë se njeriu është grumbull ngacmimesh në uri, seks dhe një sërë ndjenjash me të cilat trupi i njeriut i njeh nevojat e veta? Nëse këtë do ta pranoni, do të gjendeshim para shpjegimit materialist, e kjo nuk është qenësia as e shpirtit as njeriut - para temës të cilën hollësisht e kam diskutuar në dy veprat e mia “Enigma e vdekjes” (“Lagzu-l-mewti”) dhe “Enigma e jetës” (“Lagzu-l-hajâti”). Sepse, e sakrifikon kafshatën, shtëpinë dhe shtratin e vet të ngrohtë për qëllime më të larta, të cilat e privojnë nga shumë gjëra: e flijon këtë për drejtësinë, të vërtetën, të mirën e përgjithshme dhe lirinë. E ku janë këtu ngacmimet për uri dhe seks? Ose për shembull luftëtari në front, i cili mbi topin e vet flijohet për të nesërmen më të mirë, që do të pasojë? Ku është këtu shpjegimi materialist i trupit të njeriut?

Pra, është e vëndite se qenësia e njeriut, komponentet e tij përbërëse, e tejkalojnë kuptimin e atij fizik, substancor dhe se qenësia e tij nuk përbëhet vetëm prej nevojave fizike, fiziologjike, të cilat tek ai reflektohen. me fjalë tjera, ky vendim madhështor i njeriut që trupin e vet ta flijojë dhe

urrejë, ky është manifestim që flet se ai e qeveris, e sundon trupin, e jo trupi atë. Nga ana tjetër, nëse “unë” jam trup, si mund ta sundoj trupin dhe ta nënshtroj? Ose, thënë më qartë, nëse “unë” jam uria, si mundem që të detyrohem në uri? Pra, është evidente se të ekzistuarit e atij “kontrolluesi” të brendshëm të njeriut mbi elementet dhe instinktët trupore, është argument i qartë mbi të ekzistuarit edhe të elementit tjetër, më kualitativ, i cili e përbën pjesën përbërëse të trupit të njeriut. Nëse dimë që nëpërmjet shpirtit ta sundojmë trupin, që me arsye t'i rregullojmë dëshirat tona, që nëpërmjet kundërimit të hollësishtëm t'i vëmë kufijtë e arsyes - ky shkallëzim i parësorës dhe sekundaes e vërteton faktin i cili është më kualitativ se trupi i njeriut dhe e sundon atë, nuk i është nënshtuar dhe me trupin nuk vdes.

Atë i cili do të provonte dhe përpiqej të na shpjegonte se si njeriu është grumbull i nevojave materiale fiziologjike, do ta lusnim të na shpjegojë ku shkon ai njeri gjatë kohës së gjumit? Me fjalë tjera, atëherë, deri sa ai flen, tek ai edhe më tej kryhen proceset fiziologjike, të gjitha reflekset dhe ndërdija funksionojnë pa kurrfarë pengese. Zemra rekon, frymëmarrja funksionon gjëndrat sekrecojnë, organet digjeste punojnë, dora nga të shpuarit me gjilpërë dridhet. Dhe, përveç këtyre, ne para atij që është në gjumë jemi sikurse para drurit ose, thënë më mirë, para qenies primitive, e cila nuk dallohet prej insektit primitiv. Ku është këtu njeriu?

Gjendja alternative e gjumit dhe zgjuarësisë së njeriut, në të vërtetë, shembulli i zbehtë i vdekjes dhe ringjalljes, edhe një herë na konfirmon të ekzistuarit e atij elementi fisnik, shpirtit, në organizmin e njeriut. Me fjalë tjera, ky element me prezencën e vet në trupin e përgjumshëm, momentalisht dhe pa hyrje, e krijon Hitlerin ose Neronin, e ky trup i shtrirë zgjohet që të vrasë, sulmojë, rrënojë dhe zhdukë. Dallimi ndërmjet këtyre dy gjendjeve të organizmit të njeriut është tepër i madh që të mund të sqarohet me ndryshimet materiale momentale.

Materialistët thonë se shpirti është e vërtetë objektive, që do të thotë se është materie. Ne pyesim si mundet shpirti të jetë objekt dhe, nëse ky është, në raport me kend është objekt? Në raport me të tjerët?! me të tjerët nëse ata nuk e shohin?! Ata mund ta njohin të ekzistuarit e tij në bazë të manifestimeve, e këto manifestime, në të shumtën e rasteve janë të rrejshme dhe nuk janë autoritative. Sepse, prej përvojës dimë se të tjerëve, kryesisht, iu “shtiremi”, e madje edhe vetvetes. Nga kjo është e qartë se këto manifestime të jashtme do të jenë joreale.

Ose, shpirti është objekt i trupit, të vetë njeriut? Nuk është as, kjo, sepse të gjithë e dimë se shpirti nëse e kundrojmë si objekt nën neshterin analitik (thikën kirurgjike) do të transformohet në trup, do të tretet dhe fshihet. Këtë për shkak sepse ai nuk mund të jetë objekt, as të vendoset nën mikroskop si gjethi i drurit, sepse ai është substancë, para së gjithash për arsye se është subjekt. Thënë ndryshe, ai është fytyra tjetër e fotografisë, ai është subjekt në raport me trupin i cili është objekt. Në realitet, ky subjekt dhe objekt i përbëjnë polet e të vërtetës së njëjtë. Dhe, nëse e definojmë materien se ajo është çdo gjë që është objektive, me shqisa e kuptueshme, duhet të pranojmë se në botën kuptimore, abstrakte (vuxhud) ekziston edhe diç tjetër përveç materies, ana tjetër e të vërtetës, e ky është subjekti.

Perceptimi, vrojtimi, do të na shpie kah njohja e fuqishme se në çdo çast ekzistojnë dy gjëra: objekti njohës dhe shpirti me të cilin njihet, e gjendet jashtë objektit. A thua, për shembull, kalueshmërinë kohore do të mund ta kuptonim po të mos ishte ajo fuqi njohëse, e vendosur në këndin e izoluar të kësaj rrjedhe të vazhdueshme kohore. Po të lëvizte vazhdimisht me treguesin sekondar, kurrë nuk do të mund t'i njohim as kuptojmë ato sekonda. Njohja jonë do të zhdukej njëkohësisht me kalimin e sekondës. Më në fund, kjo ligjësi është e njohur mirë: se lëvizjen mund ta vërejë vetëm ai i cili është jashtë saj, kush nuk merr pjesë në të. Për këtë arsye, për shembull

nuk mund ta ndejmë lëvizjen, nëse njëkohësisht edhe ne lëvizim, nëse jemi në orbitën e njëjtë. Duhet të gjendemi jashtë lëvizjes që të mund ta vërejmë atë. Nuk do ta ndejmë, për shembull, lëvizjen e ashensorit deri sa jemi në ashensorin lëvizës, sepse jemi bërë pjesë e masës lëvizëse. Por, këtë lëvizje menjëherë do ta hetojmë nëse nëpërmjet vrimës në ashensorit shikojmë në ndonjë pikë ose trup i cili është në qetësi. Po ashtu, e pamundur do të na ishte ta vërejmë lëvizjen e Diellit nëse në të do të gjendeshim, por këtë lëvizje do ta vërejmë nga Hëna ose Toka. Sipas ligjësisë së njëjtë nuk mund ta vërejmë lëvizjen e Tokës derisa jemi në të, por këtë është lehtë ta vërejmë nga Hëna.

Pra, është e pamundur të kuptohet gjendja personale derisa gjendemi në të por ajo është menjëherë e kuptueshme nëse e vështrojmë nga jashtë, si objekt. Ligjshmëria e njëjtë ka të bëjë edhe me rrjedhën e kohës: që ta njohësh, subjekti yt njohës duhet medoemos të jetë jashtë rrjedhës kohore.

Në bazë të mëparshmes vijmë deri te konkludimi interesant: se shpirti ose subjekti njohës është ekzistencë e veçantë, kohësisht i pavarur dhe me të i palidhur.

Në këtë mënyrë u gjetëm para të vërtetës së njeriut: një pjesë e tij është e lidhur për kohën dhe zhduket me të. Kjo pjesë e tij me kohën bëhet, rritet dhe vjetërohet, e ky është trupi. Pjesa e dytë e kësaj të vërtete, është jashtë kohës. Ajo pjesa e dytë, shpirti, e vështron kohën nga pika jolëvizëse kohore dhe e njeh atë e në rrjedhën e tij nuk merr pjesë. Për këtë kjo pjesë e të vërtetës së njeriut nuk rritet, nuk vjetërohet as nuk zhduket. Dhe, atë ditë kur trupi të shndërrohet në dhe,

ajo pjesë e mban veçantinë e vet, mbetet e gjallë me jetën e vet të veçantë, me kohë të pacaktuar¹⁴.

Për pjesën e dytë të njeriut nuk kemi emër tjetër përpos atij, të cilin ia kanë dhënë fetë, e ky është shpirti.

Të gjithë ne në vetvete mund të ndjejmë të ekzistuarit e shpirtit, si edhe këtë se ky ekzistim, sipastributeve të veta, në lidhje me ndryshimet e jashtme të përditshme dinamike të botës fenomenale, është tjetër. Të gjithë mundemi që thellë në vete ta ndjejmë prezencën permanente të diçkahit që është krejtësisht e kundërt me ekzistencën relative, të jashtme pulsive. ky përjetim i brendshëm, të cilin e përjetojmë në çastet e zgjimit të brendshëm dhe ardhjes në vete, e të cilin e kam quajtur gjendja e “prezencës”, ky është çelësi i cili na shpie drejt zbulimit të ekzistencës spirituale te ne dhe e zbulon fshehtësinë, të cilën e quajmë shpirt, absolut ose abstrakt.

Në të dalluarit e të mirës prej të keqes, të vërtetës prej gënjeshtres, drejtësisë prej padrejtësisë, i përdorim kriteret e caktuara, të cilat janë të pavarura prej objektit të matur. Notën e japim duke vështruar nga “këndi” i njëjtë “shpirtëror”. Se shpirti ekziston dëshmon në të përfaqësuesi i tij, ndërgjegjja, si edhe ndjenja se ç’është e bukur. Në të tregon ndjenja sekrete me të cilën e dallojmë të vërtetën prej të pavërtetës, origjinalin prej surrogatit, (falsifikimit). Dhe, më në fund, se shpirti ekziston dëshmon edhe liria e brendshme e aksionit. Së këndejmi edhe përfundojmë se shpirti

¹⁴ Botëkuptim filozofik shkencor që, në kundërshtim me idealizmin, pranon se materia është parësore, kurse ndërgjegjja (shpirti) është dytësore dhe se fenomenet spirituale janë vetëm në funksion të materies, që është në kundërshtim me Islamizmin, i cili, siç kemi cekur, materien e konsideron vetëm mjet, vegël... për qëllime më të larta.

është fushë e misterieve të fshehta njerëzore, e lirisë së pafrenueshme dhe zgjidhjes e nuancimit të lirë.

Derisa jetojmë nuk i kushtojmë kujdes vdekjes dhe deri sa veprimet asaj nuk i japim pjesë në llogarinë tonë. Vështojmë në vdekjen sikur në diç iracionale. Në të vërtetë, duke vepruar kështu ne persiasim dhe sillemi të mashtruar me “unin” (egon) tonë, i cili, në të vërtetë, është shpirti, e ai sipas natyrës së vet nuk di për vdekje. Vdekja, pra, në raport me shpirtin, i cili është jashtëkohor, është si ndërrimi i rrobeve. Vdekja është shkatërrim (fena-un), dhe zhdukje (adem-un) të cilën shpirti nuk e njeh. Ai është gjithnjë këtu, prezent. Koha në të nuk vepron. Me vdekjen ai nga vetja vetëm i heq teshat materiale të kësaj bote ose, si e thonë këtë sufitë, i vesh teshat e botës tjetër (berzah¹⁵), pastaj i heq ato të berzahit që t'i veshë ato hyjnore, spirituale (melekuți), pastaj i heq ato hyjnore që t'i veshë ato të sovranit (xheberuti). Në këtë mënyrë ai ngadhënjën shkallë shkallë në rrugën e vet kah Krijuesi i tij. Secili shpirt do t'i afrohet sipas shkallës së pastërtisë së vet, valvitshmërisë dhe mundësisë që të fluturojë. Shpirtrat, të ngarkuar e të rëndë, do të bien në gremina të errëta, duke u munduar gjithmonë që prej tyre të nxirren.

T'i lëmë sufitë dhe dëshimimet e tyre. Nuk e kam për qëllim që me këtë ese të futem përtej perdes së vdekjes, në mënyrë që të mësoj ç'ka pas saj, sepse kjo do të ishte dëshirë e porealizueshme. Kam dëshirë që lexuesi të mendojë mbi vetveten dhe ta zbulojë këtë subjekt, në vete thellë të mbjellë, të cilin e kam quajtur shpirt dhe për ekzistencën e të cilit kam dhënë prova e argumente të pamohueshme: ndjenjën tonë të brendshme, të cilën të gjithë ne në vete e ndjejmë. Kjo është

¹⁵ Berzah, ndërhapësirë, ndërkohë, periode ndërmjet vdekjes dhe ringjalljes; kalim ndërmjet dyshimit dhe sigurimit (në besim).

ajo prezencë kontinuitive te ne, e cila është e përhershme dhe e pandryshueshme, si syri ynë i brendshëm i hapur përherë.

Shpirti është zgjimi i brendshëm. Ai është drita jonë e brendshme e padukshme, por e cila na ndriçon rrugën e të vërtetës dhe nëpërmjet së cilës e dallojmë të shëmtuarën prej të bukurës, të mirën prej të keqes.

Shpirti është horizont nga i cili e vështrojmë rrjedhën e kohës dhe i njohim (kuptojmë) lëvizjet e saj. Nga ai e shohim edhe kalueshmërinë e kësaj bote.

Shpirti është pika qendrore e rrethi, qendra rreth të cilit lëvizin ndodhitë kohore të kësaj bote derisa ai qëndron stabil në vendin e vet, i palëvizshëm dhe i përhershëm.

Shpirti, edhe pse është e vërteta jonë absolute, prapëseprapë është sekret. Jo në kuptimin se a ekziston, sepse këtë e argumentuam, por a është i përjetshëm apo vazhdimësia e tij është shënuar me disa kritere tjera kalendarike dita e të cilit është si një mijë vjet tonat? Kjo është sekret...

Çfarë janë raportet midis shpirtit dhe trupit?

Çfarë janë raportet midis arsyes dhe trurit?

Çfarë janë raportet midis memories, diturisë (së arritur) dhe manifestimit të diturive? Kjo është temë tjetër e cila kërkon shpjegime të gjata.

SHPIRTI

Një mbrëmje më ra ndërmend ta provoj dhe hulumtoj memorien time. Në një copë letër i kam shënuar të gjitha numrat që i kam mbajtur mend: numrin e pasaportës, automobilin, banesës, letërnjoftimit, numrat e telefonave të miqve dhe kolegëve, institucioneve dhe redaksive, gazetave, rezultatet e shumëzuesit dhe të shumëzueshmit, të cilat i di përmendësh dhe operimet tjera llogaritëse, të njohura intuitivisht. Pastaj e kam shkruar datën e ditëlindjes sime dhe fëmijëve të mi, vlerat stabile nga matematika dhe fizika siç është shpejtësia e dritës, zërit, shumën e trekëndëshit, shkallën e vlimit të ujit dhe tërë atë që e kam mësuar në Fakultetin e Mjekësisë: përqindjen e sheqerit në gjak, numrin e rruzave të kuqe e të bardha të gjakut, sasinë e gjakut në trupin e njeriut, numrin e pulsit dhe frymëmarrjes normale e tjera. Për një kohë të shkurtër para vetes kam pasur disa faqe me qindra numra, të cilët i rikujtova dhe të cilët, si vetëtimë, kaluan nëpër memorien time - sikur të isha llogaritës elektronik.

Edhe vetë kam qenë i habitur! Si kam mundur të mbaj në mend kaq numra, kur çdonjëri ka qenë gjashtëshifror ose shtatëshifror. Pyetsha ku janë të vendosur këta numra në qelizat trurorë dhe si pason rimemorimi i tyre momental? Pastaj kam menduar se si këta numra me radhë dhe ndaras janë radhitur; me çdo numër është edhe komenti përkatës i cili e shpjegon dhe definon. Pyetsha se si në memorien tonë grumbullohen me qindra e qindra numra të tillë e nuk përzihen, as nuk e fshijnë njëri tjetrin?

Përveç numrave memoria jonë është përplot me emra, terma, fjalë, forma dhe fytyra të mbajtura mend. Nuk i kemi harruar panoramat e vendeve dhe shteteve nëpër të cilat kemi kaluar dhe vizituar. Me disa erëra është e lidhur fotografia e femrës të cilën e kemi njoftuar, ose pamja e cila

na rikujtohet, vjetërsia e romanit, skenarit me mijëra kuadro, ushqimet dhe aromat. E shikojmë ushqimin dhe momentalisht, nga dëshira për të, na “rrjedh” nga goja ose ndjejmë instinkt për vjellje. Me shijen e ushqimit e vëmë në lëvizje shiritin manjetoфоник, i cili fillon të flasë mbi një gosti të pasur, ose gëlltitja e ilaçit të idhët na përkujton në sëmundjen e gjatë dhe dhembjet e mundimshme. Madje memoria na e ka ruajtur kujtimin mbi fladin dhe aromat e guacave bregdetare e era e lehë dhe e freskët në këtë na përkujton sikur këtë krejt sërish po e përjetojmë. Zërat, pëshpëritjet, zhurma, britma, apeli për ndihmë dhe të qamurit na përkujtojnë në diç. Rasti i njëjtë është me ndonjë takt muzikor, strofën e vjershës, flakareshën, goditjen me shkop shpinës dhe psherëtimën e dhembshme. Tërë këtë e ka mbajtur mend memoria dhe në kartonin e vet informativ kujdesshëm dhe besueshëm e ka shkruar: datën, rrethanat, emrat e personave, shkakun e ngjarjeve, deklaratat e dhëna... Kjo është ajo mrekulli (mu'xhize) të cilën e quajmë memorie.

Me vete e kemi kontrolluesin e vërtetë, i cili, sikurse me pendë nëpër letër, shënon në zemrat tona çdo gjë, e edhe çdo hap të bubreçit.

Nganjëherë mendojmë se diçka kemi harruar, por së shpejti zbulojmë se jo, dhe në çastin e plogështisë dhe gjysmëgjumësisë, befasisht dëshmohe mi se kjo te ne është prezente. Ndonjëhere kjo na ndodh, derisa jemi te psikiatri, ose kjo rastësisht “nga gjuha na ikë”, ose këtë joqëllimisht e diktojmë.

Asgjë përgjithmonë s'është harruar, asgjë pakthim s'është humbur. E kaluara, pa kontestim, është shkruar dhe këtë me radhë, moment pas momenti, një e rrahur e zemrës pas tjetrës.

Është pyetje e madhe ose fshehtësi hutuese ku janë të rregulluara të gjitha këto fotografi, ku është vendosur tërë ky aktiv sekret? Kjo është pyetje në të cilën janë orvatur të përgjigjen shumë shkencëtarë dhe shumë filozofë.

Filozofët materialistë kanë thënë se fuqia e memories është në tru dhe se qenësia e memories është në ndryshimet kimiko - elektrike, të cilat zhvillohen në materien e trurit si pasoja të veprimit nervor në ndodhitë (e jashtme). Saktë, ashtu siç ndodh kjo me shiritin manjetofofonik me rastin e incizimit. Me fjalë tjera, këto ngacmime të regjistruara deponohen në tru dhe ato, në çastin e orvatjes së rikujtimit automatikisht, besnikërisht, kthehen në kujtesë.

Sipas këtij supozimi materialist, memoria s'është asgjë tjetër përpos skalitje ose transplantim në materien qelizore trurore. Fati i memories është të zhduket dhe të derdhet, sikur që shkatërrohen ose zhduken të gjitha gravurat dhe prerjet. me vdekjen e njeriut dhe kalbjen e qelizave trurore do të zhduket edhe memoria.

Kjo është vërtet përgjigje e thjeshtë dhe e lehtë, por njëkohësisht edhe autorët e saj i vendosi në grackë prej kah nuk mund të dalin.

Me fjalë tjera, nëse supozojmë se memoria është vetëm veprim material e cila është manifestuar në qelizën trurore, është logjike që me çdo dëmtim material të qelizave trurore të pasojë edhe dëmtimi përkatës i memories. Nëse kështu i hyjmë këtij fenomeni - është e detyrueshme - se ekziston përpjesëtimi përkatës ndërmjet këtyre dy rasteve: çrregullimi i memories në intensitetin e caktuar duhet medoemos të manifestohet edhe në materien përkatëse qelizore, e kjo është ajo që pikërisht nuk manifestohet me rastin e dëmtimit të trurit dhe sëmundjeve trurore. Ajo që ndodh është pikërisht e kundërt prej asaj. Kështu për shembull dëmtohet qendra e të folurit, por kjo

aspak nuk manifestohet në memorien e fjalës, pason paraliza e fuqisë së të folurit, respektivisht defektit në punën e instrumentit të të folurit. Me fjalë tjera, prishja qelizore në të vërtetë është prishje e motorit, lëvizësit, por jo edhe e memories. Fotografia e fjalës në tru mbetet e shëndoshë dhe e paprekur.

Kjo na dëshmon se funksioni i trurit nuk është i njëjtë me funksionin e memories dhe rikujtimit. Truri, në këtë rast, është vetëm central i cili jep kontakt, lidhje. Ai është vetëm mjet nëpërmjet të cilit, me ndihmën e instrumentit material e shpreh fjalën, bëhet zë kumbues (tingëllues), ngjashëm siç vepron radio-aparati kur radio vala shndërrohet në impulsin tingëllues, elektrik. Dhe, kur radio-aparati të priset dhe dëmtohet, kjo nuk do të thotë se defekti është te radio valët ose te emisioni, porse ky defekt është shkaktuar në membranën e radio-marrësit i cili krijon zë. Mirëpo, vala funksionon dhe mund ta pranojë radio marrësi tjetër, në gjendje të rregullt.

Rasti i tillë është edhe me memorien, ajo është përmbledhje e pavarur fotografish, idesh dhe pikëpamjesh, e cila është e vendosur dhe gjendet në shpirt, e kurrsesi në tru ose trup. Truri s'është tjetër përpos një mjet, nëpërmjet të cilit këto fotografi transmetohen në mënyrë që, në botën materiale, të bëhen fjalë tingëlluese dhe të theksuara. Së këndejmi, dimë se aftësia e të folurit do të goditet nëse trupi dëmtohet, por kjo nuk do të jetë në rastin e memories, sepse ajo është çka edhe shpirti dhe nuk do të reagojë siç reagon trupi i njeriut. Pandaj, trupi dhe shpirti nuk janë sinonimë, një e njëjta gjë. Këtu e kemi të ashtuquajturin dualizmin fenomenal: një është trupi (materia) e tjetër është shpirti.

Në rastet e harresës së pjesërishme, në të cilat njeriu i harron ngjarjet nga periudha e caktuar kohore, i sëmuri e harron një periudhë kohore, e humb nga vetëdija e vet dhe zhduket nga

memoria e tij. Në shembujt e këtillë, në pajtim me teorinë materialiste, e obligueshme do të ishte të pasojë edhe dëmtimi i pjesërishëm i trurit, periudhës përkatëse të harresës. Mirëpo, dimë nga përvoja se këto kryesisht janë rastet e shok gjendjes (çrregullimit) të përgjithshme psikike, e jo dëmtimit të pjesërishëm të qelizave të trurit.

Për herë të dytë, edhe në këtë shembull, po bindemi se nuk ekziston sinonimia e fenomenit të harresës dhe dëmtimit material, fizik.

Në rastet e dëmtimit të rëndë material, truror, në qoftë se ka të bëjë me thyerjen, kalljen ose sëmundjen tumorite, kur lind harresa totale, gjithnjë vërehet se kjo harresë përparon rrjedhës së caktuar: më së pari fillon të harrohen emrat e përveçëm, e më së voni harrohen foljet. Nëse tash, kemi parasysh se kjo harresë e shkallëzuar ka lindur për shkak të dëmtimit i cili nuk ka qenë i shkallëzuar, në këtë rast e kemi edhe një argument në mosmarrëveshje, joidentitet të dy nocioneve të larttheksuara (trupit dhe shpirtit), sepse dëmtimi i memories, në raport me rrethin e veprimit, intensitetin dhe shkallëzimin, nuk ka lidhje me dëmtimin material të trurit.

Përsëri vimë deri te konkludimi se teoria materialiste mbi memorien është e paqëndrueshme. Përsëri u gjetëm para fenomenit i cili është sipër trupit të njeriut dhe qelizave të tij të trurit.

Së shpejti qelizat e trurit do të vdesin dhe prishen (kalben), e memoria me të gjitha detajet e veta do të mbesë e gjallë duke na rikujtuar, në jetën tonë tjetër, shpirtërore në të gjitha veprat të cilat më parë i kemi filluar.

Në të vërtetë, trupi i njeriut në këtë botë, materiale, s'është asgjë tjetër veçse zbatues dhe manifestues i qëllimeve. Trupi ka qenë vetëm instrument i shpirtit dhe i nënshtruar atij, e truri

vetëm central dhe tel ngjites. I tërë roli i trurit përbëhet prej asaj që të bëjë (zhvillojë) bashkim prej botës shpirtërore në materiale, ose, siç e thotë këtë filozofi Bergsoni: “Donner la communication”, dmth, të jepet kontakti, lidhja. Me fjalë tjera, “fijet nervore” e transmetojnë atë që shpirti e fsheh dhe e transmeton nëpërmjet impulsit elektrik në mënyrë që, në anën tjetër të përçuesit, organi i gjuhës ta komunikojë. Pra, atë të njejtën që e bën radioja nëpërmjet radiovalëve. Në këtë mënyrë, deri sa ende jemi trupa, e zhvillojmë komunikimin gjuhësor. E kur trupat të vdesin, na mbeten shpirtat që ta rikujtojmë çdo moment, çdo shkronjë, t'i rikujtojmë të gjitha qëndrimet (sjelljet) të cilat (në shpirt) janë regjistruar.

Ekzistojnë hipoteza shkencore të cilat shkojnë edhe më larg se kjo, se njohja jonë e kësaj bote në të vërtetë është vetëm rimemorim i dijes kaheerë të arritur, në shpirt të deponuar dhe të regjistruar. thënë më tekstualisht, kjo njohje nuk është ajo nga tabela e shkollës. Sipas këtij supozimi për ne njohja $2 \times 2 = 4$ nuk është e re. Ne me këtë njohje jemi lindur, e (në shkollë) vetëm e kemi përsëritur. Rasti i tillë është me të gjitha aksionet matematikore, gjeometrike dhe logjike. Të gjitha këto njohuri te ne janë të “deponuara”, ne me to lindemi dhe ne vetëm i përtërijmë. Në Këtë supozim shkencor udhëzon përvoja e përditshme e kësaj bote.

Diç e ngjashme është edhe me personalitetet, individualitetet tona. Me to lindemi ato te ne janë të shënuara, ne i bartim në shpirtërat tonë. Tërë procesi përbëhet prej asaj që realiteti i kësaj bote ofron raste, rrethana dhe modelim material në mënyrë që ky personalitet të përcaktohet mbi të mirën apo të keqen dhe që të caktohet kuptimi i veprimit të tij. Ky caktim, ose klasifikim, kryhet në këtë botë.

Kjo është ajo përgjegjësi në bazë të secilës fe, pas sprovimit dhe përvojës së kësaj bote, mëkatarit ia varin për qafe dhe e klasifikojnë lajthimin e tij.

Çfarë do të jetë njeriu, All-llahu këtë e ka ditur edhe më parë, por kjo është e ashtuquajtura “dituri pasive”, e jo aktive, sepse All-llahu, edhe pse e di çdo të bëjë njeriu, kjo dituri askend s'e obligon as detyron në të keqe; të gjithë njerëzit sillen sipas natyrës së tyre të brendshme, dhe se veprimi i tij do të jetë pasqyrim (reflektim) i subjektit të tij. Këtu nuk ka kurrfarë fatalizmi¹⁶ sepse kjo natyra e brendshme njerëzore është si edhe ndërgjegjja (damir), nganjëherë e quajmë ide sekrete (seriretu), ndonjëherë zemër (fu'âd), e All-llahu e ka quajtur fshehtësi, e në Kur'an thotë: ja'lemu s-sirre we ehfâ,, dmth. “Ai e di edhe atë që tjetrit fshehtë ia thua, edhe atë që vetëm e mendon” (Taha, 7).

Në zhargonin (dialektin) popullor, me rastin e vdekjes thuhet: “Doli fshehtësia Hyjnore”, dmth. shpirti i shkoi Krijuesit të vet.

Këtë të ashtuquajturën fshehtësi talismane All-llahu e bëri plotësisht të lirë kështu që të gjitha sjelljet njerëzore në të vërtetë janë, emancipimi i saj, vepra të subjektit të saj. Për këtë nuk mund të shtrohet pyetja mbi njëfarë domosdoshmërie në fushën e veprimit të njeriut sikur që janë determinizmet e luftës klasore dhe fatalizmit historik, sepse veprimtaria e njeriut është liridashëse dhe njeriu nuk është gozhdë, ose burmë e ndonjë makine.

¹⁶ Fatalizmi (fatum), mësim sipas të cilit gjithçka që ndodh në natyrë, në shoqëri, në jetën e njeriut është e paracaktuar, predestinuar dhe se njeriu nuk mund të ndikojë në ndryshimin e saj.

Sikur që nuk mund të profetizojmë (parathemë) në jetën e njeriut çdo të sjellë e nesërmja, po ashtu është e pamundur të flitet edhe mbi determinizmin në bashkësitë shoqërore dhe histori. Krejt ç'ka në këtë botë, mundemi të themi se kjo është në bazë të të dhënave statistikore, e këto janë hipotezat të cilat mund t'i qëllojnë ose gabojnë. Sepse, prognoza në bazë të statistikës lejon devijim të rëndësishëm, poshtë dhe lart. Kështu për shembull mesatarja e jetës së njeriut në Angli është gjashtëdhjetë vjet. Kjo mesatare statistikore është marrë nga të dhënat mesatare por ky konkludim nuk është absolutisht i saktë, sepse në Angli ka individë për shembull Bernard Sho, i cili ka jetuar më shumë se nëntëdhjetë vjet dhe e ka tejkaluar mesataren. Ndodh që dikush në fatkeqësi të vdesë në të njëzetën, e ndoshta edhe si fëmijë nga sëmundja infektuese. Përveç kësaj, vetë mesatarja nuk është permanente: prej viti në vit mund të rritet ose të bjerë. Për këtë nuk është e saktë se këtu ka të bëjë mbi fatalizmin dhe determinizmin.¹⁷ Gjithashtu nuk është në rregull t'i nënshtrohet fusha e veprimtimit të njeriut - qoftë ajo që ka të bëjë me njeriun, shoqërinë ose historinë - shablonit teorik, llogarisë statistikore ose hipotezës filozofike.

Me fjalë tjera, ideja e gabueshme e fatalizmit rrjedh nga supozimi i gabueshëm mbi njeriun, se ai është vetëm trup, pa shpirt dhe arsye, si edhe të kuptuarit të gabueshëm se shpirti dhe arsyeja janë vetëm grumbull i funksioneve kulminante të sistemit nervor. Mendimtari materialist, në të shikuarit e rëndomtë të përditshëm të nënshtimit të trupit ligjësive fiziologjike, do të përfundojë se njeriu dhe mbarë njerëzia është rob i ligjësive materiale. Në këtë mënyrë njeriu është vendosur si masë materiale, e ngjashme me të hënës e cila, sipas ligjësive të gjithësisë, është e detyruar në

¹⁷ Determinizmi (determinare), doktrinë sipas së cilës të gjitha dukuritë e ngjarjet kanë karakter ligjësor e kushtëzohen nga lidhje shkakore objektive; as dëshira e vullneti i njeriut nuk janë të lira.

rrotullim rreth Tokës. Të tillët harrojnë se njeriu njëkohësisht jeton jetë të dyfishtë. Njëri aspekt i tij jetësor është jashtë-kohor, objektiv, material, jeton me kohën e orës sonë të rëndomtë. Duke jetuar në këtë kohë njeriu lidhet me termat kohore, obligimet shoqërore dhe jeton në robëri të ligjeve dhe determinizmit. Pjesa tjetër e jetës së tij zhvillohet në kohën e tij personale, të brendshme, kohën e emocioneve dhe fantazive. Në këtë aspekt njeriu vërtet jeton i lirë dhe persiat, imagjionon, krijon novatori dhe në raport me të gjitha rendet shoqërore dhe historinë, shikon revolucionarisht. Dhe jo vetëm kjo, por është i aftë që këtë revolucion të brendshëm ta përcjellë në botën e jashtme dhe ta ndryshojë rendin shoqëror dhe nga themeli ta ndryshojë historinë, siç ka ndodhur kjo në të gjitha revolucionet përparimtare.

Ky dualizëm jetësor është atribut me të cilin shquhet vetëm njeriu. Vetëm njeriu në natyrë mund të jetojë me jetën e vet të brendshme, të lirë. Sepse, shpirti i njeriut shquhet me kualitete të llojllojshme, të ndryshme nga qeniet dhe krijesat joorganike. Në këtë rast ne gjendemi para individit i cili me vend është i pacaktuar, pakufizuar, ai është ai “uni” njerëzor i cili është karakteristik me prezencën, vazhdimësinë, ekzistencën dhe paraqitjen e vazhdueshme në vetëdije dhe me atë ky “unë” vetëm i ka imponuar botës së jashtme dhe e ka ndërruar atë. Ai i imponohet trupit, atë e orienton dhe drejton madje i disiplinon nevojat trupore: vullnetarisht ia imponon agjërimin dhe abstenimet tjera. Ndodh që ky “unë”, në të vërtetë shpirti, trupin si sakrificë ta shpjerë në vdekje.

Ky “unë”, respektivisht shpirti, nuk mund të jetë manifestim i rëndomtë trupor, bisht (satelit) dhe materie e tij e cila prej trupit është zhvilluar. Konfirmimi i këtyllë materialist nuk na sqaron asgjë. Për këtë medoemos duhet pranuar se shpirti është mbi trupin, më i lartë se ai, substanca e tij është ndryshe nga qenësia e trupit e cila i është e nënshtruar. Ai në të vërtetë e shfrytëzon trupin

si mjet për synimet e veta dhe instrument për qëllimet e veta. Diç e ngjashme sikur që arsyeja (akl) ekskluzivisht e përdor trurin për kontakt ose centralin e vet.

Është e kuptueshme dhe logjike që shpirtin e këtillë nuk mundemi ta përfytyrojmë që të sillet si trup: të vdesë, të mundë të zhduket dhe kalbet. Ai këtë nuk mundet për arsye të substancës dhe qenësisë së vet me të cilën, krejt kohën, në vetëdije na rikujton në prezencën, vazhdimësinë dhe joshkatërrimësinë e vet. Ai nuk shteret dhe nuk zhduket, siç është këtu rasti me trupin, nuk bien siç bien flokët, nuk thërmohet siç thërmohen dhëmbët. Së këndejmi, plotësisht dhe intuitivisht e përfytyrojmë vazhdimësinë e tij edhe pas vdekjes.

Nëse, tash, mendojmë mbi përgjegjësinë të cilën e ndjejmë gjatë ndonjë pune, mbi pendimin ose lehtësimin pas kryerjes së saj, përfundojmë se posedojmë kontrollin e lindur dhe idenë e fortë, e cila kujdeset mbi atë se a do të gabojmë ose do të sillemi në mënyrë korrekte. Sepse ne në mënyrë aksiomatike dhe instiktive dimë se drejtësia dhe rregullimi janë ligjësi të botës fenomenale (wuxhid) dhe se përgjithësia është rregulli i saj themelor.

Kjo ndjenjë e pashmangshme natyrale na flet se tirani, i cili i është shmangur dënimit të kësaj bote, ose dorasi i cili ka shpëtuar nga ligji njerëzor i kësaj bote, duhet të dënohet, sepse kjo botë në të cilën jetojmë, flet mbi rendin dhe rregullimin pedant, qoftë se ka të bëjë me atomin e imët ose gjithësinë e gjerë. Çrregullimi është prezent vetëm në konceptet tona, në konkludimet dhe vendimet tona të gabueshme dhe të devijuara. Ideja e drejtësisë dhe rendit si edhe e domosdoshmërisë së tyre na tregojnë në pashmangshmërinë e botës tjetër në të cilën drejtësia do të triumfojë, rendi dhe dhënia e llogarisë do të prezentohen.

Me këtë njohje ne jemi lindur dhe kjo është e vërtetë mbi të cilën na flasin instinkti dhe intuïta (natyra). Për këtë as nuk është çudi që filozofi Emanuel Kanti në veprën e vet “Kritika e mendjes praktike” e pranon këtë të vërtetë. Dhe nuk është çudi që ka ardhur deri te ky përfundim pa e lexuar Kur'anin¹⁸, sepse nuk ka nevojë që njeriu me mendje të shëndoshë ta lexojë Librin e shenjtë dhe tek ajo të mësojë se si ai, njeriu, posedon shpirt, se do të jetojë pas vdekjes dhe do të japë llogari për veprat e bëra, sepse edhe vetë mendja e shëndoshë (bon sensce) do ta shpjerë te ky realitet.

Kjo njohuri me të cilën lindemi dhe këto aksioma të cilat te ne janë të lindura, shërbejnë si orientues për të gjitha njohuritë e fituara në jetë. Ose, thënë më mirë, ato janë normativa për konfirmimin e njohurive të fituara. Me fjalë të tjera, njohuritë e fituara mund të jenë të sakta dhe të gabuara, por njohuritë e lindura janë pjesë e rendit të përkryer kozmik, a priori, e vërteta origjinale (fillestare) në dritën në të cilën i veshtrajmë të gjitha të vërtetat tjera organike. Njohja e parë, e lindur është kriter, normativ, dhe nëse ai normativ nuk është në rregull, çdo gjë tjetër do të vendoset gabimisht, e kjo nuk mund të jetë. Nëse në njohuritë e lindura, intuitive dyshojmë dhe i akuzojmë, atëherë automatikisht do t'i akuzojmë edhe të gjitha njohuritë tjera e ato do të lëkunden, sepse bazohen në njohuritë e para aksiomatike.

Pra, këtu ka të bëjë me një prej bazave të njohjes në të cilat nuk guxon të dyshohet, sepse ky burim i njohjes është çka edhe vetë jeta, ky është mishi dhe gjaku i njohjes.

¹⁸ Sigurisht autori nuk është i informuar se Kanti është interesuar për Islamizmin, e si dëshmi të kësaj e cekim faktin se në kopertinën e tezës së disertacionit të tij ndeshemi me motive islame (nga Kur'ani).

Sikur që, duke ardhur në botë, jemi të furnizuar me gjymtyrët me të cilët lëvizim dhe ushqehemi, kështu njësoj lindemi të furnizuar me njohjet intuitive në mënyrë që nëpërmjet tyre të drejtohem në të arbitruar gjatë të dalluarit të gabueshmes prej të drejtës.

Njohjen më të sigurtë e gjejmë në brendinë tonë. Ne më së miri e dimë pozitën tonë, edhe pa e shikuar vetveten (se a jemi duke qëndruar, në këmbë, jemi të shtrirë ose ulur). Këtë e kuptojmë edhe symbyllur e dimë nga brendia jonë. Kjo njohje është më e sigurt se cilado (njohje) tjetër eksperimentale.

Ose, kur vetvetes i thua: unë jam fatlum, unë jam fatkeq, ose unë jam i pikëllueshëm. Kjo është e vërtetë të cilën nuk duhet përgënjeshtuar me argumente logjike. E edhe orvatja që njohja e këtillë logjikisht të shpjegohet do të jetë e padobishme dhe e tepërt, sepse këtë askush s'e di më mirë sesa vetë ti. Po ashtu, me qëllim të argumentimit, na shërbejnë konkluzionet aksiomatike dhe bindjet intuitive, e kjo është shkalla më e lartë e njohjes, sepse kur lindshmëria dhe intuuta konkludojnë diç të caktuar, dhe kjo të vërtetohet shkeçërisht dhe idealisht - kur të gjithë ato pohojnë se ekzistojnë shpirti, arsyeja, liria, përgjegjësia, dënimi dhe shpërblimi (për veprat e bëra), kur njeriu është i inspiruar të veprojë duke e pasur parasysh se gjithësia e ka rendin dhe ligjësitë e veta, - ne atëherë jemi para argumentit i cili është më tepër sesa aksiomë. Dokumentariteti i tij, vlera dëshmuese është më e fuqishme sesa qartësia, sepse intuuta është organ njerëzor, sikur edhe syri dhe me të lindemi.

Lindshmëria, intuuta është më e fuqishme sesa argumentimi shkencor, sepse e vërteta shkencore në të vërtetë është statistikore, e teoritë shkencore rezultat i mesatares shifrore, deri sa gjykimi intuitiv e ka fuqinë e saktësisë jorevokuese. Kështu për shembull $2 \times 2 = 4$, kjo është e vërtetë

jorevokuese dhe mbi këtë nuk mund të aplikohen korreksionet, korrigjimet evolutive dhe ndryshimet të cilat në vete përmbajnë teori shkencore, sepse ky është konkludim intuitiv.

Ose, për shembull $1 + 1 = 2$ rezultat i cili nuk mund të jetë objekt dyshimi, pasi që është realitet i fituar nëpërmjet lindshmërisë tonë të brendshme dhe inspirimit aksiomatik. Këto janë njohuri të cilat me lindje i kemi sjellë me vete.

Sikur, të gjitha këto që u thanë më lart për shpirtin, njeriu menjëherë t'i mësonte, nuk do t'i shqetësonte as vetën as të tjerët. Me fjalë tjera, kur flitet mbi problemin e shpirtit, trupit, arsyes, trurit, lirisë njerëzore, determinizmit, përgjegjësisë dhe llogarisë (për veprat e bëra në këtë botë), po të ishte njeriu i vetëdijshëm për të gjitha këto dhe të mbështetej në pëshpërtijen e intuitës së vet, atë që ia këshillon zemra e tij dhe që ia imponon arsyeja, njeriu do t'i kursente shumë diskutime, biseda të tepërta, sofizma dhe kundërthënie.

Thërmia e sinqeritetit është më e mirë sesa grumbulli i librave. Për këtë më mirë do të ishte që ta përgjojmë zërin e sinqertë të shpirtit dhe pëshpërtijen e zemrës dhe që të mos orvatemi me intrigat e logjikës dhe me dëshmitë e dyshimta ta shëmtojmë atë thirrje natyrale.

Atyre të cilët do të dyshonin në këtë konkludimin tim definitiv dhe atyre të cilët e preferojnë dialektikën, diskutimin dhe shqyrtimet logjike, u preferoj që sërish ta lexojnë këtë artikull.

DREJTËSIA E AMSHUESHME

Kush e ka parë macen e cila, që njerëzit rreth tryezës të mos e vërejnë, përvidhet dhe me gojë zgjatet që ta grabisë një copëz peshku, - ai që e ka parë këtë pamje dhe ka shikuar në sytë e maces në çastin e “vjedhjes”, kurrë nuk do ta harrojë shprehjen (çehren) e shikimit të saj plot ndjenjë për mëkatin e bërë.

Pra, macja, shtazë memece, ka ndjenjë të pashpjegueshme se ka bërë shkeljen e ligjit dhe ka gabuar, kur të ndëshkohet dhe merr goditjen në kokë, ulë sytë dhe kokën sikur kupton se e ka pësuar atë që e ka merituar. Kjo ndjenjë, është instinkt primitiv të cilin All-llahu e ka komponuar në indin e krijesës. Kjo, në të vërtetë, është ndjenja primitive morale, gjurmët e së cilës i takojmë madje edhe te shtazët memece.

Ose, ta marrim për shembull qenin i cili, kur e kryen nevojën “i turpëruar” me aktin e vet, e gërvisht dheun mbi atë që ka bërë në mënyrë që ta fshehë nga sytë. Edhe këtu ka të bëjë me shtypjen instinktive e cila tregon në ndjenjën mbi të shëmtuarën dhe reagimin e shpejtë që kjo të shmanget dhe fshihet. Edhe ky është manifestim i moralit kongenital (të lindur), i cili s'është arritur me njohje, mësim as me dresurë. Ky është fenomen natyral me të cilin lindin të gjithë qentë.

Diç e ngjashme ndodh edhe me devenë e tronditur të cilën pronari, përkundër durimit dhe qëndresës së saj të gjatë, vazhdimisht e ka nënçmuar. Ose, për, shembull krenaria e luanit i cili refuzon që sakrificën e vet në mënyrë të pabesë nga shpina ta sulmojë. Për këtë gjithnjë e sulmon përpara dhe haptas. Edhe diçka: luani sulmon vetëm që të hajë, e nuk e mundon që të hajë dhe

shqyejë sakrificën, por vetëm kur uritet. Të gjitha këto lindshmëri morale janë të përmbajtura në esencën e qenieve dhe shtazëve. Ose, ta marrim për shembull lojalitetin bashkëshortor te pëllumbi. Ose, besnikërinë e jetës në bashkësi te shtazët të cilat jetojnë në kope.

Këtu ka të bëjë me parimet themelore - origjinale të ndjesisë së ndërgjegjes, të cilën e zbulojmë edhe nën lëkurën edhe në gjakun tonë, e të cilën nuk na ka mësuar mësuesi, por ajo me ne është e lindur. Kjo është ajo ndjenja e lindur e përgjegjësive të cilën e ndjejmë kur hamendemi a të punojmë diç apo jo, ose ajo ndjesia e mundimshme, e vështirë, të cilën e përjetojmë gjatë hapave të ndërmarë, e që nuk jemi të sigurt se a jemi sjellë korrekt ose, përfundimisht, ndiesia e pendimit të cilën e kemi, pasi të konstantojmë se kemi gabuar.

Kjo ndjesi e brendshme, instinkt, i cili është i përbashkët edhe për njeriun e civilizuar edhe primitiv, fëmijën dhe të rriturin, është dëshmi mbi ekzistimin e ndjesisë së ligjësive dhe rendit (në këtë botë) dhe se do të pasojë llogaria dhe drejtësia definitive, dhe se prej çdo njeriu kërkohet drejtësia, sikur edhe këtë që të ketë të drejtë që mbi të të aplikohet. Kjo ndjesi te ne është kongenitale, natyrale, ajo del prej vetë natyrës sonë, atë te ne Krijuesi e ka mbjellë.

Nëse kundrojmë në botën materiale, e cila është e përbërë prej grimcave më të imëta deri te galaksitë e pafund, do të konstatojmë se e gjithë kjo në mënyrë precize e aritmetike lëviz në bazë të ligjësive të caktuara. E madje edhe elektroni, në bërthamën e atomit, nuk e ndërron rrethin e

lëvizjes derisa nuk e lë ose merr barrën e cila i përgjigjet forcës së translokimit të tij¹⁹. Në rastin konkret sikur elektroni është udhëtari në tren i cili nuk mund të hyjë në tren para se ta paguajë biletën për vozitje.

Të formuarit e yjeve dhe zhdukja e tyre gjithashtu u nënshtrohen ligjësiave dhe shkaqeve të caktuara. Të lëvizurit e planetëve në fushat gravituese e ka ligjin e vet të proporcioneve. Të transformuarit e materies në forcë, ose masës diellore në dritë, e ka reciprocitetin e vet. Drita e ka shpejtësinë e vet të lëvizjes. Çdo valë elektrike e ka gjatësinë, shpejtësinë dhe tensionin e vet, e çdo metal spektrin e vet dhe vijat observuese të cilat e karakterizojnë, e njihen nëpërmjet spektrometrit. Po ashtu, çdo metal, varësisht nga temperatura, tkurret ose bryhet (dilatohet). Çdo metal e ka masën, dendësinë, peshën e vet të rëndomtë dhe atomike, veçantitë dhe kualitetet e veta.

Ajnshtajni ka konstatuar se ekziston lidhja ndërmjet vëllimit, masës së trupit dhe shpejtësisë së tij, ndërmjet kohës dhe rendit të lëvizjes brenda një grumbulli lëvizës, ndërmjet kohës dhe hapësirës²⁰.

¹⁹ Çdo atom përbëhet prej bërthamës të cilën e prëbëjnë grimcat (thërmijat) e elektrizuara pozitivisht të quajtura protone dhe neutralisht të quajtura neutrone, rreth bërthamës qarkullojnë grimcat e elektrizuara negativisht të quajtura elektrone. Shënim i A. Hukiqit).

²⁰ Ajnshtajni (Albert Einstein, 1789 - 1955), themelues i teorisë së relativitetit, sipas të cilit madhësitë hapësinore dhe kohore janë vetëm madhësi relative, dhe se as nuk mund të përcaktohen pavarësisht njëra prej tjetrës.

Materien, për shkak të mesatares së shpejtësisë së pjesëve të saj, e ndajmë në të ngurtë, lëngët dhe gaztë. Sepse, ngrohtësia e shpejton këtë lëvizje dhe kjo ka mundësi t'i shkrijë trupat e ngurtë dhe t'i shndërrojë në të lëngët, e kur të vijë deri te avullimi i shndërron në të gaztë.

Edhe elektriciteti krijohet në bazë të ligjësive. Tensioni elektrik, fuqia e tij, lind në bazë të tërheqjes dhe dëbimit. Gravitacioni dhe tërheqshmëria e secilit yll varet nga vëllimi dhe madhësia e tij.

Tërmetet të cilat, në shikim të parë, na duken jo të rregullt dhe kaotikë, edhe ata e kanë ligjësinë e vet të krijimit, i kanë brezet e veta dhe të ashtuquajturat drejtimet lëkundëse në të cilat ndodhin dhe është e mundur, për së gjati dhe për së gjeri rruzulli tokësor, të bëhet harta e zonave të tërmeteve.

Pra, tërë gjithësia s'është asgjë tjetër përpos shumë e rregullave dhe ligjësive precize e fiktive të cilat nuk mund të tradhëtojnë dhe gënjejnë - mashtrojnë.

Sigurisht se dikush do të vërejë: “E ç'mendoni mbi mashtrimet dhe gënjimet tona njerëzore, mbi luftërat, tiranitë, anarkinë dhe mbi vrasjet reciproke tradhtare dhe armiqësore - ku është këtu rendi dhe ligjësia?”

Në këtë vërejtje do të përgjigjem se kjo është çështje tjetër. Me fjalë tjera, ajo që ndodh midis nesh, në shoqërinë njerëzore, kjo është për atë sepse All-llahu na ka bërë përfaqësues (halif) në

Tokë, na ka dhënë të drejtën e udhëheqjes dhe lirinë e aksionit. All-llahu na ofroi neve emanetin dhe ne e pranuan²¹.

Domethënia e dhënies së lirisë do të thotë se na ka dhënë mundësi të gabojmë dhe të sillemi në mënyrë korrekte. Për këtë çdo gjë që e shohim në këtë botë njerëzore, kjo është pasojë, rezultat i asaj lirie të cilën e kemi keqpërdorur. Prandaj, anarkia e theksuar është rezultat i veprimit tonë të lirë njerëzor. Përkundarazi, qenësia e botës është kulminacioni i rendit dhe ligjesisë precize. Po të kishte dashur All-llahu ka mundur, gjithashtu, që detyrimisht të na nënshtrojë dhe të na mëarësojë ndaj atij rendi dhe ligjësie siç e ka bërë këtë me malet, detet, yjet dhe gjithësinë. Mirëpo, Ai ka vendosur që të na kursejë nga detyrimi dhe me këtë ta plotësojë drejtësinë e vet; që çdo njeri vullnetarisht të veprojë dhe me veprën e vet vetveten ta kualifikojë. All-llahu kështu ka vepruar që drejtësia, kur të ringjallemi, të jetë e tërësishme, e kjo ringjallje sipas meritave do të shkallëzohet: çdokujt do t'i jepet e drejta e tij dhe të gjitha gjërat do të vendosen në vendet e veta.

E jeta vazhdon. Vetëm duhet përmendur se jeta në këtë botën tonë, në të vërtetë, s'është mbarë tërësia jetësore. Thënë më tekstualisht, periudha kohore, epizodike e tiranisë dhe disharmonisë së kësaj bote, është periudhë e cila e ka shpjegimin dhe shkaqet e veta, sepse ajo, duke konsideruar se është periudhë e provimit për jetën e amshueshme e cila do të pasojë, është sikurse edhe vetë drejtësia.

²¹ Autori këtu aludon në ajetin Kur'anor: “Ne qiejve, Tokës dhe maleve ua ofruem emanetin (të sundojnë), e ata u ngurruan nga ky (obligim); atë e pranoi njeriu”. (El-Ahzab, 72).

Periudha jonë kohore e kësaj bote është vendosur në rrethojë (kllapa) në raport me kohën, para dhe pas saj. Kjo nuk e prezenton realitetin e tërësishëm (jetësor) e as rrëfimin e tij të tërësishëm. Kjo është vetëm kaptinë e vogël e romanit i cili i ka kaptinat e veta të shumënumërta.

Njeriu instiktivisht e mësoi të vërtetën e inkarnimit, ringjalljes. Atë e kuptoi edhe njeriu primitiv. Mbi këtë kanë folur edhe të dërguarit e Zotit si mbi gjërat transcendentale²², të gajbit (fshehtës).

Se do të pasojë jeta pas vdekjes na flet arsyeja, e edhe shkenca e cila mësoi se njeriu është prej trupit dhe shpirtit, siç e theksuam këtë më parë. Kemi konstatuar se njeriu, përkundër valës së ndryshimeve kohore të cilat e rrethojnë, me ndjenjën e brendshme të tillë vazhdimisht e përjeton prezencën e shpirtit. E kjo ndjenjë e përkujton njeriun se në vetë atë ekziston shpirti, qenësia, e cila është e e pandryshueshme, jashtëkohore, e pashkatërrueshme dhe e pavdekshme.

E edhe filozofët siç janë Emanuel Kanti, Henri Bergsoni dhe Soren Kjerkegordi²³ erdhën deri te përfundimi se shpirti ekziston dhe se ringjallja do të pasojë.

²² Transcendenca (transscendentia), kapërcimi i kufijve empirike, ajo që është në anën tjetër të përvojës; në arabishte barasvlera më adekuate është termi “gajb”.

²³ Kanti (Emanuel Kant, 1724 - 1804), karakteristika parësore e filozofisë së tij është dallimi i formës prej objektit të perceptimit, apriorës dhe aposteriores. Ai e pranon ekzistimin e sendeve pavarësisht nga vetëdija jonë.

- Kjerkegordi (Soren Kierkegaard, 1813 - 1855), “ekzistencën” e konsideron fundament të të ashtuquajturës “filozofi ekzistencialiste”. Ai mendon se “religjioni është objekt i mendimit ekzistencialist, pasi që vjen prej shpirtit”.

Në veprën “Republika e Platonit” ekziston fragmenti i shkëlqyeshëm mbi përhershmerinë e shpirtit²⁴.

Prandaj, ringjallja është realitet i cili u është imponuar edhe mendjeve më të mëdha dhe më të vogla njëzëre, e në filozofi paraqitet si aksiomë e cila vështirë mund të kontestohet.

Mirëpo, sipas mendimit tim, argumenti më i rëndësishëm për ringjalljen është ajo ndjenja e brendshme, e thellë intuitive me të cilën të gjithë lindemi dhe sipas saj veprojmë. Sepse, në gjithësi ekzistojnë rendi preciz, ligjësia dhe drejtësia. Në realizimin e kësaj drejtësie e detyrojmë vetveten, e kërkojmë edhe nga të tjerët të jenë të drejtë. E bëjmë këtë natyrshëm, instinktivisht, Digjemi kur kjo drejtësi nuk realizohet. Luftojmë e edhe vdesim në realizimin e drejtësisë. Por, në fund, kurrë nuk e realizuam këtë drejtësi. Kjo do të thotë se drejtësia në ndonjë mënyrë, kurdo qoftë kjo, do të realizohet, sepse kjo është e vërteta absolute e cila në mënyrë permanente i është imponuar arsyes dhe ndërgjegjes sonë. Tjetër çështje është që ne nuk po vërejmë se kjo drejtësi po realizohet në këtë botë. Kjo është për këtë që ne nuk po mundemi tërësisht t'i observojmë gjërat, e përveç kësaj bota jonë fenomenale, ndijore nuk është e vërteta e tërë.

- Bergsoni (Henry Bergson, 1859 - 1941), i takon traditës irracionaliste, përkatësisht filozofisë së jetës. Në qendër të preokupimeve të këtij filozofi janë fenomenet e jetës dhe lirisë... Si kundërveprim ndaj “fuqisë destruktive të arsyes” ky e rekomandon religjionin. Filozofia e tij intuicionaliste kaloi në sulm kundër arsyes dhe materializmit, dhe rezultatet e saj kanë qenë religjioni dhe misticizmi.

²⁴ Platoni (Platon, 427 - 347 p. e. r.), mësuesi i Aristotelit. Filozofia e tij paraqet apogjenë e mendimit filozofik grek, veçanërisht në nocionin e idesë, sipas të kuptuarit tjetër idetë e Platonit janë qenie transcendentale, dmth. qenie të cilat ekzistojnë jashtë hapësirës dhe kohës.

Nëse sendet kështu nuk i kuptojmë, si ta shpjegojmë atëherë reagimin tonë të ashpër kur e shohim padrejtësinë? Përse prej të tjerëve kërkojmë të jenë të drejtë? Përse luftojmë me mish e shpirt që të realizojmë diç që nuk ekziston dhe hidhërohemi që nuk po realizohet?

Mendimtari e filozofi idian Vahiduddin Hani²⁵ pohon: “Nëse etja për ujë na dëshmon në ekzistencën e tij, gjithashtu edhe etja për drejtësi medoemos dëshmon ekzistencën e saj. Dhe, pasi që drejtësi ideale në këtë botë nuk ka, kjo është dëshmi në ekzistimin e botës tjetër në të cilën ajo do të realizohet”.

Ndjenja jonë e brendshme, natyrore është argument kategorik se drejtësia, edhe pse ne sot nuk po e shohim, ekziston. Ne nesër do ta shohim. Kjo është bindje e cila buron prej brendisë sonë, e vërteta intuitivisht e inspiruar.

Intuita dhe natyra e pastër janë pjesë përbërëse të natyrës sonë të përkryer e cila nuk mashtron as nuk gënjen. Ky është një prej ligjeve të shumënumërta me të cilën është rregulluar kjo ekzistencë.

Ndoshta dikush do të vërejë: “Ta lëmë anash bashkësinë njerëzore dhe të pyetemi përse All-llahu derrin e krijoj derr, qenin qen, e insektin insekt? Ç’kanë gabuar këto qenie që të krijohen aq të mjera? Ku është këtu drejtësia? Ose, nëse All-llahu do t’i ringjallë të gjitha qeniet me shpirt, përse nuk do ta ringjallë edhe majmunin edhe qenin edhe derrin?”

²⁵ Wehiduddin Hani, njëri prej mendimtarëve më produktivë të botës moderne islame. Shquhet me ide përparimtare, humaniste e universale, por konsekuent para kolonializmit perëndimor dhe kulturës së “pashpirt” të tyre. Ndër veprat e para të tij janë “El-Islam jethaddâ (“Islamizmi thërret në garim”).

Pyetja është me vend, por e shtron arsyeja e cila e di vetëm një pjesë të rastit gjyqësor, ose vetëm një rend të materialit hetues dhe krahas kësaj shpejton të kuptojë aktgjykimin gjyqësor dhe arsyetimin e tij.

Është fakt se të gjitha qeniet shtazore e kanë shpirtin e vet. All-llahu për çdo shpirt e ka zgjedhur formën materiale të cilën ai edhe e meriton. Për këtë edhe All-llahu e krijoi derrin derr për atë se është derr dhe për shpirtin e tij e dha formën materiale të derrit. Ne asgjë nuk dimë mbi shpirtin e derrit para se All-llahu ta ketë frymëzuar në formën e tij materiale të derrit. Nuk e dimë pse, as kur në këtë mënyrë ka pasuar krijimi. E tërë që ka qenë para krijimit, për ne është e panjohur. Gjithashtu e panjohur na është ç'do të pasojë pas vdekjes.

Mirëpo, shkencëtarët si edhe Kur'ani, pohuan se ne, para lindjes kemi qenë pjesë përbërëse të një bote (e quajnë botë të atomit), e se pas vdekjes do të bëhemi botë tjetër. Jeta është e vazhdueshme dhe nuk ka vdekje. Ka të bëjë vetëm me transformimin dhe kalimin në pafund atje ku duke iu afruar All-llahut, do të ngrihemi dhe evoluojmë.

Këtë kontinuitet e pranon edhe logjika njerëzore.

E drejtësia është e vërteta permanente të cilën All-llahu e ka mbjellë në natyrë dhe përbrendësen e njeriut, e madhe, siç është thënë kjo në fillim, edhe në instinktin shtazor. Kjo drejtësi, e vërtetë absolute, do të na thotë se të gjitha format materiale dhe shtazore janë merita të konfirmuara, të vërteta, por mbi detajet e tyre, ose çfarë kanë qenë më parë, asgjë nuk dimë. Instinktivist konkludojmë se këto janë forma merituese që All-llahu e ka krijuar derrin derr sepse shpirti është i derrit, e edhe forma e tij, shpirtit të tillë i është përshtatur.

Në lidhje me ringjalljen e shtazëve Kur'ani këtë e konfirmon:

“Të gjitha shtazët që ecin nëpër Tokë dhe të gjitha shpezët që me krahët e tyre fluturojnë janë popuj (familje) sikur edhe ju njerëzit - Në Libër Ne asgjë se kemi lënë pa e përmendur - dhe do të tubohen (kthehen) pastaj para Zotëriut të tyre. “(El-En'âm, 38).

Këto qenie kanë shpirt dhe për këto Kur'ani thotë se, sikur edhe ne, do të ringjallen. Por, pas kësaj, çdo të ndodhë me ta, ku do të jenë dhe çfarë do të jetë fati i tyre, kjo është e panjohur, gajb dhe do të ishte kjo vetëm orvatje e kotë ta njohim tash për tash të panjohurën. Kjo është kureshtje mbi të cilën nuk mund të fitojmë përgjigje të kënaqshme.

Dhe jo vetëm kjo por edhe orvatja ta njohim një çast të jetës së kësaj bote në të tërësi, edhe kjo është dëshirë e kotë. Mirëpo, nëse e njohim (një pjesë të çastit) dhe me të meditar thellë mësojmë se drejtësia “është e vërtetë permanente dhe se All-llahu e ka mbjellë në natyrën tonë, në intuitën tonë, kemi mësuar mjaft sosh dhe njohur mjaft.

Mënyra me të cilën e njohëm All-llahun, të përshkruar në artikullin tonë të parë, se ky është intelekti gjithinkuadruar, universal, se Ai është Krijues, Inspirator i cili kujdeset për krijesat e veta, kështu duke e menduar kuptojmë si e ka komponuar All-llahu në krijesat e veta atë instinkt orientues, drejtërrëfyes. Ky është rezultat i kujdesit dhe drejtësisë së Tij: të krijojë krijesa dhe dritë e cila do t'ua ndriçojë drejtimin e lëvizjes. Në këtë mënyrë do ta përvetësojmë të vërtetën se All-llahu ka dërguar lajmëtarë të fesë (enbijâ) dhe i frymëzoi me libra. Sepse, All-llahu pa këto nuk do të ishte Krijues, as Inspirator dhe Organizator.

Autentitetin e librave të Zotit lehtë do ta argumentojmë me brendinë e tyre shkencore, zbulimet e tyre të transcendentales (gajb), me urtësi, legjislacione dhe me të vërteta të cilat nuk mund të jenë rezultat i angazhimit dhe njohjes individuale.

Që All-llahu të jetë Krijues (Hâlik), i Drejtë (Adil) dhe Inspirator (Mulhim) i rrugës jetësore (e kjo është pika qendrore e të gjitha feve), ai është pra fillim (i parahershëm) (mubdi) ide të cilën njeriu, pa hulumtime të veçanta, e përvetëson, e këtë të njëjtën ide na imponon natyrshmëria, intuïta jonë.

Çdo pohim tjetër është trillim i thjeshtë.

Përpjekjes, i cili synon kah ajo që ta hedhë poshtë këtë pohim, do t'i nevojitet angazhim i madh, inkonsekuencë dhe manovrim sofistik e edhe diskutim steril që, megjithatë, do të përfundojë me humbje. Përpjekja e tillë nuk do ta ketë bazën e vet të provës; ajo më tepër është rezultat i kokëfortësisë dhe kryeneçësisë sesa të menduarit objektiv dhe instinktit të pastër.

Ky është rezultat i odisejadës sime ideore disavjeçare prej fillimit krenar në librin tim “All-llahu we-l-insân” (“All-llahu dhe njeriu”) deri te qëndrimi devocionues dhe pendues në dyert e Kur'anit, Tewratit (Torës) dhe Inxhilit (Ungjëllit).

Sipas mendimit tim nuk është religjioz njeriu i cili është fanatik, ekskluziv dhe mendon se i Dërguari i tij është i vetmi dhe se All-llahu nuk ka dërguar tjetër. Të prezentuarit e tillë të All-llahut është infantil dhe konservativ. Ajo e paraqet All-llahun si kryepar të ndonjë fisi. Ky është separatizëm, ekskluzivitet e jo religjiozitet. Të përfytyruarit e drejtë të All-llahut është se Ai është shpirtmadh, se të gjithëve u jep dhe të gjithëve u dërgon lajmëtar të fesë (rusul).

“Nuk ka pasur popull të cilit nuk i ka ardhur ai i cili i ka thirrur (tërhequr vërejtjen)”. “El-Fatir, 24).

“Ne çdo populli i kemi dërguar lajmëtar të fesë (resul)”. (En-Nahl, 36).

“E Zotëriu yt kurrë nuk i ka zhdukur vendbanimet deri sa në kryeqytetin e tyre nuk do ta dërgonte të dërguarin.” (El-Kasas. 59).

“... të dërguarë për të cilët tashmë më parë të kemi rrëfyer edhe të dërguarë për të cilët nuk të kemi rrëfyer”. (En-Nisa, 164).

Sipas këtyre, ajeteve të lartcituara, ndoshta edhe Budha, në kohën e tij, ka qenë i dërguar i Zotit, por se nuk është përmendur në Kur'an. Ndoshta edhe Ahnaton, në kohën e tij, ka qenë i dërguar i Zotit, por versionet e mësimit të tij që sot na janë të njohura janë të shtrembëruara.

Për këtë All-llahu na urdhëroi Islamin si fe, sepse kjo është feja e vetme e cila i pranon të gjithë të dërguarit (rusul) dhe të gjithë lajmëtarët e fesë (enbijâ), të gjitha librat e Zotit, dhe e ka përfunduar fenë, ideshmërisht dhe legjislativisht, ia dha shpjegimin e saj burimor: se All-llahu është një, se është i Mëshirshëm, Inspirues se Ai është burimi i të gjitha instruksioneve prej Ademit deri te Muhammedi.

Shembulli më i mirë i sinqeritetit të vetëdijshëm fetar është vetëdija e njeriut siç është Gandi.²⁶ Edhe pse është hindus ai në lutjet e tij citon fragmente nga Kur'ani, Tewrati dhe Inxhili dhe libri

²⁶ Gandi (Mohandas Karamqand Gandhi, 1869 - 1948), në botë më i njohur si Mahatma (“shpirti i madh”) Gandhi. me të kuptuarit e vetvetes (self-realization), me të pamurit e Zotit fytyrë për fytyrë dhe

budhistik Dama Pada.²⁷ Këtë e bën me respekt dhe përkushtueshëm dhe njëkohësisht beson në të gjithë të dërguarit e Zotit dhe librat e Tij, në një Krijues i cili i ka dërguar.

Gandi ka jetuar ashtu siç ka folur. Jetën e ka kaluar në dashuri dhe paqe.

Fetë, nga aspekti dogmatik, janë të njëjta, edhe pse ndahen legjislativisht (kanonisht).

Pra, Krijuesi është një, i Vetmi, sikur që janë edhe besimtarët ortodoksë e të përpiktë të të gjitha feve, bashkëfetarë. Sepse, njeriu i vërtetë religjioz nuk e prezenton All-llahun ashtu sikur vetëm atë ose grupin e tij e ka udhëzuar. All-llahu është, në të vërtetë dritë e gjithësisë dhe Tokës (nuru s-semâwti we -l-erdi), i mbërritshëm për çdokend që përpiqet ta njohë; i Gjithmëshirshëm, Mëshirues, Udhërrëfyes, Zbritës i revelatës në të gjitha epokat dhe kohët. Ky është imperativ i drejtësisë së Tij permanente dhe vetëm të kuptuarit e tillë të qenësisë së Tij është e denjë madhërisë së Tij, Hyjnore.

Pa të kuptuarit e këtyre të besimit gjithpërfshirës besimtari nuk mund të jetë (bëhet) religjioz.

me të arriturit e mokshës (çlirimit spiritual), parimet e tij themelore, i fitoi zemrat e miqve dhe armiqve, brenda dhe jashtë Indisë. Parimi i tij parësor në etikë është ahimsâ ose moskryerja e dhunës, jodetyrimi.

²⁷ Sama-Padam (Dhamma-padam - “rruga e korrektësisë”) në këtë vepër janë përmbledhur 423 thënie të G. Budës në vargje të klasifikuara sipas përmbajtjes në 26 kapitla. Guatama Budha, rreth 558 - 478 p.r.r.(?), themelues i budizmit, më vonë religjionit budistik, i cili përbëhet prej dy pikave parësore: vuajtjes dhe shpëtimit. Jeta është vuajtje, shkaqet e vuajtjeve janë epshet, instinktet, të lirohesh prej këtyre do të thotë të lirohesh prej vuajtjeve, largimi absolut nga këto quhet nirvanë, gjendje ku “fiken” të gjitha kërkesat, fiket “uni” dhe lirohet shpirti nga materia.

Fetë të cilat ndahen në sekte dhe njëra kundër tjetrës, në emër të fesë luftojnë - këta janë flamuj të rrejshëm të ngritur fetarë. Flamuri i tillë i ngritur është nacionalist, shovinist, racist. Këta janë flamujt e idhujtarisë paraislamike, flamujt e Ewsit dhe Hazrexhit²⁸. Odet e Antarit²⁹. Ata edhe pse parashirojnë se luftojnë për All-llahun, në të vërtetë luftojnë për krenarinë e sëmure dhe janë destinuar në shkatërrim, edhe ngadhënjyesit dhe të ngadhënjyerit. Ithtarët e flamujve të tillë janë poliotheiste: secili e ka idolin e vet ose, thënë edhe më mirë, ata e adhurojnë vetveten, kryelartësinë e vet, e jo All-llahun.

Adhurimi i All-llahut fillon me njohjen e Tij dhe madhërisë së Tij, e njohja e All-llahut fillon me njohjen e vetvetes dhe parëndësisë së vet.

Kjo është rruga dhe shkalla nga e cila nisen udhëtarët në udhëtimin e tyre të madh deri te e vërteta.

PËRSE ËSHTË I NEVOJSHËM DËNIMI?

Të arsimuarit kanë vërejtje klasike mbi ringjalljen dhe dënimin dhe thonë: “Përse të na dënojë All-llahu kur Ai është mëshirues, i dhembshëm?” Kur e shtrojnë këtë pyetje ata harrojnë se edhe vetë

²⁸ Ewsi dhe Hazrexhi janë dy fiset e njohura në Medine me të cilat njihemi me ardhjen e Islamizmit këtu. Këto dy fise i përmend edhe Kur’ani, El-Bekare, 85.

²⁹ Antari (Antara Ibn Shedâd, trimi legjendar paraislamik, poet i shprehjes së fuqishme, autor i Muâl-lakes.

pa masë i duan fëmijët e vet e, magjithatë i ndëshkojnë me goditje, i lënë pa para në xhep, si dhe bëhen rigorozë ndaj tyre. Dhe, në qoftë se kjo dashuri ndaj fëmijës është më e fortë, gjithnjë e më i fuqishëm është interesimi i tyre për edukimin e fëmijëve. Në rast se e lënë pas dore edukimin e tyre bota do t'i padisë se nuk i duan fëmijët e tyre dhe për ta do të thotë se këta janë etër të pakujdesshëm dhe se fëmijëve të tyre nuk u kushtojnë kujdes të mjaftueshëm. Nëse rasti i tillë është me njeriun, ç'të themi për Rabb-in (All-llahu) e Madh, pasi që edhe vetë fjala “Rabb” është marrë nga fjala tërbijjet-un (edukata).

Është fakt se neologjizmi “All-llahu është mëshirues (i dhembshëm)” është konstrukcion leksikor i shprehur shkëlqyeshëm që shumëkush gabimisht e kuptojnë dhe i japin domethënie të përgjithësuar duke ia përfytyruar vetvetes se All-llahu, në të gjitha rastet, është i mëshirshëm, e kjo nuk është e saktë.

A e do, për shembull, All-llahu tiraninë?

Kjo është e pamundur!

Është e pamundur që All-llahu ta dojë tiraninë dhe tiranët dhe që, në kategorizmin e Tij, tirani dhe i shtypuri të jenë të nivelizuar. Të përfytyruarit e këtillë të fuqisë dhe drejtësisë së All-llahut paraqet konfuzion ideor.

Është e vërtetë se All-llahu dhe fuqia e Tij janë mbi të gjithë tiranët dhe se është absolutisht i fuqishëm, më i fuqishëm se të gjithë të fuqishmit. Ai është arbitri i drejtë i cili çdo njeri e vendos në pozitën dhe shkallën e merituar.

Në bazë të ligjësive të përgjithshme precize në botën materiale dhe gjithësisë që na rrethojnë, do të veprojmë në mënyrë të drejtë nëse konkludojmë se drejtësia e All-llahut është një prej attributeve të Tij. Disponojmë shpjegimet e shumënumërta, të cilat e konfirmojnë atributin e drejtësisë së All-llahut, ligjësisë, urtësisë dhe rregullimit universal në këtë botë.

Negatorët (mohuesit) e ligjësisë dhe drejtësisë universale janë ata të cilët duhet ta konfirmojnë dhe vërtetojnë se ky rregullim nuk ekziston, e jo besimtarët të cilët besojnë në ligjësinë universale.

Mirëpo, ata të cilët në tërësi e mohojnë dënimin dhe mohojnë se njeriu i është nënshtruar forcës, e cila është më e fuqishme se ai dhe ligjësive të cilat janë mbi atë, të tillët i thërrasim që t'i hedhin vështrim kësaj bote pa nevojë që ta parashtrujnë ahiretin, jetën e ardhshme.

Mendoj se nuk ka njeri i cili nuk e ka shijuar dhembjen e dhëmballës, e cila e copëton trurin dhe sikur sharra e çan kokën. Ose shtangimin në veshkë, dhembje koke të rëndë, dhembje në kërcë, ose tuberkulozën e eshtrave, e këto janë lloje të dhembjeve të skëterrës, i njohin vetëm ata të cilët janë fatkeq, që t'i shijojnë. Vizita e shkurtër repartit të spitalit Kasru-l-Ajn³⁰ do ta bindë vizitorin se ekziston kontrast i madh ndërmjet njeriut të djegur të deformuar të mbështjellë me lidhësa, i cili gjëmon, dhe njeriut i cili, në breg të Nilit, e pi një filxhan çaj, dëfrehet dhe kënaqet pranë bukuroshes e cila e argëton.

Dënimi është realitet konkret dhe njeriu i është nënshtruar forcës, e cila është më e fortë se ai dhe ai nuk ka mundësi që t'i shmanget shtrëngimit të asaj fuqie. Për ne është e barabartë se këtë fuqi besimtari a e quan të “All-llahut” ose ateisti “të natyrës”, “ligje të natyrës” ose “ligj kryesor”. Kjo

³⁰ Spitali i njohur klinik në Kajro (Shën. i A.Hukiqit).

shmangie e emrit të vërtetë s'është asgjë tjetër veçse lojë fjalësh sofistike. Me rëndësi është se ka qenë i detyruar ta pranojë se ekziston fuqia mbi fuqinë e njeriut dhe ndodhitë, dhe se kjo fuqi dënon dhe vë në sprovë.

Njerëzit e ndihsëm, të cilët lebetiten në përfytyrimin e All-llahut si tirani i cili na ndëshkon, do t'i përkujtojmë në atë ç'kanë vepruar disa sundues kur armiqtë e tyre i gjykonin me të ngulur në hu..., do t'i përkujtonim në atë çka bërë xhelati të cilit i qe besuar ekzekutimi i dënimit. Ai sakrificën do ta vënte në bark dhe në pjesën e mbrapme të trupit do t'ia ngulte hurin, i cili në maje ka qenë i mbushur me gozhda. Xhelati hurin shkallërisht do ta ngallmonte ashtu që t'ia shqyente organet e brendshme në tërësi dhe huri të dalë te qafa e sakrificës. Detyra e xhelatit ka qenë që sakrificën ta mbajë sa më gjatë gjallë, deri sa huri të dalë në qafë, në mënyrë që t'i ndjejë të gjitha dhembjet e domosdoshme.

Ende më rëndë se kjo është të verbuarit e robërve me hekur të skuqur.

A mundemi të supozojmë se All-llahu (xh. sh.) tiranëve të tillë do t'u përgatisë koktej sepse All-llahu është i dhembshëm dhe i mëshirshëm?

Jo, por skëterrë - kur tashmë nuk ka ekzistuar mjet tjetër që të tillët ta njohin dhe të binden se ekziston Zoti i drejtë - është pika skajore, e fundit e mëshirës.

Në të vërtetë, ky ndëshkim është mëshirë duke e marrë parasysh se kjo është masë edukative dhe këshilluese për ate i cili këtë e ka refuzuar të mësojë prej të gjitha librave të Zotit dhe prej lajmëtarëve të fesë (rusul), për ata të cilët i kanë mohuar edhe njohjet primare të arsyes dhe aksioneve të njeriut.

Vallë, është e drejtë që Hitleri, në Luftën e Dytë Botërore, të mbysë njëzet milionë njerëz³¹, që njerëzit e tij ta rrjepin lëkurën nga robërit, që mijëra njerëzve t'u zihet fryma në gypat e gasit dhe t'i djegë në furra dhe që, në çastin e kapitullimit, duke ikur nga pasojat e veprave të veta të këqija, të bëjë vetëvrasje? Vetëm disharmania dhe paqëllimësia e tërësishme e kësaj bote dhe papërshtatshmëritë e saj mund ta shpëtojnë këtë doras total nga mëkati i tij.

Me fjalë të tjera, çdo gjë që na rrethon, në këtë rruzull përkryeshmërisht të rregulluar e të bukur, nuk flet mbi disharmoninë, të gjitha, prej yjve më të mëdhenj e deri te atomi më i imtë, flasin mbi rendin dhe rregullin. Për këtë, All-llahu nuk do të ishte i Mëshirshëm, as që do të jetë i drejtë, përveç nëse këtë njeri do ta vinte në ambisin e veprave të këqija të tij.

Njeriu i mençur, subtil dhe i arsyeshëm nuk duhet të filozofojë që ta kuptojë vërtetësinë e dënimit. Ai, së shpejti, edhe do ta zbulojë arsyetimin e këtij dënimi në vetvete, në vetëdijen e vet, në sytë e mëkatarit, në shikimet e dorasve, në lotët e fatligëve, në dhembjet e të pezmatuarve, në nënçmimet e të zënëve robër, në tiraninë e ngadhënjyesit, në gurgullimin (gërhatjen) e atyre që vdesin. I tilli, kur ta përfshijë ndjenja e pendimit - e pendimi në çastin e mëkatit është zëri i të vërtetës - do ta kuptojë esencën e dënimit (adhâb) dhe dhënies së llogarisë (hisâb). Kjo llogari me vetveten, ky është kijamet në miniaturë, skëterra më e vogël, kjo, në mënyrë plastike thënë maketa e ditës së Gjykimit. Kjo është drita që jep shënjë në rrezik, e cila ndizet në shpirtrat tonë të tregojë se veprat do të maten, se ekziston e vërteta dhe e pavërteta dhe, kush është në rrugën e

³¹ Nuk e di se në ç'kuptim është përdorur ky numër, kur dihet se anekënd botës gjatë Luftës së Dytë Botërore kanë vdekur rreth 56 milionë njerëz.

drejtë edhe zemrën do ta ketë të qetë, e kush është në rrugën e shtrembër do të jetë greminën e pendimit dhe me zemër të zhgënjyer e të dëshpëruar.

Dënimi i kësaj bote është gjithnjë masë edukative, qoftë se ka të bëjë me individin ose popullin. Humbja më 1967 në Sinaj³² ka qenë leksion , mësim, sikur që ngelja e nxënësit në shkollë është mësim. Gjithashtu dhembjet e të sëmurëve dhe shëndeti i dobët, në krahasim me njeriun i cili ka jetuar jonormalisht - është dëfryer në luksoz dhe bollëk - janë mësim.

Vuajtja ia heq ndryshkun dhe korrozionin shpirtit dhe i jep shkëlqim metalit të tij.

Më në fund, nuk dimë asnjë të dërguar (nebi), as reformator (muslih), as artist (fennân) ose gjeni (abkarij), e që nuk i ka shijuar vuajtjen më të rëndë qoftë se ka të bëjë me sëmundjen, varfërinë ose internimin.

Vuajtja, e shikuar nga ky kënd, është mëshirë dhe ajo, në këtë rast, paraqet tatim të obligueshëm, dhuratë e cila paguhet për kalim në shkallën më kualitative.

Nëse, nganjëherë, nuk mundemi ta zbulojmë enigmën e mësimin dhe urtësisë së dënimit, kjo është për atë që nuk kemi mundur ta kuptojmë as ta njohim tërë rrëfimin, por vetëm atë epizodë e cila është ndërmjet kllapave dhe të cilën e quajmë të kësaj bote. Por, ajo që ka ndodhur para kësaj dhe që do të ndodhë pas kësaj, kjo për ne është transcendentale, e panjohura sekrete. Për

³² Autori aludon në disfatën e rëndë ushtarake në luftën ndërmjet Egjiptit dhe Izraelit. (Shën. i A. Hakiqit).

këtë, në lidhje me këtë, duhet të heshtim me respekt dhe që mbi këtë të mos i shfaqim mendimet tona.

Çfarë do të jetë dënimi pas ringjalljes (ba'th), ne mbi këtë nuk mundemi të detajizojmë, sepse çdo gjë që është e lidhur me Ahiretin është transcendentale. Është e lejuar të parashtrojmë se ajo që në këtë kuptim është thënë në librat e shenjtë në mënyrë alegorike dhe në aluzione, është e ngjashme me atë sikur t'i flasim fëmijës mbi kënaqësitë e marrëdhënieve seksuale, të cilat mund t'i përjetojë vetëm në moshën madhore, sepse në fjalorin e tij fëmijëror nuk mundemi të gjejmë nocion adekuat. Kështu diç e ngjashme është edhe me xhennetin (parajsën) dhe xhehennemin (skëterrën). Me fjalë tjera, përvojat me këto dy nocione, në lidhje me ne, janë transcendentale dhe është e pamundur të përshkruhen me fjalët e përvojës së kësaj bote. Krejt që në këtë aspekt mund të bëhet, kjo është që përafërsisht të përshkruhen, siç është përshkrimi i zjarrit ose parqeve të mrrekullueshme përfundi të cilave rrjedhin lumenjtë; e, në të vërtetë, ç'do të ndodhë, kjo është mbi të gjitha këto përshkrime të përafërsishme, këto janë gjëra dhe fenomene të cilat s'i ka parë syri i njeriut, as s'i kanë rënë ndërmend njeriut.

Vetëm se sigurisht mund të thuhet se skëterra është vuajtja më e madhe shpirtërore dhe fizike e cila mund të përjetohet dhe se parajsa është përjetimi më i madh fizik dhe shpirtëror i begative dhe kënaqësive.

Sufitë thonë se xhehennemi është vend i largësisë dhe i izoluar prej All-llahut, e xhenneti vend i afërsisë së Tij dhe gjithë asaj që kjo afërsi e bart me vete: fatin të cilin është e pamundur të përshkruhet.

“Ai i cili në këtë botë ka qenë i verbër, ai edhe në botën tjetër do të jetë i verbër edhe më rrugëhumbur”. (El-Isrâ, 72). Verbëria, në këtë rast nënkupton zemrën e verbër, mosaftësinë për ta vrojtur të vërtetën.

Në të vërtetë, ky është shkallëzim dhe krahasim ndërmjet të verbërit dhe njeriut që sheh, atij që është në rrugë të drejtë dhe atij në rrugë të shtrembët. Mirëpo, në Ahiret këto kontraste do të jenë shumë më të mëdha.

“Shiko se si disave iu japim përparësi ndaj disave; e në Ahiret dallimi në shkallë dhe prioritet do të jetë, vërtet, i madh”. (El-Isrâ, 21).

Dallimet do të jenë aq të mëdha saqë gjendja e njeriut në shkallën e ulët do të jetë sikurse po digjet në zjarr, edhe më keq. Ky është i njëjti po ai ligj i shkallëzimit i cili dominon në tërë botën fenomenale, qoftë që ka të bëjë me këtë apo jetën pas vdekjes, të njeriut apo hyjnisë, për shqisat tona me botën e dukshme apo të padukshme. Çdo gjë do ta ketë gradën e vet dhe meritën e vet. Dy persona nuk do të nivelizohen.

Kalimi prej shkallës në shkallë do të jetë vetëm në bazë të angazhimit, veprës, përvojës dhe vuajtjes. Së këndejmi edhe konkludimi se në jetën pas vdekjes në shkallën më të ulët do të jetë ai, verbëria zemrore e të cilit në këtë botë ka qenë më e madhe.

Në këtë është esenca e drejtësisë: që çdo njeri të vendoset në vendin, kategorinë dhe meritën e vet. Ai i cili në këtë botë përjeton tirani, do të fitojë në jetën pas vdekjes kënaqësi. Drejtësia e marrë do të konpensohet.

Dënimi (adhâb) kështu i kuptuar, në të vërtetë është drejtësi, e shpërblimi (thevâb) gjithashtu është drejtësi, e të dyjat janë rezultate të domosdoshmërisë. Kjo është e ngjashme sikur kur themi se prej çelikut më të fortë të konstruktohet motori, prej materies së butë të kauçukut të fabrikohen gomat e forta automobilistike, prej melekuqes së lirë fshisa, prej pambukut kualitativ jastëkët, e prej atij kuantitativ - pejëzat për gypat e kanalizimit.

Këto janë aksionet për të cilat na flasin instikti dhe logjika e arsyes. Këtyre konkludimeve nuk u nevojiten shkrimet elokuate filozofike as arsyetime të veçanta.

Së këndejmi, edhe konfirmimi se të gjitha fetë janë manifestim i të natyrshmes, jokontestueshmes, edhe ai nuk mund të rrëzohet. Për këtë mësimet e tyre janë e vërtetë absolute, të pranueshme me arsye të pastër të cilën nuk e ka shtrembëruar filozofia dhe sofizmi i izoluar, kjo është arsyeja e cila e ka ruajtur urtësinë, mendjemprehtësinë e vet dhe nuk është e ngarkuar me kryeneçësi dhe mendjemadhësi. Për këtë sufij-a (mistiku) edhe thotë se All-llahu s'është i nevojshëm për argumente, porse All-llahu është argument me të cilin çdo gjë tjetër argumentohet. Me të ekzistuarit, dhe domosdoshmërinë e All-llahut e definojmë dhe e njohim ndryshmërinë (kontingjencën). Ai është substancë me të cilën e njohim nduarnduarshmërinë fenomenale. Ai është l o g o s³³ nëpërmjet të cilit e mësojmë urtësinë e kësaj bote kalimtare.

Intelekti (akl) i cili kërkon argument për të ekzistuarit e All-llahut, ky është intelekt i cili ka pushuar të mendojë, sepse drita na i zbulon gjërat dhe na tregon për to. Mirëpo, gjërat e

³³ Logos (Logos), logjikë, arsyeja, fjala e All-llahut e cila dominon në gjithësi dhe e përshkon; burim i revelatës dhe inspimit.

ndriçuar nuk janë argumenti jonë për dritën, - në të kundërtën do të ngatërroheshin premisat, si ndokush që gjatë ditës udhëton dhe pastaj pyet: “Ku e ke argumentin se është ditë? Ma konfirmo këtë me argument?!”

Do të vërenim edhe këtë se njeriu i cili e ka humbur pastërtinë e karakterit dhe dëlirësinë e zemrës, është i humbur. Të tillit nuk i mbetet asgjë tjetër, veçse të polemizojë. I tilli e ka humbur çdo gjë. Ai vazhdimisht do të endet dhe kurrë në cak nuk do të arrijë.

Atij që do të ishte kundër dënimit në këtë botë, i cili tronditet, zemërohet dhe e mallkon jetën dhe konfirmon se kjo është jetë e cila nuk mund të durohet, se ai e refuzon, se askush nuk e ka konsultuar para se që është lindur, ose me dhunë është krijuar, se me dhunë është gjykuar në vuajtje dhe se tërë kjo paraqet tirani eklatante, do t'i thonim se të refuzuarit e këtillë (të jetës) me pakënaqësi, është i ngjashëm me artistin që e ka rolin në dramën e cila kërkon që artisti çdo ditë para shikuesve, të pranojë goditje dhe ta shkelin.

Sikur, për shembull, ky ta kishte humbur memorien dhe në shiritin filmik nga jeta e vet ta shohë vetëm këtë rol të cilin ai, si prerje nga tërësia, e luan çdo ditë në skenë, ai së shpejti do të protestonte duke refuzuar të durojë mundime dhe do të thoshte se askush nuk e ka konsultuar, se me dhunë është krijuar, se tiranisht është gjykuar të vuajë, se pa shkak të arsyeshëm para opinionit është nënçmuar dhe se në këtë botë është pa vullnetin e vet të lirë.

Ky artist harron se para fillimit të programit, ka ekzistuar kontrata. Ka paraprirë obligimi prej regjisorit dhe artisti e ka pranuar këtë obligim, e pastaj është obliguar dhe ka kontraktuar se obligimet do t'i kryejë. Krejt kjo ka ndodhur në liri të plotë para se të ketë filluar programi dhe

artisti vullnetarisht e ka pranuar rolin e vet³⁴. Madje e ka pëlqyer rolin e vet dhe është orvatur që ta luajë.

Mirëpo, artisti, para se të ketë dalur në skenë, krejtësisht ka harruar periodën e vet kohore. Për këtë jeta e tij, me obligimet dhe dhembjet e tij është shndërruar në pikëpyetje dhe misterie të pakuptueshme.

Kështu do të silltet njeriu i cili merr me mend se jeta e tij e tërësishme është përfshirë në ekzistencën fizike, në këto disa çaste të kësaj bote, dhe se do të zhduket dhe mbarojë në tokë, dhe se nuk do të ketë kurrfarë ekzistence tjetër përveç kësaj tredimensionale në skenën e kësaj bote.

Ky njeri ka harruar se ka qenë shpirt (ruh)³⁵ në botën e All-llahut, se në botë ka ardhur me detyrë, se vullnetarisht e ka pranuar këtë obligim dhe se ndërmjet tij dhe krijuesit të tij (regjisorit më të madh të dramës në botën fenomenale) janë bërë kontratat dhe obligimet, se pas dramës së luajtur fenomenale - botërore të kësaj jete, do të pasojë ringjallja (ba'th) dhe dhënia e llogarisë (hisâb), dhe se pas lojës së përfunduar kritikët do ta japin fjalën e vet. A ka fituar artisti në popullaritet apo ka humbur në sytë e tyre.

Ka të bëjë me harresën, mospërfilljen dhe shikimin e ngushtë, të kufizuar i cili përfytyron se kjo botë është çdo gjë. kjo është ajo imagjinatë e cila na mashtron dhe na shpie në dilemë, para çështjeve të dënimit të keqes dhe të dhembjes.

³⁴ Autori aludon në ajetin 9 të kaptinës Es-Sexhde.

³⁵ Këtu aludohet në ajetet 30 e sa të kaptinës El-Bekare.

Së këndejmi, edhe erdhi emri për Kur'anin se është Vërejtje, Përkujtim (Paralajmërim), Sjellje ndërmend, mësim për të arsyeshmit, mençurit. Mandej edhe i dërguari i Zotit është qortues, përkujtues:

“Tërhiqua vërejtjen!, ti je vetëm qortues, e jo detyruës”! (El-Gashije, 22)

Bota nuk është tërë rrëfimi. Ajo është vetëm akt, pjesë e dramës. Fillimi i rrëfimit ka lindur para lindjes dhe ai vazhdon pas vdekjes.

Në shikimin e këtyllë përfshirës dënimi e ka domethënien e vet. Kështu dënimi në këtë botë fiton domethënie të mëshirës së të Mëshirshmit me të cilën Ai na paralajmëron që të mos bijmë në neglizhencë. Kjo është përpjekje që të zgjohemi, t'i angazhojmë shqisat, që arsyeja të kërkojë përgjigje. Kjo është vërejtje permanente që kjo botë s'do të jetë parajsë, as që kjo mund të jetë. Ajo është vetëm episodë. Dhe se dhënia pas kënaqësive të kësaj bote e orienton të zhyturin e tillë në neglizhencë dhe apati shkatërrimtare.

Pra, ka të bëjë me dënimin sa për sy e faqe i cili, në esencë, është mëshirë.

Sa i përket dënimin në Ahiret, ai është njohje dhe përjetimi i të vërtetës dhe drejtësisë absolute të cilës nuk do t'i shpëtojë “atomi i të mirës, as atomi i të keqes”, e kjo është “jekin”, dije autentike mbi rendin e përgjithshëm të rregullatorit i cili çdo gjë aq shkëlqyeshëm e ka krijuar.

“Wa'bud rabbeke hattâ je'tijeke-l-jekin” (El-Hixher, 99).

“Adhuroje krijuesin tënd deri sa të vijë jekini” e “jekin” këtu do të thotë vdekje dhe ajo që pason pas saj.

Ç'MËSOVA NGA VETMIA?

A je i sinqertë?

Kjo është pyetje në të cilën të gjithë pozitivisht dhe shpejt do të përgjigjemi, sepse të gjithë ne për vetveten parashtrijmë se jemi të sinqertë dhe se nuk gënjejmë. Ndonjëri do të pranojë një a dy gënjeshtër të vogla, por të gjithë konsiderohemi jashtëzakonisht precizë dhe të sinqertë dhe se denjësisht e flasim të vërtetën.

Përveç kësaj, të lejojmë që së bashku ta vështrijmë këtë pohim evident, dhe së shpejti do të konstatojmë se si sinqeriteti është send mjaft i rrallë dhe se njeri plotësisht i sinqertë thuhet nuk ekziston.

Është evidente se shumica prej nesh e mashtrojmë vetveten kur supozojmë se jemi të sinqertë. Sepse, ne, madje edhe para se ta kemi hapur gojën, fillojmë të gënjejmë nga çasti i zgjimit në mëngjes. Me fjalë tjera, nganjëherë edhe vetë mënyra e të krehurit të cilën e kemi zgjedhur bëhet gënjeshtër; plaku i cili, që të duket më i ri, i lëshon flokët si tinxher - gënjen; gënjen edhe plaka e cila i ngjyros flokët e saj që të duket më e re.

Gënjeshtër është edhe tufa e flokëve nga tembla e cila e mbulon rrashtin e kresë së “qelanit”. Gënjeshtër është edhe proteza në gojën e dhëmburimit. Gënjeshtër janë edhe rrobat e lehta prej tergalit të cilat i fshehin teshat e ngrohta, prej leshit. Këto të njëjtat janë edhe korsetat dhe brezat rreth gruas barkoshe. Kraholi artificial i plastikës në gjinjë për thithje të femrës së lodhur, - është gënjeshtër. Të shminkuarit (kozmetika) me të cilën njeriu dëshiron t'i mbulojë rrudhat, edhe kjo

është lloj i gënjeshtërs memeece. Pudra, të kuqtë e buzëve, surma, makijazhi në sy, qerpikët artificialë, të gjitha këto janë tashmë gënjeshtër të bëra para se ta hapim gojën e të flasim.

Edhe gërsheti i nxënëses në kokën e vashës tridhjetëvjeçare paraqet gënjeshtër. Gënjeshtër është dhe mjaft keq ndikon goma përtypëse në gojën e njeriut në moshë. Të gjitha këto e bëjnë njeriun gënjeshtër edhe pse ende as gojën nuk e ka çelë.

E kur dikush e çel gojën dhe thotë: “Mirëmëngjesi!”, ai këtë e thotë nga shprehia dhe tradita. Këtë ia thotë edhe atij që ia do të mirën edhe atij që s'ia do të mirën. Prandaj, edhe këtu gënjën, sepse me fjalë ia ka dëshiruar mirëmëngjesin edhe njeriut ndaj të cilit është i disponuar armiqësisht.

Ose, kur dikush e ngren dëgjuesen e telefonit dhe i kërkon gjërat të cilat vërtet nuk i dëshiron, por këtë e bën vetëm nga kurtoazia; edhe kjo është gënjeshtër. Nganjëherë po ai i njëjti, për shkak të turpit ose oportunitetit do të refuzojë diç që do të dëshironte ta posedojë; edhe kjo është gënjeshtër. Jo të sinqertë janë prindërit dhe vajza të cilët dy orë të gjata bisedojnë për çdo gjë, vetëm jo për atë për çka njëri tjetrit më së shumti do të dëshironin t'ia besonin.

E rrejtshme është edhe reklama me të cilën përshkruhet shija e cigares dhe dobitë e saj shëndetësore. Rasti i njëjtë është edhe me reklamën e cila pohon se pilula e aspirinit e shëron ftohjen. Kjo është gënjeshtër edhe nga aspekti i farmakologjisë.

Çdo gjë që ndodh në botën e shitblerjes fillon me gënjeshtër.

Ta rikujtojmë reklamën e tenistit në dorën e të cilit shohim shishen e uiskit dhe fotografinë e luanit i cili përqafton shishen e verës. Ose fotografinë e sprinterit të njohur i cili e pi cigaren e

duhanit nga Virginia. Të gjitha këto janë gënjeshtër të zbukuruara të cilat i shohim të ngjitura në mure, në faqet e para të gazetave, në reklamat e kinemasë dhe televizionit, - sikur gënjeshtër të ishte bërë traditë komerciale së cilës nuk i shihet për të madhe.

Po ashtu në botën e politikës dhe politikanëve, në kuloarët e Kombeve të Bashkuara dhe në fjalorin e diplomatëve hasim se si gënjeshtër është rregull. Madje edhe shkathësia është aftësi e lartë diplomatike që gënjeshtërën ta prezentosh si të vërtetë, të thuash diç ashtu sikur këtë nuk dëshiron ta thuash, të fshehë ç'dëshiron, që sa për sy e faqe të duash çka vërtet e urren, që sa për sy e faqe të urren çka vërtet e do.

Me këtë rast më kujtohet anekdota e cila tregohet për Çerçilin kur e ka parë epitafin në të cilin shkruante: “Këtu pushon njeriu i sinqertë dhe diplomati i madh”, e Çerçili duke e qeshur shtoi:

“Kjo është hera e parë që t'i shoh dy njerëz të varrosur në një arkivol”.

Me fjalë tjera, sipas mendimit të Çerçilit, është i papajtueshëm sinqeriteti dhe kualitetet e politikanit të lartë, janë të papajtueshme te një njeri sepse, sipas Çerçilit, gënjeshtër është parakusht i politikës së shkathët.

Kushti i politikës është që, për shkak të interesit, ta fshehësh, të vërtetën dhe ta pengosh simpatinë, e të shërbehesh me dinakëri, subtilitet, mendjeprehtësi dhe me përgjigje ekuivoke - hipokrite. Diplomati i cili publikisht e manifeston simpatinë e vet, është diplomat i marrë. Thënë ndryshe, ai kurrë s'do të bëhet diplomat.

Edhe në botën religjioze dhe në sferën e liturgjisë gënjeshtër e fshehtë përgjon në formën e ceremonialit ekstrem dhe formalizmit të tepruar. Ta marrim për shembull muajin e agjërimit

muajin e abstenimit nga ushqimi i cili është shndërruar në muaj të grykësisë e për këtë çpiken paragiellat (antipastet), mezellëqet, gjellat aromatike dhe delikateset prej kadaifit deri te pitet e shumëllojshme. Konsumi i mishit në muajin e Ramazanit po rritet, e të dhënat statistikore na flasin se ngjitet deri te konsumimi i dyfishtë dhe në këtë mënyrë muaji i Ramazanit po shndërrohet në muaj të pjatave dhe grykësisë.

Prej njëqind musal-live (atyre që falin namaz) prej tyre më shumë se nëntëdhjetë qëndrojnë të kthyer kah All-llahu të dekoncentruar, mendimet e tyre në namaz janë të lidhura për interesat e tyre në këtë botë. Ata mendojnë se po i luten Zotit e ata, në të vërtetë, po u luten interesave dhe synimeve të veta dhe përulen që Zoti (xh.sh.) vetëm t'ua realizojë synimet dhe interesat e tyre.

Ose për shembull papët mesjetarë kanë jetuar në luksozin mbretëror e sulltanor dhe kanë notuar në ar, mëndafsh, sundim dhe ndikim. Kanë qenë feudalë të pasur dhe kanë poseduar pallate dhe të gjithë këtë në emër të fesë dhe Ungjellit, i cili thotë se pasaniku nuk do të hyjë në mbretërinë e Zotit përveç nëse deveja hyn nëpër vrimën e gjilpërës. Kanë shkuar edhe më tej dhe kanë menduar se janë zotërinj të parajsës dhe kanë shitur shkresa për faljen e mëkateve (induljenca).

Në “Vendin e dashurisë” gjejmë se mashtrimi i vetvetes është sistem i gjithëpranueshëm: secili me vetëdije dhe pa të e mashtron vetveten, e nganjëherë edhe tjetrin. Dy të dashuruar bisedojnë mbi dashurinë dhe secili, veç e veç, dëshiron të ofrojë dëshmi me nder të arsyes së pranueshme që të arrijë në krevat. Edhe dashnorit i duket se është çmendur prej dashurisë e ai, në të vërtetë, kërkon mjet që të ikë nga njëmendësia e hidhur.

Në mjediset e qytetëruara dashuria praktikohet si lloj i humbjes së kohës ose si lloj shkathtësie dhe përvoje, ose si aspekt i suksesit të personalitetit.

Nganjëherë fjala dashuri përdoret si gënjeshtër e mjaltë, e cila e mbulon dëshirën e egër të posedimit, nënshtrimit dhe supremacionit. Nganjëherë, prapëseprapë, fjala dashuri përdoret si plan dhe grackë e mirë që të arrihet deri te trashëgimia. E në formën më të shpeshtë dhe më të përhapur fjala dashuri është mjet që të arrihet kënaqësia e epsheve dhe mënyrë që të qetësohet ndërgjegjja, që të mposhtet trupi dhe të mënjanohet afektacioni (jonatyrshmëria).

Ai është mendimi ynë permanent me ndihmën e së cilës e tejkalojmë kompleksin e mëkatit. Kështu femra nga vetja do ta heqë edhe copëzën e fundit të teshës duke e bindur vetveten se këtë po e bën sepse është sakrificë e dashurisë..., se dashuria është ndjenjë e pastër, se kjo është caktim i Zotit, se kjo është fati dhe se ajo nuk është e para e cila ka dashuruar, as e fundit e cila është flijuar.

Nuk ka rrenë më të rafinuar se ajo në dashuri. Këtu në çdo fjalë është rrena, në çdo kontakt e pavërteta. Edhe vetë instikti seksual, edhe ai është i rrejshëm, sepse ai aq lehtë zgjohet, e edhe lehtë fiket. Ai aq shpejt ngihet dhe kërkon ndërrimin e shijes.

Sinqeriteti në dashuri është i rrallë, më i rrallë se elmazi (diamanti) në shkretëtirë. Sinqeriteti në dashuri është etika e lojalëve reciprokisht, e jo shfaqje e simpatisë së rëndomtë. Trillohen poezi të dashurisë dhe tregime romantike, dhe, nga ana e tyre, bëjnë komplot që ta thurin (trillojnë) fijen e gënjeshtrave të dekoruara dhe të bukura, ndërtojnë kala në ajër dhe ëndërrojnë ëndrra trëndafil, fotoqafim fotografimi dhe të shkëlqyeshme mbi puthjen, përqaftimin dhe kontaktin në shtrat, i përshkruajnë kënaqësitë e vuajtjeve dhe vuajtjet e kënaqësive, përmallimin e zhveshjes (privimit), lotët në shtrat, alivanosjet tronditëse, njohet mbi ndarjen dhe mjegullat, mjegullat..., aromat dhe pikturat tërheqëse të pikturuara me furçën e artistëve, gënjeshtarëve të mëdhenj.

Gënjeshtra në art është traditë klasike të cilën ka herë e kanë filluar poetët. Odat dhe satirat (përqeshëset) klasike në poezinë tonë, arabe, dëshmojnë për shtrirjen e kësaj tradite të keqe.

Arti është produkt i epsheve, ideve dhe temperamentit, e temperamentit dhe karakteri janë të ndryshueshëm.

Gënjeshtra, vërtet, ka shumë!

Ne, vërtet, gënjëjmë edhe kur hamë, sepse hamë edhe kur jemi të ngirë.

Ku është, pra, sinqeriteti?

Kur do të pasojë ai çasti i vlefshëm kur do ta themi të vërtetën dhe kur vetëm ajo do të vijë në shprehje?

Ai vjen shumë rrallë. Ai do të lajmërohet në laboratoriumin e shkencëtarit kur ai shikon në mikroskop që të kërkojë të vërtetën. Në këtë moment arsyeja jonë njëmend me plot zjarr dhe sinqeritet hulumton dhe absolutisht në mënyrë objektive e kërkon të vërtetën. Ajo objektivisht, në dritën e numrave precizë, normativave dhe vlerësimeve mediton. Vetëm shkenca është shikim objektiv, i pavarur nga devijimi dhe temperamentit njerëzor. Mjet shkencor është vetëm metoda e vërtetë induktive, fiziognomike.

Momenti tjetër i sinqertë është ai i vetmisë, i kuvendimit me vetveten, kur fillon dialogu i brendshëm, ai kuvendim në vetmi kur nuk ka vesh tjetër të përgjojë. Kjo të zënit besë, pranim, nxjerrje e sinqeritetit prej thellësisë më të madhe të njeriut në nivelin e vetëdijes, në shtangimin e sinqertë që të kuptohet - ajo është një prej çasteve më të çmueshme. Atëherë, në këtë moment,

jeta pushon të rrjedhë që ta shprehë sekretin e vet. Atëherë edhe koha pushon që kësaj ndjenje mezi të kuptueshme t'ia mundësojë prezencën, sepse atëherë jemi para të vërtetës, atëherë nuk mund të gënjejme, mashtrujmë dhe falsifikojmë, sikur që nuk mund të bëjmë këtë në çastin e vdekjes dhe në kramzën (grahmën) e saj.

Atëherë, në atë çast, zbulojmë se tërë jetën e kemi jetuar për këtë çast, se kemi vuajtur dhe kemi duruar që të arrijmë deri te kjo njohje e vlefshme mbi shpirtin tonë.

Rasti i këtyllë pason, ndoshta, një herë në jetë, dhe se vlera e tij është e barabartë me tërë jetën. Nëse ky çast vonohet dhe paraqitet pikërisht në çastin e vdekjes, tërë jeta është humbur, ka fërshëlluar pa rëndësinë e vet, pa kuptimin e vet, pa urtësinë e vet. E kanë ngrënë rrenat dhe ardhja në veti ka pasuar shumë vonë.

Për këtë, kuvendimi me vetveten për njeriun bashkëkohës, të humbur në labirintin e rrenave e falsifikateve, është domosdoshmëri dhe shenjtëri. Ky kuvendim për njeriun bashkëkohor paraqet shokën shpëtuese dhe barkën për shpëtim.

Njeriu vetë lindet, vetë vdes dhe fillikat vetëm arrin deri te e vërteta. Dhe nuk e teprojmë, kur, duke e përshkruar këtë botë, themi se është e rrejshme, ose është e pavërtetë dhe se këto të gjitha janë kapje të erës. Sepse, krejt çka na rrethon në këtë botë fenomenale, çdo gjë është rrenë dhe falsifikim. E mbysim njëri tjetrin për shkak të mashtrimit, mburrjes dhe krenarisë së rrejshme.

Bota më tepër është komedi sesa do të ishte tragjedi.

Por, megjithatë ne digjemi për të vërtetën dhe të lumtur vdesim. Ndjenja për të vërtetën e përmbush tërë qenien tonë edhe pse jemi të paaftë që deri tek ajo të mbërrijmë. Ne, edhe pse

është rreth nesh, nuk e shohim, por me plot zemër e ndjejmë. Dhe pikërisht kjo ndjenjë vërshuese, është argument se e vërteta ekziston.

Edhe pse nuk e kemi parë të vërtetën, edhe pse deri tek ajo nuk kemi arritur dhe mbëri, ajo është në ne. Ajo është pikërisht kjo e cila na motivon, ajo është ideali absolut i cili as për një çast nuk e lëshon ndërgjegjen tonë dhe arsyeja jonë përherë mallëngjen për atë.

Çasti i meditimit të pastër na shpie kah e vërteta. Të njëjtën e bën edhe shkenca. Në të njëjtin drejtim lëviz edhe kontrolli ynë i brendshëm, vetëdija. Edhe arsyeja jonë na orienton kah e vërteta.

E vërteta në Kur'an është sinonim i All-llahut, dhe e vërteta el hakk është një prej emrave të Zotit, esma-ul-husna.

Të gjitha këto përjetimet tona të brendshme, indikatorët dhe orientuesit tregojnë se e vërteta ekziston. Vetëm ajo është sipër kësaj bote, ajo e tejkalon. Ne atë me sy nuk e shohim, por e përjetojmë. Atë e dëshmojnë shpirtrat tonë, me tërë fuqinë dhe impulsin e tyre.

Për këtë vërtet habitemi me atë i cili kërkon dëshmi për ekzistencën e Zotit, për ekzistencën e të vërtetës. Me pyet për të vërtetën, kurse ajo e përshkon tërë qenien e njeriut, ajo e ka pushtuar tërë zemrën e tij!

Si të bëhet objekt dyshimi diç që është pika qendrore të cilën e synojnë të gjitha zemrat, e dashur nga të gjitha zemrat dhe synim të gjitha arsyeve?

Si të dyshmojmë në të ekzistuarit e saj, e ajo i ka pushtuar dhe ka dominuar mbi të gjitha ndjenjat tona?

Si të dyshojmë në të vërtetën dhe për ekzistimin e saj të kërkojmë argumente në të pavërtetën?

Si të rrëshqasim mbi dykuptimësinë logjike deri te kundërthëniet dhe që ekzistencën primare, reale dhe vërtetësinë e saj ta bëjmë hipotetike?

Në këtë rast unë vërtet nuk gjej këshillë më të çmueshme veçse të them që të gjithë t'i kthehemi natyrës sonë të pafalsifikuar të pastër, virgjër, të dliurë, të cilën nuk e ka ndotur pseudologjia e izoluar dhe të persiaturit ekuivokë, që secili në vetminë e tij, me meditimet personale të kërkojmë përgjigje në zemrat tona. Zemrat tona do të përgjigjen në çdo gjë.

Me fjalë tjera, All-llahu u ka dhuruar zemrave tona atë kompasin, i cili nuk gabon, e të cilin e quajmë intuitë, aksiomë kongentiale. Intuita nuk mund të mashtrojë as të shrembërohet dhe deformohet, sepse ajo është boshti i botës fenomale, pika e saj qendrore, fusha e saj e gravitacionit dhe mbi të ndërtohen të gjitha njohjet dhe kuptimet.

“Me përkushtim ktheja fytyrën tënde natyrës së All-llahut, sipas së cilës Ai i krijoi njerëzit. Nuk ka ndryshime në të krijuarit e Zotit”. (Err-Rrum:30).

All-llahu këtë intuitë të njeriut (në Kur'an të quajtur el-fitretu) e ka bërë që ta kërkojë, dhe këtë vazhdimisht, sikur që i kërkon kompasin polet e veta dhe jep shenjë në to.

Për këtë çdokush le të jetë i tillë si ia dikton këtë natyra e tij dhe asgjë më shumë. E natyra së shpejti do t'i japë shenjë në të vërtetën.

Pa vështirësi natyra e njeriut do ta orientojë njeriun kah All-llahu.

Bëhu vetëm ai që je!

Shpirti yt do të të udhëzojë në rrugën e drejtë.

BARASPESHA MADHËSHTORE

Kurrë nuk do ta harroj natën të cilën e kam përjetuar, para disa viteve, gjatë rrugës në malet e pashkelura të Afrikës Ekuatoriale. Me anije kam lundruar nëpër Nilin e gjerë. Tashmë e patëm kaluar El-Melkalin dhe hymë në zonën me shumë mushkanja, në të cilën Nili derdhet dhe shndërrohet në kënetë që s'kanë anë e fund. Anija luhatej mbi sipërfaqen e ujit, ajri ishte ngjithës, i ngopur me lagështi; të gjithë në anije, e edhe vetë kapiteni, lënguan nga malaria. Rregullisht i kam gëlltitur tabletat e kamokinit nga frika që të mos i marr ethet.

Atë natë më ra ndërmend që të ngjitem në kuvertë (terracë të anijes) të shoh si duket natën Afrika Ekuatoriale. Duart dhe fytyrën e pata lyer me pastë kundër mushkanjave dhe hipa në kuvertë. Atë që e pashë m'u duk sikur ëndërr: mijëra trungje ndizeshin dhe fikeshin sikur këto të ishin bredhat e kërshëndellave me të cilat fëmijët argëtohen. Kanë qenë të mbuluara me mijëra drita të vogla elektrike të cilat një pas një fikeshin dhe ndizeshin.

I hutuar, i kam fërkuar sytë me duar dhe sërish kam shikuar. Ç'kam vërejtur ka qenë njëmendësi, e jo ëndërr. Vërtet trungjet janë ndezur sikur të jenë të mbuluara me mijëra llampash elektrike, e

pastaj fikeshin. Kapiteni i anijes ma sqaroi se atë që atë natë e kam parë është realitet, se ata drunjtë janë të mbuluar me mijëra çikëvera (xixëllonja) dhe se ato, njëkohësisht ndriçojnë që me dritën e tyre t'i tërheqin mushkanjat dhe t'i hanë, pastaj fikën sërish të bëjnë dritë. Tha se kjo është një prej ligjësive natyrore: kurdoherë që shumohej një lloj insektesh, All-llahu e krijon insektin tjetër, armik, i cili do ta shkatërronte në mënyrë që midis krijesave të veta ta ruajë baraspeshën, dhe që një lloj mos ta çrrënjosë tjetrin përveç, në përpjesëtimet e caktuara.

Një kohë të gjatë e kam rikujtuar atë natë dhe atë bisedë. Çdo ditë gjithnjë e më shumë kam tubuar argumente se tërë gjithësia është skenë e baraspeshës madhështore të çdo gjëje dhe se çdo gjë në mënyrë precize është parashikuar dhe se ligjësive u janë nënshtruar.

Me fjalë tjera, sikur rastësisht rruzulli tokësor të ishte me madhësi më të vogël se ç'është, gravitacioni i tij do të ishte më i dobët, brezi ajror do të ndahej, zhdukej në gjithësi, uji do të avullohej dhe shkrihej dhe Toka do të mbetej e shkretë sikur Hëna, mbi të cilën nuk ka as ujë as ajër, as atmosferë dhe jeta do të ishte e pamundur. E sikur Toka, me parashtrimin, të kishte qenë me madhësi më të madhe sesa që ekziston, fuqia e saj e gravitacionit do të ishte më e madhe, lëvizja në do të ishte më e rëndë, peshat tona trupore do të ishin disa herë më të mëdha dhe trupat aq të rëndë saqë nuk do të mund t'i bartnim.

Ose, për shembull, nëse Toka lëviz rreth boshtit të vet më ngadalë, siç është rasti me Hënë, dita do të zgjatte 14 ditë të tashme e nata 14 net, e klima prej ngrohtësisë vdekjeprurëse gjatë dy javëve të para do të shndërrohej në ftohtësi, të padurueshme gjatë dy javëve vijuese. Andaj jeta do të ishte e pamundur.

Diç e ngjashme do të ishte sikur Toka nga orbita e vet të largohet dhe t'i afrohet Diellit, ose të largohet sikur që është rasti me Jupiterin dhe Saturnin, do të na zhdukte ftohtësia.

Ose, ende më drastike se kjo: e dimë se Toka rrotullohet me pjerrtësi prej 33 shkallësh, për këtë i kemi periodat kohore të cilat shumicën e zonës së Tokës e bëjnë produktive dhe të banueshme.

Sikur korja e tokës të ishte më e trashë do ta pinte oksigjenin dhe njerëzit nuk do të mund t'i plotësonin nevojat e veta me këtë gas të çmueshëm për frymëmarrje.

Sikur detet të ishin më të thella se që janë, teprica e ujit do ta pinte karbon-dioksidin dhe bimët nuk do ta kishin të mjaftueshëm të jetojnë dhe të marrin frymë.

Sikur mbështjellësi i ajrit rreth Tokës të ishte më i rrallë, meteorët, të cilët po bien në vend që të treten dhe zhduken në depërtimin e tyre nëpër mbështjellësin e dendur të ajrit - siç po ndodh tash - do të na mbytnin neve.

Sikur, me ndonjë rast, të rritet përqindja e oksigjenit në ajër në krahasim me të tashmen, përflakshmëria e tij do të ishte më e madhe dhe zjarret më të vogla të shndërroheshin në eksplozime të tmerrshme.

Sikur, prapë, kjo përqindje e oksigjenit të zvogëlohej, aktiviteti ynë do të bëhej i inertshëm.

Sikur akulli të mos ishte më i lehtë se uji, nuk do të notonte mbi ujë dhe thellësitë e detit nuk do të mund ta ruanin ngrohtësinë dhe se nuk do të ishin të përshtatshme për jetën e peshqve dhe qenieve tjera të detit.

Sikur të mos ekzistojë çadra e ozonit, e gozhduar në atmosferë sipër Tokës, e cila i pengon rrezet ultravjollcë që me fuqitë e pakufizuara të arrijnë në Tokë, këto rreze mbytëse do të na zhdoknin.

Nëse dëshirojmë ta bëjmë autopsi vetë njeriun, edhe këtu do t'i gjejmë këto mrekulli (mu'xhize) dhe misterie të cilat tregojnë në këtë baraspeshë precize matematikore: çdo qenie në gjakun e vet posedon përqindjen dhe sasinë e natriumit, kaliumit, kalciumit, sheqerit holesterolit, albuminave. Çdo spostim - ndrim i këtyre përpjesëtimit, qoftëse ka të bëjë edhe me sasinë e vogla, do të thotë sëmundje. Nëse ky jonivelizim vazhdon, kjo do të thotë pleqëri dhe vdekje.

Organizmi i njeriut është i furnizuar me elemente, të cilat, në ruajtjen e këtij ekuilibri gjatë tërë jetës, automatikisht dhe prej vetvetes veprojnë. Alkaloiditeti i gjakut i posedon rregullatorët e vet të cilët e ruajnë. Acidi i urinës, gjithashtu, i posedon rregullatorët e vet të cilët kujdesen për të. Temperatura permanente e trupit të njeriut prej 37 shkallësh ruhet me ndihmën e proceseve të ndryshme fiziologjike dhe kimike, të cilët temperaturën pandryshueshëm dhe barabarësisht e mbajnë në këtë nivel.

Rasti i tillë është me shtypjen e gjakut, me pezmatimin e muskujve dhe rektimën e zemrës. E njëjtë është edhe me aparaturnë për thithje dhe tretje (metabolizmi), me aparaturnë e kombustimit (djegies) në furrën e mëlçisë së zezë, me sistemin e ekuilibrit nervor me të cilën rregullohen impulset për shqetësim dhe qetësim. Ose procesi me të cilin hormonet dhe enzimet (fermentet) i rregullojnë më shpejt dhe më ngadalë proceset kimiko-biologjike.

Trupi i njeriut paraqet mrekulli artistike dhe teknike në sferën e ligjeve të baraspeshës, rregullit dhe harmonisë të cilën e njeh çdo mjek dhe të gjithë të cilët e kanë studiuar fiziologjinë, anatominë dhe kiminë organike.

“... i cili çdo gjë e ka krijuar dhe çdo gjësë ligjësinë ia ka dhënë!” (El-Furkan:2).

Vëllime e vëllime librash nuk do të mjaftonin që t'i numërojmë shembujt nga botanika, zoologjia, medicina dhe astronomia. Çdo imtësi do të na dëshmonte dhe konfirmonte këtë baraspeshë precize dhe organizim madhështor në botën kreative dhe botën e krijesave. Naiv është rrëfimi se kjo harmoni dhe rend është rezultat i rastit, si për shembull kur të thonim se një eksplozim në shtypshkronjë i renditi shkronjat e ndonjë fjalori vëllimor.

I mashtruar është edhe kimisti i cili thotë: “Më jepni ajër, ujë edhe (baltë) kushtet e jetës natyrale dhe unë do t'ua trajtoj - përbëj njeriun.” Ky kimist, me vetë thënien se po i nevojitet materiale dhe kushtet, po e pranon paaftësinë që ta imitojë. Krijuesin, i cili çdo gjë e ka krijuar, e edhe kushtet e njeriut. E sikur edhe t'ia gjenim të gjitha këto kushtet dhe materiale dhe nëse ai, për shembull, do ta krijonte njeriun, nuk do të thotë: “Atë e krijoi rasti”, por do të thotë:

“E kam krijuar unë”

Me të “krijuarit rastësisht do ta krahasonim rrëfimin mbi majmunin i cili është ulur para makinës së shkrimit dhe në pafundësi i shkruan të gjitha kombinimet e mundshme. A mund ta supozojmë se ai, një ditë, rastësisht do ta daktilografojë ndonjë strofë ose fjali të Shekspirit, e cila e ka kuptimin e vet. Çdo supozim i këtillë është i pamundur.

Ta lejojmë hipotezën se kjo rastësisht ka ndodhur në natyrë, se pas miliarda kombinimesh midis elementeve në ujërat e kënetave të formohet sasia e acidit atomik (DNA), i cili mundet vetvetiu ta përtërijë. Por, po pyetemi, se si kjo sasi e acidit organik është zhvilluar në jetën të cilën po e shohim? A mundemi të themi se (përsëri) rastësisht është formuar protoplazma, ose se, në rastin

tjetër, është formuar qeliza, ose, se, në rastin e tretë, qeliza është ndarë në dy lloje: në bimore dhe shtazore, e këto qeliza, gradualisht janë përtërirë. Shpjegimi i tillë është i barabartë me thuprën magjike.

Kurdoherë që diç nuk kemi mund të kuptojmë kemi thënë se kjo rastësisht ka ndodhur, por a është kjo e arsyeshme?

Rastësisht shpezët dhe peshqit shtegtarë, në largësi prej mijëra kilometrash, nëpër dete e shkretëtira, orientohen kah caqet e veta? Rastësisht zogthi e then gëzhhojnë e vezës në vendin e saj më të ndjeshëm që prej saj të dalë? Rastësisht shërohen varat dhe vetvetiu, pa kirurg, koagulohen (qepen) skajet e tyre? Rastësisht luledielli kupton se dielli është burim i jetës së tij dhe për këtë i kthehet? Rastësisht në drurin e shkretëtirës rritet fara me krahë që të mund të fluturojë në zonat ku kushtet për bimë janë më të mira, ku kanë ujitje dhe shi? rastësisht bimët e zbuluan ngjyrën e vet të gjelbër (klorofilin) dhe e përdorin për krijimin e fuqisë së vet jetësore? Rastësisht mushkanja veve të veta, (pa ndihmën e Arkimedit), u ka krijuar qese notuese? Rastësisht bleta e ka organizuar shoqërinë dhe rregullimin, e ka aplikuar arkitekturën dhe teknologjinë e komplikuar kimike me të cilën lëngu dhe poleni transformohen me mjaltë dhe dyllë? Ose bubrecci, termi, i cili e ka zbuluar ligjësinë themelore të ventilimit dhe ka ndërtuar shtëpi termostatike dhe në shoqërinë e vet në mënyrë rigorozë e ka zbatuar parimin e bashkësisë njëklasore? Ose insektet e ngjyrosura të cilat e kanë zbuluar teknikën e maskimit dhe kamuflimit?

A janë të gjitha këto rastësisht? Nëse edhe e pranojmë, në fillim, një rastësi, si mundet arsyeja ta pranojë zinxhirin dhe permanentësinë e akcidentales dhe koïncidencës? Të pranohen fenomenet e këtilla si aksidentale do të thotë joseriozitet i cili mund të vërehet vetëm në filmat komikë të lirë.

Disa janë orvatur që fjalën aksident (rast) ta ndërrojmë me tjetër. Thanë se kjo jetë mallëngjyese, me të gjitha ngjyrat dhe llojet, ka lindur nga nevoja, nga domosdoshmëria, sikur që është nevoja dhe domosdoshmëria e cila të motivon në ushqim kur je i uritur. Pastaj, me ndërlikueshmërinë e rasteve, midiseve dhe nevojave, këto domosdoshmëri janë komplikuar dhe kështu janë krijuar të gjitha këto lloje.

Kjo është vetëm lojë fjalësh. Me fjalë tjera, në vend të fjalës “aksidentalisht” i kanë vënë fjalët “është komplikuar domosdoja e nevojshme”, e “ndërlikueshmëria” është, sipas tyre, automatike, prej vetvetiut. Ajo vetvetiu rritet dhe një ton shndërrohet në simfoni. Si? Si një ngjarje mund të rritet në roman përplot ngatërresa e të mos orientohet dhe dirigjohet me logjikë?

Nga ana tjetër, kush e ka vendosur i pari nevojën dhe domosdonë? Si mund të lindë domosdoja prej jodomosdosë (mundësisë)? Ky është diskutim i pafryt dhe kokëfortësi e cila ka për qëllim ta asfiksojë (shuajë) zërin e natyrës i cili na imponohet dhe flet se Krijuesi, Organizatori ekziston, se kjo është Dora e cila jep instruksione, shkopi i Dirigjentit, i cili e drejton këtë simfoni të bukur e mallëngjyese.

Kjo baraspeshë madhështore, harmoni mahnitëse, veçanti dhe rregullim i cili është i përbërë prej miliona detajesh thërret me tërë zërin se këtu ekziston Krijuesi, Filluesi i këtyre krijesave, se Ai është Zoti i Gjithfuqishëm, se Ai i posedon të gjitha përkryeshmëritë e tyre, se ndaj tyre ka kujdes, si baba i butë, i plotëson nevojat e tyre, i dëgjon psherëtimat e tyre, i sheh gjendjet e tyre. Ky është All-llahu të cilin fetë na e kanë përshkruar me emrat më të bukur (esmau-l-husna) dhe nuk ka zot tjetër.

Ai s'është ligjësi e shurdhër për të cilën thotë materializmi, memec, e as zoti i izoluar i Aristotelit. Ai s'është as zoti i Platonit në botën idealiste, e Ai s'është as ekzistenca materiale siç e ka përfytyruar Spinoza³⁶ dhe rekomanduesit tjerë të panteizmit (monizmit ekzistencial-wahdetu-wuxhud).

All-llahu është: Një dhe asgjë s'është i ngjashëm me Të. Ai është mbi çdo gjë e dimë, mbi të gjitha situatat, format dhe trajtat, kohët dhe vendet. Ai është i hetueshëm sipas veprimtimit të vet, i padukshëm sipas qenies së vet. Atë nuk e shohin sytë, e Ai çdo gjë e sheh, ose, thënë edhe më mirë, të gjithë sytë me Atë shohin. Me dritën e Tij dhe me ndihmën e fuqisë të cilën Ai syve ua dhuroi.

Arsyeja shkencore (el-aklu-l-ilmijj) nuk i pranon këto fjalët e sufizmit, andaj dëshiron ta shohë Zotin që ta pranojë. Dhe kur i themi se All-llahu është i pakufizuar, se është e pambarim, se është nocion transcendent, shkenca thotë se për këtë arsye atë nuk e pranon, se shkenca nuk beson në nocionet transcendentale - sekrete, dhe se sfera shkencore është empirike - se fillon prej sensibilizmit dhe përfundon me përvojën dhe eksperimentin.

Do t'i themi shkencës se ky konfirmim është jo i vërtetë, sepse gjysma e shkencës së sotme është nocion transcendent, me fjalë tjera, shkenca konkludon se ngjitja kodrës është më e rëndë se sa zbritja teposhtë kodrës, se ngritja e gurit në shpinë është më e rëndë se sa ngritja e ndonjë shkopi,

³⁶ "Ekziston vetëm një substancë e cila është shkak i vetvetes, medoemos ekziston dhe është i paskajshëm: zoti ose natyra: (Spinoza, shën. i A. Hukiqit).

se shpendi kur ngordh bie në tokë, se molla nga trupi i mollës gjithashtu bie në tokë, se Hëna në gjithësi rrotullohet.

Këto vrojtme në shikim të parë ndërmjet veti nuk kanë kurrfarë lidhshmërie. Por, kur Njutni e zbuloi ligjin e fuqisë së gravitacionit³⁷ i cili i lidh të gjitha këto manifestime, atëherë edhe rënia e mollës nga druri, vështirësia gjatë ngjitjes, ngritja e gurit dhe lëvizja e Hënës në gjithësi, u bënë argumentet e teorisë e cila na e shpjegoi gjendjen faktike.

Edhe përveç kësaj ky gravitacion është nocion transcendentale, sepse askush s'e di ç'është qenësia e tij. Askush s'i ka parë shtyllat mbi të cilat mbështetet qielli dhe në të yjet dhe planetët, edhe vetë Njutni, autori i teorisë, në letrën drejtuar mikut të tij Bentlit, thotë: “Vërtet është e pakuptueshme që ta kemi materien e cila është e pajetë dhe jo e ndijshme që ndikon në materiet tjera dhe i tërheq edhe pse midis tyre nuk ka kurrfarë lidhje dhe marrëdhënie.”

Ja, kjo është teoria shkencore me të cilën manipulojmë, besojmë në të dhe e konsiderojmë shkencore e ajo është transcendentale, me mendje e pakuptueshme. Rasti i tillë i njëjtë është me elektronin, radio-valët, atomin, neutronin. Të gjitha këto s'i kemi parë por, megjithatë, në ekzistencën e tyre besojmë duke mjaftuar me gjurmët, emanacionet e tyre. Edhe ne, për këto

³⁷ Gravitacioni (gravitatio), fuqia tërheqëse ndërmjet pjesëzave materiale në gjithësi nën ndikimin e së cilës kryhen lëvizjet e trupave qiellorë. Këtë ligj shkencërisht e shpjegoi fizikani i njohur Isak Njutni (1642-1727).

fenomenet, themelohet shkenca të veçanta, iu ndërtojmë institucione dhe laboratoriume, e ato shkenca, në raport me shqisat tona, janë jo të ndjeshme, gajb (transcendentale)³⁸.

Thënë më saktësisht, shkenca nuk e ka kuptuar esencën e asnjë sendi në tërësi. Vetëm i dimë emrat e këtyre sendeve, por jo edhe esencën e tyre. Ne ndërmjet veti shërbehemi me termat ndërsa esencën e tyre nuk e njohim.

All-llahu ia mësoi Ademit vetëm emrat, por jo edhe kuptimet, siç konfirmohet në Kur'an:

“All-llahu ia mësoi Ademit të gjitha emrat...” (El-Bekare:31).

Ja, këta janë kufijtë, suazat e shkencës.

Më së shumti që shkenca dëshiron të mësojë këto janë raportet (lidhjet) (alakat) dhe përpjesëtimet (mekadir), por ajo nuk mund të shohë esencën, as qenësinë, kuiditetin e tyre. Shkenca në mënyrë permanente i mëson dhe njih sendet sipas fenomenalitetit të tyre dhe i ekzaminon (hulumton) ato nga ana e jashtme. Edhe përkundër kësaj mënyre konsekuente iu përmbahet teorive të veta, sikur e ka mësuar esencën e sendeve; i preferon dhe rekomandon disa gjëra, të cilat, në raport me mjetet me të cilat shërbehet, janë transcendencë, persiatje dhe supozim i pastër.

Gjendemi në epokën e shkencës transcendentale e cila paraqet një lloj labirint supozimesh.

Konsideroj se shkenca nuk mund ta kritikojë transcendencën deri sa ajo vetë deri në vesh është fundosur në transcendencë.

³⁸ Krejt çka i tejkalon kufijtë e çdo përvoje të mundshme njerëzore dhe që me kurrfarë afrimi gradual nuk mund të njihet. (Filozofski riječnik, Zagreb 1965. A.H.)

Për këtë do të ishte më mirë për ne të besojmë në botën e gajbit, botën transcendentale, në mirëbërësin tonë Fisnik, gjurmët dhe emanacionet e të cilit i shohim te çdo lëvizje e syrit, të çdo rrahje e zemrës, te çdo çast i meditimit. Kjo do të ishte më mirë se sa të asfiksohemi (mbytemi) në hipoteza e supozime.

DEXHALLI (ANTIKRISHTI)

Fetë në formë legjende na flasin se si para rrënimit të plotë të botës do të paraqitet një njeri, i cili do të bëjë vepra të jashtëzakonshme dhe mrekullira dhe i cili, nëpër mbarë botën, do t'i mashtrojë njerëzit, se ata do ta ndjekin atë dhe do t'i besojnë se ai është Zot.

Legjendat na përshkruajnë se ai është me një sy, por është jashtëzakonisht i aftë që me atë sy, mund të shohë se ç'po ndodh në skaj të botës, e me vesh mund t'i dëgjojë edhe pëshpëritjet e njerëzve përtej detit. Sipas dëshirës së tij edhe shiu do të bjerë dhe bimët do të mugullojnë. Ai do t'i zbulojë pasuritë e fshehta, do t'i shërojë të sëmurët, do t'i ringjallë të vdekurit dhe me shpejtësi të erës do të fluturojë. Do ta mashtrojë çdonjërin i cili do ta shohë dhe do t'i përulen, sikur All-llahut, në sexhde. Vetëm besimtarët e vërtetë do ta shohin në fotografinë dhe qenien e tij të vërtetë; ata nuk do t'i mashtrojnë veprat e tij mbinjerëzore. Ata në fytyrën e tij do t'i lexojnë shenjat e mosbesimit (kufrit).

Ky është Dexhalli apo i dërguari i rrejshëm, Antikrishti, një prej paralajmërimeve të rrënimit të plotë të botës, për të cilin po lexojmë nëpër veprat teologjike.

Dexhalli, në të vërtetë, tashmë është lajmëruar, siç e thotë këtë shkrimtari polak Leopold Vajsi, i cili e ka pranuar Islamizmin dhe jetoi në Mekke. Quhet Muhammed Esed⁵⁹. Ky Dexhalli me një sy siç thotë Leopold Vajsi, është progresi material, materializmi dhe bollëku material, ato janë idole bashkëkohore. Me fjalë tjera, civilizimi i epokës së atomit, me një sy dhe i çalët, i cili përparon vetëm në një drejtim, shikon vetëm në një orientim, ky është ai orientim i materializuar. Ai nuk e posedon syrin tjetër, “shpirtëror”, atë sy i cili e observon, shikon aspektin shpirtëror të jetës. Për këtë jeta e materializuar është fuqi pa mëshirë, shkencë pa fe, teknologji pa etikë-moral.

Dhe vërtet ky Dexhall arriti që me anë të shkencës, nëpërmjet telegrafisë pa tela të dëgjojë se ç'po ndodh në skajin tjetër të botës, nëpërmjet televizionit të shohë se ç'po ndodh në këndin më të largët të botës. Ai, sot, në mënyrë artificiale krijon shi, shkretëtirën e bën të plleshme, i shëron të sëmurët, i transplanton zemrat e të vdekurve në kraharorin e të gjallëve, me raketa fluturon rreth Tokës, me bombat atomike mbjell vdekje dhe shkreti dhe e zbulon xehen e artë në brendi të bjeshkës.

Dexhalli i këtitillë i ka mashtruar e gënjyer njerëzit, e ata filluan ta adhurojnë.

⁵⁹ M. Esedi (Muhammed Esedi, 1900 - .), para kalimit në Islamizëm quhej Leopold Weis, i lindur në Lavovë, (atëherë i takonte Austro-Hungarisë). Një kohë të gjatë e studioi fenë e tjerat, e pastaj... ka marrë pjesë në shumë aksione dinamike në zgjimin e popullit nga neglizhenca ekzistuese. Përveç aktivitetit politik, diplomatik kultural është marrë edhe me publicistikë. Një nga veprat e tij “The road to Mecca” (“Rruga deri në Mekke”) është përkthyer më në serbokroatishte në Sarajevë, 1981. Me sukses e përktheu Kur’anin në anglishte, e tjera.

Para një defileu të këtillë verbues të progresit shkencor të Perëndimit, me njerëzit e Lindjes e kemi humbur besimin në vetvete dhe me përlujtje e nënçmim shikojmë në traditën tonë dhe në fenë tonë.

Duke e përjetuar kompleksin emocional të vlerës më të mëngët dhe prapambeturinë, menduam se feja jonë është lloj mitologjie së cilës i turpërohem dhe së cilës duhet t'i lirohem në mënyrë që të inkuadrohem në karavanin e progresit dhe të hyjmë në tempullin e ri, tempullin e shkencës ku do ta adhuronim zotin e ri i cili quhet fuqia materiale.

Kështu të verbuar dhe pa vetëdije, jemi gjunjëzuar, sepse nuk ditëm ta dallojmë mjetin prej qëllimit. Me fjalë tjera, fuqinë materiale e kemi bërë qëllim, ndërsa harruam se ajo është vetëm vegël dhe mjet.

Mjet është hekurudha, telegrafi, rryma elektrike, energjia atomike. Roli i këtyre mjeteve është që të vihen në shërbim të njeriut, që t'i plotësojnë nevojat e tij materiale dhe që t'ia mundësojnë aktivitetet ideore, meditimin dhe fisnikërimin e shpirtit me njohuri autentike. Dhe, në vend që këto mjete neve të na shërbejnë, ne u jemi vënë atyre në shërbim: po përpiqemi dhe po angazhohemi, po luftojmë dhe ndërmjet veti po grindemi që të posedojmë vetura, radio dhe televizorë. E kur një ditë këto gjëra t'i posedojmë, rritet lakmia jonë dhe dëshirojmë të kemi vetura edhe më të mëdha dhe më luksoze, magnetofonë stereo-fonik, barkë për rekreacion, jahtë, vilë, kopsht, basen personal për notim dhe përfundimisht avion privat. Gjykimi ynë racional, para rrëkesë, rrebeshit të të mirave gjithnjë e më të reja të konsumit të cilat i mbushin vitrinat, humbet dhe shndërrohet në uri të tmershme, e cila sa më shumë që blejmë, bëhet aq më e ashpër. Dhe kështu pangopësia dhe lakmia pa përfundim ndërrohen: posa zbutet njëra, e reja shpërthen.

Synojnë vetëm kah një cak, që të arrihet fuqia ende më e madhe materiale ose luksozi jetësor të cilin teknologjia e përditshme e servon nëpër vitrinat e shitoreve.

Dhe sikur që qytetari i rëndomtë e grumbullon pasurinë konsumuese, shtetet grumbullojnë armë dhe municion që njëra tjetrën me këto mjete, në luftëra të pakompromis ta shkatërrojnë, e pastaj sërish të fillojnë të grumbullojnë armë edhe më të rrezikshme dhe bomba edhe më rrënuese.

Bota është bërë skenë e marrë në të cilën budallenjtë vrapojnë vetëm në një drejtim - në drejtim të fuqisë materiale. Dexhalli me një sy është idol bashkëkohor: “Nuk ka zot përveç materies, ajo është zot”.

Kjo është lutja e përditshme. Po zhduket besimi në Zotin, e me këtë besim në një përmasë të madhe zhduket edhe ndjenja e sigurisë dhe qetësisë. Koncepti filozofik i botës është bërë xhungël në të cilën po lufton kthetra e dhëmbi syrit, po zhvillohet lufta klasore, racore dhe ideologjike. Botë e llahtarshme përplot me frikë dhe krime. Askush s'është në qiej që të kujdeset për këtë botë dhe ta ruajë atë.

Deri këtu na solli adhurimi i Dexhallit të cilin e quajmë fuqi materiale. Rezultat i kësaj është ky njeri i pikëlluar, i brengosur, i frikësuar dhe i shqetësuar. Edhe ai djalosh i cili e ka bërë zakon të marrë drogë nëpër rrugët e Londrës dhe Parisit. Ose vetëmbytjet dhe çmendjet të cilat më së shumti janë paraqitur në vendet e pasura, në vendet me standard dhe bollëk të lartë sikur që janë Suedia, Norvegjia dhe Amerika.

Ky njeri i frikësuar, i cili e ka humbur sigurinë, po orvatet që me anë të veglave industriale - teknologjike ta kthejë këtë siguri nëpërmjet syrit magjik në dyert e shtëpive i cili funksionon në

bazë të rrezeve ultra të kuqe dhe e zbulon vjedhësin. Ose, me ndihmën e ziles alarmuese në arkë dhe kardiogramit çdomujor që të zbulojë gjendjen parainfraktike. Rolin e ngjashëm e ka edhe erkondishni (aparati elektronik për rregullimin e ajrit të ngrohtë dhe të ftohtë në shtëpi), polisa e sigurimit, me dhjetra lloje vitaminash, ilaçesh për qetësim dhe disponim dhe me dhjetra aparate tjera me të cilat e kursejmë angazhimin dhe mundimin fizik.

Çdo mjet material, prapë e kërkon mjetin tjetër material për të gjetur mbështetje. Dhe kështu vazhdimisht, nuk ka siguri. Përkundrazi, kemi tepër shqetësim, frikë dhe mllef. Vrap i kah mjetet më të mëdha materiale nuk është duke e dhënë rezultatin e kërkuar dhe të dëshiruar.

Njeriu harron se në këtë humnerë në të cilan e ka kaluar jetën e tij, në fillim ka gabuar kur mendoi se kjo botë është pa Zot dhe se njeriu është hedhur në këtë botë, pa ligjësitë të cilat e ruajnë dhe se është pa Krijues të cilit do t'i jetë përgjegjës.

Njeriu ka gabuar edhe herën e dytë kur filloi ta adhurojë fuqinë materiale dhe u orvat ta bëjë burim të fatit të tij, të sigurisë së tij dhe qëllim të jetës dhe përpjekjeve të tij. Ai, në vend të Allahut, e vendosi atë. Ai fuqinë materiale e përfytyroi për shpëtuese, e cila do t'ia japë sigurinë, qetësinë dhe paqen e humbur, se kjo fuqi mund ta ruajë nga vdekja dhe shkatërrimi. Ndërsa ajo pikërisht është shtrembëruar në të kundërtën dhe është bërë ajo e cila ia mori qetësinë shpirtërore dhe, në fund, u bë mjet i luftës e cila e mbyt njeriun dhe e masakron atë.

Njeriu ka gabuar edhe herën e tretë kur e mendoi se kimia, fizika dhe elektronika janë shkencë, ndërsa feja mit dhe bestytни. Sikur të kishte menduar më tepër do të mësonte se kimia, fizika dhe elektronika janë vetëm aspekte të shkencës, degë të cilat i studiojnë disiplinat e caktuara shkencore, marrëdhëniet, kualitetin dhe kuantitetin, derisa religjioni është shkencë universale, ose

thënë më mirë, ajo është gjithëdituri, sepse ajo e studion parafillimin e sendeve dhe përfundimin e tyre absolut, qëllimet definitive të botës fenomenale, kuptimin e përgjithshëm të jetës dhe përfundimisht fshehtësinë universale të dhembjes.

Kimia, fizika dhe elektronika janë shkencat të vogla, e feja është e madhe. Ajo në gjirin e saj i përfshin të gjitha shkencat tjera.

Nuk ka kundërthënie ndërmjet fesë dhe shkencës, sepse feja, në qenësinë e saj është fund i njohjes e cila domosdo i nënkupton të gjitha shkencat. Së këndejmi rrjedh edhe nevoja e të studiuarit të fesë, sepse ajo është e cila në mënyrë organike, shkencave të vogla ua cakton qëllimet, ua parasheh caqet dhe në suazën e jetës ideale vë detyrat solide.

Feja është ajo e cila e valorizon ndërgjegjen dhe i jep asaj normativ, e ndërgjegjja, për shembull, energjisë nukleare do t'i caktojë detyrë dhe obligim konstruktiv, e nuk do ta përdorë për shkretërimin dhe mbytjen e të pafajshmëve. Feja është ajo e cila na thërret që rrymën elektrike ta bëjmë, për shembull, mjet për ndriçim, e jo për shkatërrim. Feja na mëson se të gjitha shkencat janë mjete e jo caqe, sikur edhe këtë se progresi material është mjet, e jo cak-qëllim.

Njësoj janë edhe mjetet materiale. Sepse, materia, sikur edhe ne, është krijuar, e nuk është zot i cili adhurohet. Prandaj, materia nuk mund t'i falë njeriut siguri, qetësi dhe fat. Përkundrazi, sipas natyrës së saj materia është e prishur dhe relative, po sikur edhe të gjitha sendet tjera në këtë gjithësi të papërkryer. Për këtë, materia edhe nuk është e përshtatshme që njeriu plotësisht në të të mbështetet e as nuk paraqet fuqi objektive.

Feja jo vetëm që nuk është kundër shkencës, por ajo e urdhëron, nxit, gjithashtu, ia jep rolin e ndërmjetësuesit për njohje si një ndër mjetet e shumënumërta të cilat i posedon njeriu, sikur që janë: kongenitaliteti (natyra e pastër e brendshme), aftësia e të observuarit, intuita, frymëzimi dhe revelata.

Refuzimi i shkencës dhe mospranimi i mjeteve progresive materiale është njësoj gabim sikur edhe adhurimi i mjeteve të tilla dhe të nënshtruarit e njeriut atyre e kjo është një ndër shkaqet e prapambeturisë së vendit tonë⁴⁰. Me fjalë tjera, në Lindje do të ballafaqohesh me një prej dy fenomeneve: ose do ta takosh atë që e mohon shkencën dhe kufizohet në fe dhe Kur'an, ose atë i cili e mohon fenë dhe kufizohet në shkencë materialiste dhe mjetet materiale. Mirëpo, të dy këto raste paraqesin shkaqet e tragjedisë së civilizimit të kësaj zone. Asnjëri prej këtyre dy rekomanduesve të drejtimeve nuk e ka kuptuar kuptimin e vërtetë të fesë, e as kuptimin e vërtetë të shkencës.

Feja, e posaçërisht Islamizmi, e shikon shkencën si obligim të domosdoshëm. Në këtë aspekt i dërguari jonë thotë se shehid është kush vdes në rrugë të diturisë... se dijetarët janë trashëgimtarë të të dërguarëve të All-llahut..., dhe se e kemi detyrë të kërkojmë dituri qoftë kjo edhe në Kinë. Fjala e parë me të cilën filloi shpallja e Kur'anit është "IKRE" ("Mëso, studio, hulumto...).

Islamizmi është fe e arsyes dhe ithtarëve të tij u drejtohet me metodë racionale. Për këtë shkenca dhe progresi material shkencor kanë rëndësi të jashtëzakonshme në fenë tonë, porse gjithmonë

⁴⁰ Këtu autori mendon për Egjiptin dhe vendet arabe përreth.

janë trajtuar si mjete e jo qëllime, e idole të adhuruara. Vetëm ky është qëndrim i vërtetë ndaj shkencës dhe pozitës së saj.

Me fjalë tjera, mjete material nuk i jep shpirtit siguri dhe qetësi, por vetëm ia siguron rrugën kah begatia dhe bollëku dhe ia siguron nevojat e përditshme jetësore. Ai nuk sjell siguri. Edhe pse ekzistojnë frigoriferët, aparatet radio-televizive, magnjetofofonët, er-kondishnët, shevroletët dhe aparatet tjera materiale, mbetet shkretia shpirtërore. Përkundrazi, sa më i varur të jetë njeriu nga këto mjete dhe më tepër të vrapojë pas tyre, aq më e madhe është edhe pasiguria dhe shkretia e tij shpirtërore.

Siguria shpirtërore, rehatia dhe paqja arrihen vetëm me një mjet: e ai është të besuarit se ekziston Zoti, i cili e ka krijuar gjithësinë se ai Zot është në mënyrë universale i drejtë, se gjithësisë ia ka imponuar ligjësitë, të cilat e mbajnë dhe çdo gjë me urtësi dhe arsye në gjithësi e ka paraparë; të besojmë se All-llahut do t'i kthehemi, se dhembjet dhe vuajtjet tona nuk do të jenë të kota, se individualiteti njerëzor është e vërtetë universale, e jo vidhë a aparaturës e cila në tokë do të humbet.

Vetëm bindja e thellë kësioj ia kthen njeriut vlerën dhe dinjitetin e tij. Këtë nuk mund ta bëjë frigoriferi, televizori, magnjetofofoni, as çfarëdo mjeti tjetër material, sado i rëndësishëm të jetë. Me këtë bindje të thellë futet qetësia në shpirt dhe njeriu i tillë e arrin konsolidimin shpirtëror dhe barspeshimin e brendshëm dhe ndjehet më i fuqishëm sesa vdekja dhe sesa dhuna. Me këtë bindje njeriu u konfrontohet rreziqeve edhe më të mëdha, i ngadhënjën; me imanin e tij në mburojë më të fortë se të tankut, në fortifikatën e cila nuk mund të pushtohet me kurrfarë torpedo, sepse kjo fortifikatë e tejkalon edhe vetë vdekjen.

Me këtë besim njeriu e ndjen se e ka kthyer personalitetin dhe individualitetin e tij, se ai është vërtet ai dhe se, nëpërmjet të kuptuarit dhe njohjes së All-llahut të përkryer dhe një, e njohu vetveten, esencën dhe pozitën e vet.

Kush e ka ndje në këtë njohje të rrallë, e di se kjo është gjendje e frymëzimit dhe përjetimit të brendshëm, e jo imagjinatës. Nuk është kjo dekorim mashtrues i sigurisë imagjinuese, por është e vërteta qenësore. Kjo është përjetim dhe zgjim i vërtetë, e jo ëndërr dhe imagjinatë.

Këtë bindje të thellë religjioze e njohim nëpërmjet kundërthënies së saj: nëpërmjet situatës së adhuruesve të shumënumërt të Dexhallit, Mesiut - antikrishtit bashkëkohor, i cili posedon tru elektronik. Këta adhurues të shumënumërt të cilët ndërmjet veti grinden i përdorin drogat dhe pa qëllim bredhin në dyert e marrëzisë dhe vetëmbytjes, me hapa të përgjakshëm i afrohen luftës së tretë botërore.

Instinkti jonë do të na tregojë kush ka të drejtë: kjo shumicë e cila njëri tjetrin e han dhe e cila, nga urrejtja dhe smira shkatërron, ose kjo pakicë në zemrat e të cilëve është rehatia dhe e cila e kuptoi se Zoti ekziston.

Feja nuk e refuzon as jetën as arsyen. Kjo posaçërisht është rast me Islamizmin, i cili ka lindur prej dashurisë për jetë, i cili jetën e mbron dhe kujdeset për të. Gjithashtu ai nxit në respektimin e arsyes, në zgjerimin e idesë shkencore, e prezenton legjisllacionin bashkëkohor, i cili i bashkon shpirtin dhe trupin dhe i bën një. Në Islamizëm nuk guxon të vijë deri te dominimi i shpirtit ndaj trupit e as trupit ndaj shpirtit; porse edhe njëra edhe tjetra të sillen si njësi të pandara. Me fjalë tjera, Islamizmi nuk kërkon prej nesh që sensualitetin, instiktin tonë ta vdesim, por ta rregullojmë dhe të kujdesemi në suazën e kufijve të lejuar. Norma religjioze islamike nuk është

përcaktim eksklusiv i lutjeve, vetmisë dhe asketizmit. Norma fetare islamike është puna dhe veprimi. Të përjetuarit shpirtëror të Zotit duhet të kurorëzohet me veprim për mirëqenien e shoqërisë dhe dobisë së përgjithshme. Madje edhe vetë lutja islame nuk është e plotë nëse manifestohet vetëm me përlulje shpirtërore, por ajo njëkohësisht duhet të manifestohet edhe me trup duke u përlulur (ruku') dhe prosternuar (suxhud).

Ose, të bëhemi edhe më të qartë: lutja islame, namazi, është simbol i kësaj tërësie të pandarë, simbiozës së trupit dhe shpirtit; shpirti është i bindshëm, gjuha madhëron dhe trupi përulet.

Edhe vizita (tavafi) rreth Qab-es e simbolizon pikën qendrore, një pol: të gjitha lëvizjet dhe të gjitha idetë janë të orientuara kah një cak - Krijuesi, Qenies së vetme i cili i pavarur, independent ekziston, ndërsa çdo gjë prej tij varet. Për atë edhe tavafi është simbol i këtij integriteti tresh dhe unitetit të tyre: material, psikik dhe shpirtëror.

Në këtë mënyrë Islamizmi ia kthen njeriut adezionin e tij e bën prej tij simbiozën e shpirtit dhe materies, ia kthen qetësinë dhe e përfundon këtë luftë të përhershme të sensualitetit dhe arsyes dhe prej tyre lind diç e re: sensualiteti i paramenduar, i ekuilibruar në të cilën treten dy kundërthënie sikur që bashkohet ndjenja dhe ideja, përjetimi i brendshëm dhe manifestimi i jashtëm. Në këtë mënyrë u shmangemi kundërthënieve ndërmjet ndjenjës dhe arsyes, arsyes dhe fjalës, fjalës dhe veprës. Në vend të kontrasteve të tilla, në vend të njeriut të tillë të dezorganizuar, e kemi njeriun e ri i cili e bashkon shpirtin dhe trupin, veprën dhe fjalën, përjetimin e brendshëm dhe manifestimet e jashtme.

Me bashkimin e shpirtit dhe materies, njeriu arrin të bashkohet me Krijuesin e tij, e kjo është të afruarit e njeriut Zotit, kur njeriu hyn në rrethin e dritës dhe shkel jashtë kufirit të kësaj bote fenomenale.

Mësimi burimor islam lëviz rreth kësaj ideje bashtore, themelore, idesë së njësisë (tewhidit). Këtë ide Kur'ani e konfirmon me çdo shkronjë të tij, me çdo fjalë, me çdo ajet dhe e përsërit në figura, rrëfime, shembuj, urtësi dhe maksima të ndryshme.

Islamizmi ia paraqet epokës së materies derën e vetme të shpëtimit, rrugëdaljen dhe zgjidhjen e vetme. Me fjalë tjera, Islamizmi i ofron njeriut tërë trashëgiminë e vet shpirtërore e nga ai nuk kërkon që t'i lëshojë të arriturat e tij shkencore apo materiale. E tërë çka Islamizmi kërkon është që njeriu të realizojë unitet të suksesshëm ndërmjet materies dhe shpirtit, në mënyrë që në këto baza të ngrihet civilizimi i ri, civilizimi i fuqisë dhe mëshirës, civilizimi ku fuqia materiale nuk do të jetë idol, por mjet dhe vegël në dorën e zemrës mëshiruese. Në këtë mënyrë do të zhduket Dexhalli, lajmëtari i rrejshëm i fesë dhe do të vendoset shoqëria ideale njerëzore.

Dhe, përfundimisht, do të përpiqem të përgjigjem në pyetjen e shtruar me ngurrim: përse na krijoi All-llahu?, përse na sollti në këtë botë? dhe çfarë është urtësia e kësaj peripecie të cilën e përjetojmë?

Kur'ani në këtë pyetje përgjigjet me disa ajete të tij:

All-llahu e krijoi njeriun me kureshtjen e mbjellë instinktivisht në të, që nëpërmjet saj t'i mësojë fshehtësitë e kësaj bote dhe vetvetes, e nëpërmjet vetvetes ta njohë Krijuesin. Duke e njohur

Krijuesin e tij të Lartë, do të fillojnë ta adhurojnë dhe duan dhe në këtë mënyrë do ta meritojnë dashurinë e Tij dhe dhuratat e Tij.

Për këtë All-llahu edhe na krijoi, për këtë cak përfundimtar, të na dojë dhe shpërblejë. Ai edhe na dënon që të na bëjë të vetëdijshëm dhe nga gjumi të na zgjojë dhe me këtë të na aftësojë për dashurinë dhe begatitë e Tij.

Me dashuri është krijuar,

Për dashuri është krijuar,

Dhe për dashuri është dënuar.

I hyjnuar dhe i lartësuar je Ti, i cili je Mëshirues dhe i Urtë.

Ti i cili na krijove!

NË VEND TË PASTHËNIES

E shohim të arsyeshme që me këtë përkthim t'i japim edhe ca shpjegime, e ato janë të natyrave të ndryshme. Të gjitha këto mund t'i reduktojmë në disa.

- Veprës i paraprin parathënia e dr. A. Smajloviqit nga vepra “Dialog me mikun”, Sarajevë, 1976, për çka singërisht i falënderohemi. Mirëpo, meqë kjo parathënie është shkruar para dhjetë viteve, lexuesve ua bëjmë të ditur se M. Mahmudi edhe sot e kësaj dite me angazhim të pashoq

hulumton, mediton dhe publikon, pikërisht sipas sentencës së njohur të Faraday-s: “To work, to finish, to publi” (Të punosh, të përfundosh, të publikosh.) Rezultat i kësaj pune janë me dhjetra vepra, studime dhe shkrime tjera. Përveç kësaj thesarin islam e pasuroi edhe me më se 50 filma dokumentarë mbi florën, faunën, botën inorganike e tjera. Të gjitha këto të motivuara nga Kur'ani, por edhe nën prizmin rigoroz të Kur'anit dhe shkencës.

Me fjalë tjera, vepra e dr. Mustafës është shembulli më i mirë i mishërimit dhe pandashmërisë ndërmjet shkencës dhe teologjisë, empirikës dhe metafizikës. Ai është shembull ideal se edhe ata “pa ixhazet-name dhe ahmedije” mund të kontribuojnë në të komentuarit e Kur'anit.

- Për përkthyesin në radhë të parë shtrohet pyetja e përkthimit të neologjizmave, terminologjisë dhe mjeteve tjera shprehëse. Me këtë problem edhe ne jemi ballafaquar, dhe thënë sinqerisht, mjaft jemi hamendur në disa terma. Për këtë gjendje ekzistojnë shumë faktorë. Kjo edhe ka qenë shkas që të intervenojmë pas termave të caktuar me kllapa, duke e dhënë edhe termin e afërt përbri atij parësorit dhe t'i japim shpjegimet e shumta pas tekstit në fund të faqeve. Sidomos jemi ndalur te termat më të shpeshtë, por edhe ata të rrallët, por që e lënë të mangët kërkuesin e lexuesit. Nëse në këtë sado pak e kemi plotësuar nevojën jemi më se të kënaqur.

Për pikëmbështetje gjatë përkthimit tonë e kemi pasur përkthimin e suksesshëm të prof. A. Hukiqit në serbokroatishte, Sarajevë, 1977, prej nga jemi shërbyer edhe me disa shpjegime, për çka i falënderohemi këtij veterani të pendës. Megjithkëtë, në disa raste kemi abstenuar nga disa terma të aprovuar në tekstin në serbokroatishte. Tërë përkthimin në shqipe e kemi krahasuar me origjinalin dhe në disa raste i jemi përmbajtur tekstit arab, ngase ka qenë më i afërt me shqipen. Për këtë qëllim shih origjinalin, botimi i dytë, Daru-l-me'arif, Kajro, 1977, 112 faqe.

- Në fund mund të themi se është kënaqësi e vërtetë për përkthyesin të rreket me krijimtarinë e dr. M. Mahmudit, e shpresoj se këtë do ta ndjejnë edhe lexuesit gjatë leximit, sepse të gjithë ne në ndonjë mënyrë e gjejmë veten të mishëruar me të. Dhe, u shprehim mirënjohje të gjithë atyre që në çfarëdo mënyre e mundësuan botimin e kësaj vepre dhe shpresojmë se kjo vepër do të gjendet në vitrinat tona të etshme për literaturë të këtyllë fetare në gjuhën shqipe.

Nexhat Ibrahimi